


VIKTOR CANOSINAJ



roman

Pianistja belge

85H-31  
C 19

Viktor Canosinaj

# Pianistja belge

*Roman*



Dyrrah

# I

Ata po vinin me vrap, kapur për dore, me çantat hedhur shkujdesur supit, me pamje të çakërdisura njerëzish të harruar, mbetur në një ishull të humbur, që shohin diku në det një anije shpëtimtare dhe dalin në breg e fillojnë hidhen përpjetë, duke bërë shenja me duar e duke thirrur si të krisur. Në sy kishin një shkëlqim ëndërrimtar, të etur. Ata sy shikonin larg, me qindra kilometra larg, nuk donin t'ia dinin fare për tokën ku shkelnin. Kohë pas kohe vajza ngjeshej pas djalit sikur të donte të bindej për praninë e tij, sikur të mos i mjaftonte dora e tjetrit, të cilën e kishte shtrënguar gati-gati me kthetrat e një shpendi grabitqar.

Gruaja e moshuar i pa dhe ndali. Kuptoi gjithçka. Ishte një ditë që ata po e prisnin. Të tre. Ajo u pështet pas murit të rrugicës duke mbajtur në krahun e djathtë një shportë. Djali dhe vajza nuk e panë. Shtynë me sup portën e vjetër të shtëpisë dhe hynë në oborr. Vetëm atëherë gruaja vazhdoi të çapitej, iu afrua portës dhe i pa ata të dy tek po putheshin sikur të kishte tingëlluar ora e fundit e botës. Çantat i kishin flakur për tokë. Vajza ishte lidhur pas supit të djalit dhe lakohej pas tij si një velë e grisur anijeje të cilën stuhia kërkon ta shqisë përfundimisht nga direku, por ajo nuk epet, mbahej te lidhja e fundit e litarit, një lidhje e pagabueshme kjo, e bërë nga dorë mjeshtri. Buzët e saj kërkonin vazhdimisht ato të djalit, të hapura, të thara, të nxehta.

Ai i përgjigjej, e tërhiqte pas vetes me një rëndësi të fortë, ndërsa me tjetrën kërkonte diku në xhepin e pantallonave çelësin e derës. Më në fund e gjeti atë dhe e hapi derën pa u shkëputur nga trupi i vajzës dhe buzët e saj. Përfunduan të dy brenda dhe pas tyre dera mbeti hapur.

Gruaja e moshuar buzëqeshi si nëpër ëndërr. Kam pasur moshën e saj atëherë, mendoi. Ajo iu afrua duke u rrëqethur derës së katit gjysmë të nëndheshëm të asaj shtëpie të vjetër e të madhe, që dikur, në kohën e lavdisë së saj, mbante emrin Vila e Trëndafilave të Bardhë. Dëgjoi disa rënkime të ëmbla, pastaj fjalë dashurie pa fund, që të kujtonin mërmërimën e një përroi që vjen përmes një lugine malore, duke kërcyer gurë mbi gurë e duke u lëpirë brigjeve të veshur me myshk e shkurre. Djali dhe vajza kishin përfunduar në dysheme, të kapërthyer me etjen e vjetër të racës njerëzore për t'i shkrirë dy trupa në një.

Gruaja nuk u tërhoq. Vazhdoi të shikonte qetësisht, e përmalluar, me një buzëqeshje miqësore, si njerëzit kur kujtojnë ndodhitë e tyre të shkuara që nuk do të përsëriten më kurrë. Vajza ishte kapur me këmbë pas mesit të djalit dhe me krahë te supet e tij. Përkulte vazhdimisht qafën për të arritur buzët e tij. Ajo ishte shtrati i përroit, i cili nuk u mjafton kurrë ujërave të harbuar pranverorë që zbresin nga malet, për t'u këputur poshtë nëpër ujëvara dhe për t'u derdhur më në fund në një lumë më të gjerë. Djali ishte përroi që tashmë kishte zbritur deri në brez të malit dhe vrulli nuk mund t'i përmbahej më. Ai lëvizte mbi trupin e vajzës si vrundujt e ujit kur kapërcejnë një va.

Gruaja e moshur bëri drejt djalit një gjest kurajoje, pa e ndëprerë buzëqeshjen dhe duke u përhumur edhe më thellë në përmallimin e saj. Im nip di të bëjë dashuri



vërtet bukur, mendoi. I ka ngjarë të gjyshit në gjithçka. Zot i madh e i plotfuqishëm, që më shikon nga lart, falmë! Është trupi i tij, janë lëvizjet e tij. Ajo kafshoi fort buzën e poshtme për të përmbajtur rrëqethjen.

Ndërsa përroi po i afrohej honit ku varej poshtë me oshëtimë, djali u përmend papritur dhe pyeti i trembur se mos kishte ndonjë rrezik. Jo, mos ik, iu lut vajza. Nuk ka asnjë rrezik. Çuditërisht, rënkimet e saj i kujtuan gruas së moshuar ëmbëlsinë e një akordi në La minor. Ajo mbylli sytë. Aty pranë po luhej një pothuaj fantazi. Në djall të shkonin të gjitha partiturat e arkivave muzikorë. Si nuk i kishte shkuar mendja ndonjë kompozitori të hidhte në nota atë pothuaj fantazi të vjetër sa të gjithë përrënjtë e botës? Apo e kishin bërë dhe e kishin fshehur nën tituj të tjerë? Me siguri duhej të ishte kjo e dyta.

Shtrati i përroit filloi të ngushtohej. Po afrohej honi i ujëvarës. Vajza filloi të thërriste emrin e djalit, duke iu lutur që ai akt dashurie të mos ishte i fundit. Jo, iu përgjigj ai, nuk do të jetë i fundit. Deti do të jetë miku ynë i madh shpëtimtar. Do të mbërrijmë atje ku jemi nisur me dhjetëra herë nëpër ëndrra.

Gruaja e moshuar hapi gishtat e dridhur të duarve. Jo, nuk ka akord që ta japë mrekullinë e këtij çasti, mendoi. Mbahu, Antuan! Mrekulli të tilla ndodhin rrallë në jetë. Rënkimet e vajzës dhe thirrjet e saj lutëse u zgjatën si oshëtimat e ujëvarës në rënie e sipër, pastaj u zbehën dhe filluan të shuheshin dalngadalë si vrundujt e ujërave malorë që më në fund gjejnë prehje poshtë në fushë.

– Antuan, do të vija me ty deri në ishullin Galapagos, ku jetojnë vetëm breshkat, – psherëtiu vajza.

– Kurse unë deri atje ku fillojnë akujt, – ia ktheu djali.

Oh, pse kaq larg, qeshi gruaja e moshuar duke u

përlotur. Pas pak ajo u kollit.

– Eh, paskam lënë derën hapur, – foli.

– Nona, jemi brenda unë dhe Eta, – ia ktheu i nipi.

Ajo u la edhe ca kohë që ata të visheshin.

– Çantat e shkollës i keni lënë jashtë, – tha pastaj duke hyrë. – Merrini dhe bëjini gati, nëse doni që të ikim! Anijet po mbushen. Për pak orë në to nuk do të ketë më vende. Më besoni.

Gruaja vështroi nga vajza. E skuqur, ajo po qante. I uli sytë me druajtje, ndonëse nuk ishte hera e parë që gjyshja e Antuanit i gjente aty brenda, pas akteve të ngutura të dashurisë.

– Eta, je më e bukur se kurrë, – i foli ajo.

– Falemnderit, nona! Ne menduam se... do të ishte hera e fundit që takoheshim në këtë shtëpi... Antuani... dhe vrapuam shumë...

– E shoh që keni vrapuar. Edhe unë po vrapoja dje. Pashë në ëndërr qytetin tim të vogël të lindjes. Vrapoja nëpër rrugët e tij. Para më doli Klara.

– Klara?!

– Po.

– E si ishte?

– E re. Si atëherë kur formuam grupin. Më pyeti në e kisha bombën me vete dhe unë u zgjova e trembur. Bombën nuk e kisha.

Vajza i buzëqeshi. Gjyshja hapi krahët dhe ato u përqaftuan.

– Nona, do ta marrim mamin me vete? – pyeti papritur Antuani.

– Kam frikë se ajo nuk do të pranojë të vijë, – ia ktheu gjyshja.

Pas ndonjë çerek ore një grua me pamjë të trembur hyri brenda. Kur pa një valixhe të vjetër të së ëmës dhe

çantën e të birit dhe të shoqes së tij të shkollës që po mbusheshin, ajo filloi të qante.

– Jo! Ju lutem, jo! – thirri. – Mama, le të presim përgjigjen zyrtare. Nuk mund të ikim kështu. E shumta nga prilli gjithçka do të ketë përfunduar dhe mund të nisemi me viza.

E ëma e përqafoi për ta qetësuar.

– Jo, Sofi. Nuk i duroj dot më burokracirat. Kam duruar shumë. Do ta presim përgjigjen atje. Ti... vazhdon të jesh e lëkundur?

– Nuk mund ta lë shtëpinë vetëm. Mund të na e marrin. Tjetra buzëqeshi me keqardhje.

– Ke të drejtë. Kjo mund të ndodhë vërtet. Në këtë vend ka kohë që nuk respektohet prona e tjetrit. Gjithsesi, unë do të kthehem shpejt. Atëherë, na përgatit diçka për të ngrënë. Për dhjetë minuta ne nisemi.

Sofia vështroi nga i biri.

– Ma, të lutem, eja! – i foli ai.

– Jo, është më mirë të qëndroj, – foli ajo pa e vështuar. – Do të bashkohemi më vonë. Do të shkoj në kishë të lutem për ju. Mos u trembni, keni gjyshen me vete. Ajo është si Zhanë d’Arka.

Gruaja e moshuar vështroi nga e bija që filloi të vinte rrotull e hutuar.

– Më mirë ulu, – i foli. – Nuk je për gjë.

Sofia iu lut të birit t’i qëndronte pranë. Filloi ta përkëdhelte e ta puthte, pastaj e përqafoi sikur të mos donte ta lejonte që të shkonte. Ndërkohë vajza ishte tërhequr mënjanë dhe e vështroi e prekur. Sofia ndjeu në lëkurën e të birit aromën e huaj të vajzës aty pranë dhe ngriti sytë drejt saj.

– Eta, ti po ikën me leje? – pyeti.

– Mami e di, – u përgjigj vajza.

– Atëherë, shkoni, – tha Sofia gati me mundim. – Mama, të lutem, gjej një anije sa më të madhe e të sigurt.

– Ne do të kemi fatin me vete, – ia ktheu e moshuara, – edhe sikur të marrim barkën më shkatarraqe që lëkundet mbi det.

Ndërsa ata dolën, Sofia qëndroi ca në mes të dhomës duke qarë, pastaj u kujtua për kishën dhe nxitoi pas tyre. Jashtë dukej sikur kishte filluar lufta. Mungonin vetëm sirenat e kushtimit ajror. Nëpër rrugë njerëzit vetëm vraponin, a thua se donin t'i shpëtonin një bombardimi që mund të fillonte nga çasti në çast. Dukej sikur ai qytet e kishte humbur kuptimin dhe nuk kishte më asnjë vlerë. Nëpër rrugë ishin shpërndarë libra shkolle. Njerëzit shkelnin mbi ta.

Në hapësirën e portit ikësit kishin filluar të mësynin anijet si ato hordhitë mesjetare kështjellat. Duke shtrënguar për duarsh gjyshen dhe Etën, Antuani qëndroi para një një anijeje ndëroqeanike.

– I bukur, – tha e moshuara. – Ngjitemi!

Ata zunë vend mes një grupi të madh familjarësh, drejt e mbi kuvertën metalike të anijes. Mbi kryet e tyre shndriste një qiell gënjeshtar marsi, me disa re puplore tek-tuk, që u ngjanin pulëbardhave në një telajo. Deri nën hapat e nxituar të ikësve.

– Kurrë nuk kam për ta kuptuar pse e bënë kaq të urryer këtë vend, – psherëtiu e moshuara. – Për të gjithë. Askush nuk i ktheu përgjigje.

## II

Nga pasditja, ndërsa anija u nis, bluja e qiellit filloi të zbehej.

– Plot 47 vjet, – foli përsëri e moshuara. – Me anije erdha në këtë port dhe me anije po largohem.

Përsëri nuk i ktheu përgjigje njeri. Dy të rinjtë po putheshin e përqafoheshin si shumë të tjerë aty rrotull. Qëndruan në krahët e njëri-tjetrit derisa ra nata. Pastaj gjyshja nxori nga valixhja e saj një batanije.

– Ejani, zogjtë e mi, – tha. – Ngjeshuni pas meje. Nata është e ftohtë dhe e lagësht.

Ata vazhduan të kërkonin me duar, nën batanije, njëri-tjetrin, deri vonë, ndërsa anija çante në det të hapur, kur u duk se djalin e zuri gjumi.

– Nona, të të them një sekret? – pëshpëriti vajza.

– Po të dëgjoj.

– Ty të dua më shumë se teta Sofinë.

– Të jam mirënjohëse, vogëlushe. Tani, a mund të të besoj edhe unë një sekret?

– Fol pa merak. Antuani po fle.

– Paradite... atje te shtëpia... unë ju pashë. Ishit të mrekullueshëm.

– Na pe duke bërë... dashuri?!

– Zoti ju bekoftë dhe më faltë mua mëkataren! Sa bukur ishte.

Vajza u struk nën krahun e gruas.

– Gjyshe, më fal, por...

- Oh, ju kuptova shumë mirë. Si mund të veprohet ndryshe kur nivesh për të marrë detin dhe atje në mes të tij mund të ndodhë...

- Në të vërtetë, këtë nuk guxuam t'ia thoshim njëri-tjetrit.

- Eh, janë ca gjëra që kuptohen pa u thënë. E do shumë tim nip?

- Duhet të bisedojmë për këtë hapur?

- E pse jo?!

- Jam e sigurt se lidhja jonë arrin përtej dashurisë. Unë nuk e di se çfarë vjen përtej dashurisë.

Gruaja e moshuar buzëqeshi.

- Të siguroj se vijnë gjëra tepër tokësore.

- Jo, nuk e besoj.

- Eh, edhe unë nuk e besoja dikur! Vazhdo, më flit për ju të dy!

Vajza kaloi dorën butësisht mbi kokën e djalit.

- Antuani është shpëtimtari im. Më deshi dhe më mbajti pranë në ditët e mia më të vështira, kur më shkante mendja deri te... vetvrasja.

- Jo! Andeta, mos ma thuaj këtë.

Vajza psherëtiu.

- Nona, janë shumë gjëra që ti nuk i di.

- Oh, sigurisht. Por unë di me siguri që ajo nuk ishte hera e parë që ju po bënit dashuri.

Ato qeshën të dyja duke u munduar të mos dëgjo-heshin.

- Pra... ti e kishe kuptuar?

- Vogëlushe, unë i kam shkelur ato rrugë shumë para jush. Sa herë që ju largoheshit nga mësimi dhe vinit në shtëpi, sajoja ndonjë punë. Nja dy herë kam kthyer nga rruga edhe time bijë, që të mos ju gjente aty brenda. Ajo edhe sot e kësaj dite nuk e beson që i biri ka



filluar të bëjë dashuri. I duket i vogël. Sikur do t'ia marrin.

Vajza psherëtiu rishtazi.

– Ne filluam të bënim dashuri nga fundi i vitit të tretë. Ndoshta ishim ndër të parët e klasës që e nisëm atë histori. Ose, më saktë, historia na mori me vete.

– Po prindërit e tu, e kuptuan?

– Mamit i kisha treguar... pjesërisht. Ndodhi një ditë kur ajo më kërkoi të bisedonim. Pandeha se ishte e shqetësuar për mua dhe i fola për Antuanin. Nuk u befasua. E prisja të të ndodhte, tha. E rëndësishme është që ai djalë të të dojë dhe të respektojë. Unë nuk kam ndër mend të të pengoj.

Kaq. Pastaj më tregoi se mund të ndahej nga babi. Nuk reagoja fare. Edhe unë e prisja atë lajm. Marrëdhëniet e tyre ishin kthyer në një sherr sfilites. Nona, të lutem, më kupto! Dua të flas me dikë. Te ty kam besim.

– Të kuptoj. Mos ki turp. Flasim mes femrash. Një vit më e madhe se ty unë jam martuar. Andeta, gjithçka që do të më tregosh është njerëzore.

Vajza u shtrëngua edhe më shumë pas gruas.

– Prindërit e mi kishin kohë që nuk bënin më dashuri. Detyroheshin të shtriheshin bashkë, sepse nuk kishin nga të shkonin. Në divanet e kuzhinës flija unë dhe motra ime e vogël. Kaq është shtëpia jonë, një apartament i qelbur i ndërtuar me kontribut vullnetar.

– Oh, ka edhe më të vogla. Ne e kemi ndarë dhomën me perde.

– E di. Dyshoja se mami kishte filluar ta urrente babin. Nuk pranonte të bënte dashuri me të. Unë dhe ime motër e kuptonim këtë nga... nga...

– Nga krevati shtrembanik që nuk kërciste më.

– Oh, gjyshe!

– E kam vuajtur edhe unë në fëmijëri atë kërcitje

krevati. Antuani po ashtu.

- Zakonisht ndodhte të shtunave.

- Kuptohet. E shtuna është dita e higjienës. Lahen të gjithë.

- Kur isha e vogël, ato kërcitje krevati më acaropin aq shumë, sa e detyroja motrën tjetër të qante, që prindërit t'i jepnin fund aktit të dashurisë. Ishte një lloj hakmarrjeje idiote. Kur motra qante, kërcitjet e krevatit dhe rënkimet e tyre dëgjoheshin më pak. Pastaj u rrita dhe e kuptova se ishte budallallëk të turpëroheshe nga një gjë aq normale. Radha i erdhi sime motre që më kërkonte një shpjegim.

Por një të shtunë kërcitjet dhe rënkimet nuk u dëgjuan më. As të shtunave që pasuan. Çuditërisht, fillova të vija re te mami shenja gjallërimi dhe lumturie të papritur. Disa herë e kapa duke folur me vete e duke buzëqeshur. Një ditë, para se të dilte, ajo hodhi një parfum marramendës dhe për herë të parë unë dyshova se kishte filluar të tradhtonte babin.

- Po ai, dyshoi?

- Fare. Atij as nuk i shkonte nëpër mend se një grua shqiptare, përfaqësuese e denjë e klasës punëtore, t'ia dridhte burrit. Ai ishte sekretar partie. Jetonte në një botë të gënjeshtërt librash që tregonin përralla për komunizmin. I besonte ato përralla dhe ato e morën më qafë, siç morën më qafë Don Kishotin romanet kalorsiakë. Edhe librat lëkan viktima pas.

- Unë mendoj ndryshe.

- Si?

- Faji nuk i është i librave mbi komunizmin, por i atyre që i lexuan dhe i besuan. Shumica as nuk i lexoi e as nuk i besoj kurrë, pavarësisht se i mbante në pjesën më të dukshme të shtëpisë. Këta përbëjnë kategorinë e

të zgjuarve dhe dinakëve.

Ndoshta. Im atë kërkonte që përrallat me komunizëm t'i besonim edhe punëtorët e uzinës ku punonte dhe ne të familjes. Ishte i bindur se ato gënjeshtër do të bëheshin së shpejti realitet. Nona, nuk e di a më kupton?

– Të kuptoj shumë mirë.

– Por një ditë mami i përplasi para këmbëve një vepër të Leninit dhe i tha se ishte i marrë. Babi u tërbua. Jo edhe aq nga fakti se e shoqja e kishte quajtur të marrë, por nga libri i Leninit që përfundoi në dysheme. Filloi ta godiste mamin ku të mundte. Ishte hera e parë që bëhesha dëshmitare në një skenë të atillë. Mbeta e mekur. Babi nuk ishte tip i dhunshëm. Kurrë nuk ka qenë.

– Ndërhyre?

– Jo. Mami nuk më lejoi. U mbrojt vetë. Heroikisht. Dhe e kërcënoi babin se ndonjë ditë do t'i gjente librat e tij të marksizëm-leninizmit poshtë, në rrugë. Kështu mund të flasin vetëm armiqtë, iu çorr ai. Por mami vetëm qeshi me tallje dhe doli nga shtëpia.

Në atë shtëpi aq të vogël kishim shumë vepra të klasikëve të marksizëm-leninizmit. Edhe portretet e tyre janë ende atje, në korridor. Kjo ishte arsyeja kryesore që më vinte turp ta ftoja Antuanin në shtëpi. Erdhi një ditë që ata libra më provokonin të vjella kur i shikoja. Ne, në klasë, duke filluar nga unë dhe Antuani, nuk besonim më te marksizmi. Vetëm talleshim me citatet pa fund të klasikëve. Të jetosh mes urisë dhe mjerimit dhe të të mësojnë në shkollë se si një ditë në botë do të triumfojë komunizmi, kjo e kapërcente talljen. Ndaj edhe ne filluam të talleshim me ata që na tallnin. Zakonisht iknim me Antuanin nga ora e Marksizmit dhe vinim atje, te ju, për të bërë dashuri.

– Posi, më kujtohen mirë ditët tuaja të preferuara.

Gjyshja tërhoqi batanijen mbi supet e veta dhe të vajzës, pastaj mbuloi me një pjesë të saj të nipin. Vështroi për pak çaste drejt qiellit.

– Duket sikur Hëna po nxiton drejt një takimi dashurie, – tha.

Edhe vajza i ngriti sytë lart. Të shtyra nga era, shtëllunga resh, me pamje shpendësh të frikshëm, që ngjanin sikur po kacafyteshin me njëri-tjetrin, largoheshin vrulltazi drejt lindjes, duke kaluar para profilit rrumbullak të Hënës, e cila shndriste zbehtë, me pamjen e një vajze që fshihet pas perdes së dritares. Poshtë saj, kuverta e anijes i ngjante një oborri kishe në natën e së Premtes së Zezë. Rrotull ngrihej dhe shuhej jehona monotone e zhurmës së dallgëve.

Gruaja përkëdheli flokët e vajzës.

– E lamë te...?

– Pastaj, pas mamit, më erdhi radha mua të villja neverinë për veprat e klasikëve. Një ditë babi më pyeti pse nuk po filloja të lexoja veprën e fundit të Udhëheqësit, të cilën ai sapo e kishte prurë në shtëpi. Iu përgjigja me sinqeritet se kisha dhjetë ditë pa ngrënë një gjellë me mish dhe se ato që shkruante Udhëheqësi dhe klasikët e tjerë të marksizëm-leninizmit ishin gënjeshtër. Ai mori pamjen e një njeriu që dëgjon gjënë më të pabesueshme në botë.

– Ti nuk beson në këto vepra të çmuara?! – thirri.

– Jo, – iu përgjigja qetësisht, duke e vështruar drejt e në sy.

Atëherë ai mori një libër në frëngjisht, të cilin unë po e lexoja ato ditë dhe filloi të më godiste me të kokës duke ulërirë:

– *S'të pëlqejnë veprat e klasikëve ty, ë? Do nga këta romanet me dashuri? Brez pa bosht! Brez i infektuar nga*

*propaganda borgjezo-revizioniste!*

Mami ndërhyri të më mbronte.

*– Mos e prek vajzën! – iu drejtua babit kërcënueshëm. – Do ta shohim shumë shpejt ku do të të çojë marrëzia e atyre librave.*

Që nga ajo ditë marrëdhëniet e mia me babin u ftohën deri në një përshëndetje fare të thatë. Shpesh e kaloja mbrëmjen te nënëdaja dhe flija atje. Kur ai ndodhej në shtëpi, shkoja te ndonjë shoqe ose vija te ju. Ajo që koha kur fillova të bëja dashuri më shpesh me Antuanin. Më dukej sikur çliroheshja dhe hakmerreshja. Mjaftonte një vështrim i tij dhe unë isha gati t'ia mbathja nga mësimi. Nxitonim për në shtëpi dhe sapo hynim brenda, lëshoheshim ku të mundnim, pa pyetur për asgjë tjetër rreth e rrotull.

– Ti... nuk kishe frikë?

– Në fillim, jo. Isha fare naive. Antuani edhe më shumë se unë. Por na ruajti fati. Pastaj, një shoqe, që ishte e fejuar me një student të Mjeksisë, më solli një revistë italiane ku flitej për problemet e marrëdhënieve seksuale dhe atëherë ne të dy e kuptuam se vinim nga Epoka e Akullnajave.

Gjyshja qeshi.

– Pse qesh?

– Ashtu, qesh me veten time. Po me Antuanin, si u njohe?

– Ai erdhi te ne në vit të tretë, pas një shkrirjeje klasash. Deri atëherë ishim përshëndetur rrallë. Unë dija që Antuani kishte një gjyshe të huaj, prindër të divorcuar, që lexonte dhe notonte shumë. Kaq. Nganjëherë më dukej tip që ne nuk e kuptonim dot. Edhe ai na dukej si i huaj. Sikur jetonte në një botë tjetër, ku ne nuk arrinim dot. Sidomos kur fliste frëngjisht ose italisht.



Unë fillova ta vështroja fshehurazi. Ndoshta u dashurova me të shumë më parë se ta kuptoja këtë gjë. Deri sa, një pasdite, kur u takuam në bibliotekën e qytetit, ai më kërkoi të më shoqëronte deri në shtëpi. Unë pranova pa e zgjatur. E cila nga shoqet e mia nuk do të pranonte! Rrugës ai më pyeti se pse në klasë e vështroja fshehurazi. U skuqa. E kuptova se ai e kishte kapur atë detaj. Isha e sflitur nga ato që po ndodhnin në shtëpi, ndihesha e braktisur, e vetmuar. Ndala, e vështrova drejt e në sy dhe iu përgjigja:

– Ti më pëlqen.

– *E pse? – më pyeti ai.*

– Këtë nuk di, – i thashë.

Antuani buzëqeshi dhe, për habinë time, më bëri të ditur se edhe ai mendonte se unë kisha diçka të veçantë që atë e tërhiqte. Në fillim m'u duk se po tallej.

– E cila qenka e veçanta ime? – e pyeta.

– *Mënyra sesi e flet frëngjishten, – qe përgjigja.*

Frëngjishtja ishte lënda që doja më shumë, që nga klasa e pestë.

– Antuani nuk ka gabuar, – tha gruaja. – Këtë detaj e kapa edhe unë kur folëm për herë të parë bashkë në frëngjisht. E folura jote është vërtet perfekte.

– Ndoshta kam ndonjë defekt në hundë.

– Pse të mos themi se je lindur për të jetuar andej nga flitet frëngjisht?

Ato qeshën të dyja.

– Që nga ajo pasditja e bibliotekës nuk u ndamë më. Isha gati të përshkoja në këmbë një shkretëtirë të tërë, vetëm me një gllënjë ujë, për të mbërritur si një deve heroinë beduinësh të Antuani dhe për të ndenjtur me të. Shumë shpejt filluam të bënim të gjitha marrëzitë e mundshme.



Një ditë, pa e patur mendjen, u puthëm në oborrin e shkollës dhe një sekretare rinie na spiunoi te drejtoresha. Ajo, një bolshevike e betuar, na kërcënoi me përjashtim.

*– Nuk mund të ndodhin shfaqje të tilla të huaja në shkollën time socialiste! – thirri.*

Pastaj na kujtoi mua faktin se isha bija e një sekretari partie, kurse Antuanit familjen e tij reaksionare.

Antuani nuk u besoi veshëve.

*– Drejtoreshë, nuk e keni marrë vesh se është shembur Muri i Berlinit? – i foli me tallje.*

*– Mund të shembet në Berlin, por jo këtu te ne, – ia ktheu ajo kërcënueshëm.*

Por një ditë, në orën e Marksizmit, që e zhvillonim me drejtoreshën, ne grisëm librat dhe filluam të thërrisnim në kor: poshtë komunizmi. Pas ndonjë jave drejtoreshën e larguan nga shkolla jonë.

Ndërkohë, një mësuese, që kryente detyrën e sekretares së partisë së shkollës, nuk mbeti prapa. U takuam me tim atë në një plenum idiot dhe i tregoi atij për historinë time të dashurisë. Babi erdhi në shtëpi i xhindosur. Nuk ishte trembur edhe aq nga aventurat e mia, sesa nga biografia e Antuanit.

*– Mos guxo të shoqërohesh më me atë djalë! – më paralajmëroi.*

Në ato çaste e urrevë. Pasatj m'u kujtua mësimi i Biblës "Respektoje prindin tënd" dhe ndjeva për të keqardhje. Ishte...

*– Naiv. Tmerrësisht naiv, – ndërhyri gruaja. – Idealist i pandreq-shëm.*

Vajza ngriti sytë nga e moshuara dhe nën ndriçimin e zbehtë të njërit prej farëve të anijes ato u vështruan të menuara.

*– Nona, po ti nuk e ke njohur!*

- Gabohesh, e njoh shumë mirë.

- Ke pyetur për të?

- Jo.

- Po atëherë?!

- Vazhdo, zemër. Do të flasim për këtë.

- Iu përgjigja se do të shoqërohesh me Antuanin edhe sikur ai të më dëbonte nga shtëpia. Tek më vështronte, babi nuk u besonte syve. Pyeste veten se si mund të përfundonte ashtu vajza e një njeriu të ndershëm, tmerrësisht të ndershëm, vajzë e rritur mes veprave të klasikëve të marksizëm-leninizmit, mes një morali të fortë socialist, në një mjedis ku nuk depërtonte dot asnjë rreze nga bota e degjeneruar borgjezo-revizioniste.

- *Mos u pataks kështu, - i foli mami, = është thjesht një miqësi adoleshentësh. Por ty të ka mbetur ora te Plenumi IV. Pika që s'ju bie me gjithë plenumet tuaja! Njerëzit po mbahen gjallë duke ngrënë dhjamin e tyre, kurse ju vazhdoni me plenumet. Mos guxo t'i flasësh më vajzës për këtë problem! Qoftë edhe sikur të shoqërohet me nipin e mbretit Zog!*

Babi u tërhoq në dhomën prindërore i shushatur. Mami më vështrroi e përlotur.

- *Eta, të lutem tregohu e vëmendshme kur... - më porositi.*

- *Sa për ato biografite, mos e çaj kokën!*

Ndërkohë ajo vazhdonte ta tradhtonte babin. I kuptoja ditët e tradhtisë nga parfumi i shtrenjtë që hidhte. Fillova ta urreja edhe atë. M'u duk sikur po kërkonte një aleancë të heshtur me mua për ato që po ndodhnin. Por një ditë unë e mbërtheva për krahu në korridor sa ajo u rrëqeth.

- Ma, ku po shkon? - e pyeta.

- *Të takoj një njeri, - m'u përgjigj ajo. - Që... e dua. E kam dashur prej vitesh, që kur isha në moshën tënde. Por...*

*nuk më lejuan të lidhesha me të. Dhe a e di pse?*

Pas asaj pyetje ajo më vështroi gati me inat.

*– Për biografinë e tij! – thirri duke më tundur grushtin para fytyrës.*

Unë ia shtrëngova krahun edhe më fort.

*– Ti nuk mund t'ia bësh babit këtë! Unë nuk të lejoj!*

*– Ti... nuk më lejon? Të lumtë! E prisja këtë qëndrim.*

*Por... unë dhe babi jemi gati të ndarë. Unë... do të largohem nga kjo shtëpi. Ti tani je e rritur dhe duhet të më kuptosh. Nuk mundem të jetoj më dot me atë njeri. E kam duruar gjatë. Po pres lejen e njerëzve të mi për t'u ndarë.*

Unë ia lëshova krahun duke u dridhur dhe fillova të qaja e trembur.

*– Ma, të lutem, mos na e bëj këtë! – i fola. – Mbase gjërat do të ndryshojnë.*

Ajo më vështroi përmes lotëve.

*– Por nuk do të ndryshojë fakti që nuk e dua, – tha.*

*– Por na do mua dhe time motër! – u ngashëreva unë.*

Ajo më përqafoi.

*– Të paktën mos e tradhto pa e ndarë zyrtarisht, – vazhdova unë. – Nuk është e ndershme. Sado i humbur që të jetë babi im, ndaje njëherë, pastaj shko me atë tjetrin. Ndryshe...*

Ajo filloi të qante mbytur dhe u kthye mbrapsht.

Gjyshërit dhe daja nuk e lejuan të ndahej nga babi. E bindën se me atë njeriun tjetër nuk kishte asnjë të ardhme përderisa në mes ishim unë dhe ime motër. Ajo nuk e hodhi më parfumin e shtrenjtë.

Ndërkohë, babi po shushatej për ditë e më shumë. Një mbrëmje u kthye në shtëpi i zverdhur dhe i mbaruar. Gjatë një mbledhjeje në uzinë, punëtorët kishin filluar ta shanin dhe ta godisnin me veprat e klasikëve që ndodheshin në një raft aty në sallën e mbledhjeve. Gjithçka

kishte marrë fund. Ata nuk ushqenin më dot fëmi-jët e tyre, kurse im atë u bënte thirrje që të kishin besim te partia.

Atë mbrëmje ai fliste me vete. Çuditej se si mund të përfundonte ashtu klasa jonë e lavdishme punëtore, shtylla kryesore e socializmit. Nuk e besonte dot.

Një javë nuk doli nga shtëpia. Iu shfaq për herë të parë diabeti dhe disa herë pati luhatje të frikshme tensioni. Ndërkohë, pjesën më të madhe të punëtorëve të uzinës i nxorën në asistencë. Kulmi që kur edhe babin e njoftuan se edhe ai kishte dalë në asistencë. Ndërsa nga detyra e sekretarit të partisë e kishin shkarkuar, sepse disa djem të rinj, që punonin në uzinë, ishin arratisur.

Atë ditë ai m'u dhimbs përtej çdo këshille të Biblës. I qëndroja në këmbë para krevatit për t'i shërbyer. Nuk ndieja asnjë lloj mërie. Atë...

– ... e përdorën sa deshën të vetët dhe në fund e tallën dhe e braktisën.

– Po. Këto mendoja tërë kohën. Komunistët janë një racë e pabesë.

– Gabohesh, vogëlushe! Jo të gjithë. Janë vetëm ata që shtiren si komunistë, që përfitojnë nga komunizmi dhe që komandojnë. Mes... nesh... kishte edhe shumë idealistë, njerëz të ndershëm deri në vuajtje.

– Nona... po ti?!

– Prit njëherë! Vazhdo, më trego.

– Gjatë atyre ditëve që shkonin si ajo era pa asnjë drejtim, e cila vetëm ngre pluhur gërricës dhe të acaron, unë e kuptova se kush ishte Antuani për mua. E kisha marrë vesh se ju po përgatiteshit për t'u larguar nga Shqipëria dhe më dukej se do ta humbja. Ndonëse ai më kishte premtuar se nuk do të largohej kurrë pa mua, kisha frikë. Doja t'i jepja më shumë. Gjithçka kisha

më të shtrenjtë. Që nëse ndaheshim...

Një mëngjes maji i kërkova të mos shkonim fare në shkollë. Ai pranoi. Erdhëm te ju. Të gjetëm në shtëpi ty, që nuk vonove të merrje shportën e famshme prej kashte dhe të niseshe për në pazar, ndonëse atje nuk kishte asgjë për të blerë. Me t'u mbyllur dera, u zhvesha para Antuanit, që më vështronte i hutuar dhe iu luta të bënim dashuri. Ai në fillim u tremb, por nuk pranoi ta jepte veten. Ishim të dy aq të paditur, sa tani më vjen për të qeshur. Megjithatë...

– ...ia dolët në një farë mënyre.

– Po. Në një farë mënyre. Pastaj, tërë ai djalë, 1 metër e 85 centimetra i gjatë, që mund të kalonte me not La Manshin, pa u ndalur, ndërsa vështronte mes kofshëve të mia, u zverdh dhe mend i ra të fikët. Eta, diçka po ndodh, mërmëriti.

Gjyshja filloi të qeshte duke shkundur supet.

– Im nip kështu?! Jo!

– Iu luta të më gjente ndonjë leckë të pastër dhe ai grisi një nga kanotjeret e tij. U sajova me të deri sa mbërrita në shtëpi. Antuani më shoqëroi. Më pyeste kohë pas kohe si ndihesha dhe çfarë do të ndodhte paskëtaj, sikur të ishte fjala për ndonjë rrjedhje tjetër nukleare të Çernobilit. I përgjigjesha se e doja shumë. Kur mbërritëm te pallati, iu luta që të shkonte në shkollë. Ai pranoi.

Por nga mesdita e dëgjova të fërshëllente poshtë ballkonit sinjalin tonë me pak nota nga një këngë e Mirelë Matjësë. Dola. Ai po priste i shqetësuar. Më pyeti me shenja a kishte pasur stop. Stop, iu përgjigja edhe unë me shenja, pastaj i buzëqesha për ta qetësuar. E kuptova nga buzët që më tha disa fjalë të ëmbla në frëngjisht. Iku i lumtur, por edhe i mbushur me një krenari naive

mashkullore, që një femër i kishte dhuruar virgjërinë. I ngjante një jeniçeri të trimëruar befas, që ka hyrë i pari në kështjellën e armikut dhe pret nga pashai i tij dekorata e shpërblime.

Gjyshja qeshi përsëri.

– Nona, virgjëria është ende e çmuar.

– Po. Dhe ashtu duhet të jetë. Po hymë në një botë ku ka shumë gjëra për të dhënë dhe fare pak për të ruajtur.

– Copën e kanoqjeres së tij e ruajta të paprekur, si idiote. Në rast se ju do të iknit nga Shqipëria, do të kisha të paktën një kujtim. Ajo është ende atje, në sirtar, mes ndërresave prej pambuku të cilësisë së fundit.

– Oh, zemër! Detaj vërtet poetik. Nuk do të jetë e largët dita kur për atë copë lecke do të shkruash një nga poezitë e tua më të bukura.

Vajza fshiu një gjurmë loti që po i thahej në faqe.

– Eh, ja kështu. Pastaj yt nip nuk u tremb më dhe ne vazhduan të bënim dashuri ku të mundnim. Një ditë vere ndodhi brenda në det.

– Jo!

– Ishim të lumtur, nona. Dhe kur dy njerëz janë të lumtur, mund të bëjnë dashuri edhe në majë të çatisë.

Tjetra u kollit.

– Vërtet thua?

– Më fal, nona! E tepërova më duket.

– Mbase do t'i kthehemi prapë asaj punës së çatisë. Eta, që në takimin tonë të parë unë e kuptova se ti e doje tim nip marrëzisht. Më vinte mirë për atë dashuri. Kur Antuani më kërkoi të lidhej me ty, i thashë se kisha vetëm një kërkesë: vajza të ishte nga një familje e varfër dhe komuniste. Në fillim ai shqeu sytë, pastaj mori frymë i lehtësuar.

– Nona, në këtë vend janë të gjithë të varfër, – tha.



– Shumë shpejt do të ketë edhe të pasur, – ia ktheva.  
– Madje shumë të pasur.

– *Kurse babai i saj është sekretar partie, – vazhdoi ai.*

– Vërtet i kërkoje që të lidhej me një vajzë të varfër dhe nga familje komuniste?!

– Habitesh?! Nuk duhet, vogëlushe. Do të kemi kohë të bisedojmë shumë gjëra. Italia është ende larg. Po më tej, si shkuan marrëdhëniet e tua me babanë?

– Ai nuk e mblodhi dot veten për shumë kohë. Kur mbetëm keq fare ekonomikisht, daja e ftoi të punonin bashkë në shtëpinë e tij me oborr, ku kishte hapur një dyqan primitiv shumice. Bashkë me një shok, sillte mallra ushqimorë dhe sapun nga Bullgaria, mes rreziqesh dhe telashesh pa fund. Babi mori përsipër mbarëvajtjen e dyqanit kur ata të dy ndodheshin në udhëtim.

– *Ju komunistët e urrreni pasurinë dhe lekun, – i tha daja. – Por kur fiton me djersë dhe ndershmëri, bota të duket ndryshe. Shefat e tu dhe njerëzit e besuar të regjimit do të bëhen të pasur. Dije mirë këtë! Kështu po ndodh edhe në Rusi e Bullgari. Viktimat do të jeni përsëri ju, besimtarët e palëkundur të komunizmit. Shefat gjithmonë kanë pasur nevojë për viktime. Besimtarët si ti dhe ideologjia kallpe u duheshin për të mbajtur sa më gjatë pushtetin. Një ditë do të bindesh për këtë dhe uroj që ajo ditë të mos vonojë.*

Babi filloi të punojë nga mëngjesi në darkë, pa i ngritur sytë drejt njerëzve, pa u ndier, ende i tronditur pas tërë atyre që kishin ndodhur. Kishte qenë një njeri që nuk kishte përfituruar pothuaj asgjë nga detyra e tij partiake. Nuk kishte lënë aksion, pallat me kontribut e punë vullnetare pa marrë pjesë. Edhe kur i erdhi rasti për të marrë një apartament të madh për vete, nuk pranoi, sepse në uzinë kishte të tjerë më nevojtarë se ai. Mami nuk ia fali atë lloj zemërgjerësie prej komunisti të devot-

shëm. Aty filloi krisja dhe ftohja e tyre e madhe.

Por këto javët e fundit, ndërsa babi kthehej në shtëpi dhe linte mbi tryezë ushqime apo para të fituara në dyqanin e shumicës, para nga të cilat nuk mbante për vete asgjë, situata filloi të ndryshonte. Ai nuk bëri asnjë lloj kundërshtimi kur mami futi në ca thasë plastike veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe portretet e tyre. Më kërkoi edhe mua ta ndihmoja që t'i hidhnim të plehurat e lagjes.

*– Sa keq, – më tha kur po i zbrisnim thasët poshtë, – me lekët e tërë këtyre librave do të kisha blerë një dhomë të re gjumi. Tani letra nuk shitet as me kile.*

Një natë, nga dhoma prindërore u dëgjuan përsëri kërcitjet e sustës dhe të dërrasave të krevatit dhe unë, për herë të parë, nuk u trazova. Përkundrazi, ndjeva lehtësim. Martesa e tyre po shpëtonte. Ndërsa motra e vogël, që kishte ndenjtur tërë kohën e aktit të dashurisë me veshët mbyllur, më pyeti papritur:

*– Eta, deri në ç'moshë bëjnë njerëzit dashuri?*

*– Ma ha mendja deri në të tetëdhjetat, – iu përgjigja duke u munduar të mos qeshja. Ajo u kthye nga mua e tmerruar dhe nuk foli.*

Të nesërmen, ndërsa po nisesha për në shkollë, mami më pyeti për Antuanin. Donte të dinte nëse lidhja jonë do të zgjaste. Po, iu përgjigja duke u munduar të tregohesha sa më bindëse.

*– Për mua rëndësi ka që ti të jesh e lumtur, – tha ajo me një pamje të lodhur. – Një dashuri e nisur, duhet jetuar deri në fund, ndryshe të shkatërron. Është si të jetosh nën një çati që pikon sa herë bie shi. Eta, po t'u dha rasti, ik nga ky vend! Fillo një jetë ndryshe nga e imja. Në këtë botë vetëm një herë jetohet.*

Iu përgjigja se Antuani më kishte premtuar të më

çonte në vendin e gjyshes së tij. Ajo më vështroi gjatë dhe u përlot papritur.

– *Eta, të dua shumë, – tha.*

– Edhe unë, – iu përgjigja.

– *Me gjithë ato... që ndodhën?*

– Rëndësi ka që tani e tutje ti dhe babi...

– *Do të jetojmë si t'i vijë. Mos u shqetëso.*

Atëherë i tregova se pritej të ndodhte një mrekulli me anije. E porosita që, nëse ikja papritur, t'i thoshte babit se nuk i mbaja asnjë mëri. Ajo pohoi në heshtje.

Nona, tani që kjo anije po na çon larg, ndiej mall për babin.

– Natyrisht, vogëlushe. Ai është babai yt. Ti do ta kuptosh më vonë atë njeri. Atëherë do ta duash edhe më shumë.

### III

Ndërsa filloi të binte një shi i imët, ato u shtrënguan edhe më pranë njëra-tjetrës. Mes errësirës pa fund dëgjohej vetëm zhaurima e dallgëve. Antuani flinte pështetur në prehërin e gjyshes, i mbledhur kruspull nga të ftohtit.

– Ka qenë një natë korriku e vitit 1943 kur e bëra këtë udhëtim me det në drejtim të kundërt, – foli pastaj e moshuara pas një psherëtime të gjatë.

– Antuani më ka treguar disa gjëra, por...

– Jo, Antuani nuk e di të vërtetën deri në fund. Gjithçka nisi nga dashuria ime për komunizmin. Vogëlushe, unë kam qenë komuniste. Hyra në partinë komuniste që në moshën 16 vjeçe. Jetonim në një qytet të vogël të Belgjikës. Vend minatorësh prej vitesh e vitesh me radhë. Im atë ishte sindikalist. Nga më të flaktët. Mbrëmjeve mblidhej me shokët në shtëpi dhe diskutonin për komunizmin. Lexonin libra deri vonë.

Unë i dëgjoja. Herë pas here merrja librat e tyre, por leximi më lodhte shpejt. Idenë e parë për komunizmin e krijova nga tregimet e tim eti. Oh, ishte si një përrallë. Rrëfim Bible. Bota do të bëhej një mrekulli. Minatorët s'do të guxonin t'i shfrytëzonin më si kafshë pune. Punëtorët do të ishin njerëzit më të lumtur të planetit, kurse pasanikë nuk do të kishte më. Ata parazitë do të punonin si gjithë të tjerët. Të gjithë do të ishim të barabartë. Fëmijët do të ishin më të lumturit. E thënë shkurt, një

variant i përrallës së Hirushes. Dhe këtë parajsë tokësore do ta sillnin komunistët. Madje ajo kishte filluar të ndërtohej në Bashkimin Sovjetik.

Kur e dëgjova për herë të parë këtë përrallë, unë isha vetëm 12 vjeçe. U rrita me të. Atëherë komunizmi ishte në modë mes të rinjve, si të gjitha gjërat e reja të paprovuara.

Pasi tim atë e vranë në një demonstratë, unë hyra në partinë komuniste. Motra ime e madhe e quajti atë gjë një marrëzi dhe më këshilloi të mos përzihesha me politikë, sepse nuk isha tip i prerë për atë lloj feje pa Jezu Krisht. Kështu e quajti ajo komunizmin.

*– Bjeri edhe ca kohë pianos, pastaj gjej një burrë, martohu dhe të tjerat t'i mëson jeta, – kështu më këshilloi. – Nëse burrit tënd nuk do t'i pëlqejë muzika, lëre edhe pianon.*

Ajo ishte një tip për të cilën unë dyshoja shpesh në e kisha motër vërtet. Nuk ishte e bukur, por kishte një paraqitje tepër serioze dhe të fisme. E dinte me saktësi se çfarë kërkonte. U martua me një burrë në gjendje të mirë, i cili kishte një dyqan të vogël ushqimor dhe filloi të shikonte jetën e saj, pa pyetur për gjithçka kishte lënë pas.

Kur unë i thashë një ditë se kishte tradhtuar idealet e babait tonë, ajo qeshi me tallje.

*– Për babanë mund të flisnim po të na kishte lënë ndonjë trashëgimi, – tha. – E ç'më duhen idealet e tij të së ardhmes së ndritur komuniste kur ai më nisi te burri me një fustan? Unë jetoj të sotmen, motër e dashur. Madje i urrej edhe fjalitë në kohën e ardhshme.*

Mbeta vetëm me nënën, e cila filloi të punonte në një sektor tepër të vështirë e të ndotur të minierës vetëm e vetëm që unë të vazhdoja shkollën. Ëndërroja të studioja për piano. Nuk shquhesha për ndonjë talent të veçantë,

por isha këmbëngulëse. Eh! Pikërisht këmbëngulja nuk i duhet muzikës. Talentin ua fal Zoti pak njerëzve. Mua nuk ma fali. Dhe më mirë që s'ma fali, se do të më kishte shkuar dëm.

Kisha filluar të luaja në piano që e vogël. Gjithçka nisi kur një mëngjes vere çova qumështin në vilën e zonjës Klodetë, diku në periferinë e bukur të qytetit tonë. Ajo po luante në piano dhe unë u meka. Zonja e kapi atë detaj dhe më uli para tastierës. Ishte një mre-kulli. Ajo më pyeti nëse doja të mësoja të luaja. Pranova pa shumë ceremoni. Fillova të merrja leksione në shkëmbim të punëve të ndryshme që bëja në vilë.

Oh, e shtrenjta zonja Klodetë! Ajo kishte ardhur në këtë botë për të vendosur fatin tim. Po të mos isha magjepsur pas pianos dhe të mos kisha shkelur në shtëpinë e saj, gjërat do të kishiñ rrjedhur ndryshe. Mbase më për keq... Mbase...

Lufta dhe ardhja e gjermanëve përmbysën gjithçka. Unë hyra në një grup komunist të rezistencës. Partiturat e pianos filloi t'i mbulonte pluhuri. U detyrova ta braktisja konservatorin që në vitin e parë. Ndoshta lufta dhe aktiviteti komunist qenë shfajësime për mungesën e talentit. Tani që i vështroj gjërat në largësi, e besoj këtë. E kisha kuptuar se e shumta do të dilja një mësuese muzike dhe kaq.

Grupi ynë komunist drejtohej nga një tip që mua më magjepsi më keq se pianoja me trimërinë dhe guximin e tij. Quhej Ludvig. Ishte më i madh se ne pjesëtarët e tjerë të grupit dhe mësuam se kishte ardhur në qytetin tonë për të organizuar rezistencën dhe për të krijuar sa më shumë grupe si yni. Ta dëgjoje atë kur fliste për komunizmin ishte sikur në veshë të kumbonte një sinfoni. Ne e besuam verbërisht. Të gjithë. Tetë pjesëtarë të grupit,



pesë djem dhe tri vajza. Ishim të rinj, gati për t'u flijuar. Filluam të kryenim aksionet e para kundër gjermanëve, pa e kuptuar se në ç'rrugë ishim futur.

Ndodhi që atë verë të vitit 1943 në qytetin tonë të vogël ia mbërriti gjyshi i Antuanit, i shkruari i madh i fatit tim. Ai kishte studiuar në Paris për drejtësi bashkë me Lysienin, djalin e zonjës Klodetë. Kishin qenë shokë të ngushtë. Pas disa punëve të veta në Itali, gjyshi i Antuanit u hodh për të bërë disa ditë pushime në shtëpinë e shokut të tij. Lysieni po e priste prej kohësh. Nuk ishte hera e parë që ai vinte mik në atë shtëpi.

– Gjyshin e Antuanit e quanin Vegim, kështu?

– Po.

– E kam parë shpesh nëpër fotografitë e vjetra të familjes suaj.

– Dhe?

– Ta them pa hile?

– Sigurisht.

– Nuk do të kishte femër që të mos dashurohej pas tij. Antuani i ngjan tmerrësisht.

– Oh, vogëlushe! Nuk gaboresh. Ai u shfaq si një vegim në jetën time, siç kishte emrin. Isha 15 vjeçe kur e takova për herë të parë. Atëherë ishte student. Erdhi të kalonte pushimet verore te Vila e Blireve.

– Te zonja Klodetë?

– Po. Ashtu njihej në qytet ajo vilë me dy blire gjigantë anash. Një pasdite unë po i bija pianos në dhomën e madhe të zjarrit kur ai hyri papritur. Nuk e ndjeva. Kishte qëndruar pas meje dhe po dëgjonte. U përmenda vetëm kur ai duartrokiti. E mora me mend se kush duhej të ishte. Zonja Klodetë më kishte kërkuar ta pastronim shtëpinë cep më cep se do t'ia mbërrinte një mik i veçantë. U ngrita dhe u skuqa vetiu tek qëndroja

përballë tij. Mendimi i parë që më shkrepri në kokën time prej adoleshenteje ishte ta përqafoja.

Atë natë mezi munda të fle.

Tërë ato ditë që ai ndenji te Bliret iu bëra hije. E vështroja fshehurazi. Mezi prisja që të kthehej bashkë me Lysienin nga një pyll i madh jo shumë larg qytetit ku shkonin për të kalëruar. Madje, një pasdite me vapë, guxova dhe hapa derën e dhomës ku ai po flinte. Fillova ta vështroja si idiote. U dashurova me të që ditën e tretë të qëndrimit të tij te Bliret. Ti e di, dashuria e adoleshenteve është si ajo flaka që djeg pyjet, duke ndezur fillimisht kurorat e pemëve me një shpejtësi të frikshme. Nuk mund ta përcaktoj sa ndenja e ngrirë, duke e parë. U largova vetëm kur ai lëvizi i bezdisur nga një mizë.

Gjyshi i Antuanit e kuptoi mirë atë që po ndodhte me mua dhe u mundua të mos më ushqente asnjë lloj iluzioni. Më konsideronte fëmijë. Veç kësaj, kishte kodin e tij fisnik të sjelljes. Kishte ardhur mik te Bliret dhe nuk mund të ngatërrohej me një vajzë që punonte aty dhe ishte gati si pjesëtare e familjes.

– Po ai... nuk ndjeu gjë për ty? – pyeti vajza.

– Ndjeu, sigurisht. Por nuk e shfaqti. Vogëlushe, nuk është koha tani që unë të lavdërohem, por...

– Nona, ti je ende e bukur. Kur shoh fotografitë e tua të viteve të para të martesës, më duket vetja kot fare. Seç kanë ca hire të papërsëritshme femrat e brezit tënd. Një lloj fisnikërie që tani duket sikur po humbet. Nuk jam në gjendje ta shpjegoj veçantinë. Nuk di...

– Mbase nga kjo histori do të kuptosh diçka, vogëlushe. Para se të largohesh, gjyshi i Antuanit më kërkoi të luaja në piano për të. M'i puthi të dyja duart duke më falënderuar dhe kaq. Por ndërsa ai ishte gati me valixhet te këmbët, te dera e dhomës së miqve, unë për-

fitova nga heshtja e katit të dytë të shtëpisë dhe u ngjita vjedhurazi. Vrapova drejt tij dhe iu hodha në krahë si e çmendur. I pëshpërita në vesh një "Të dua", që nuk e kuptova se si doli nga fyti im, pastaj u zhduka në një dhomë, duke mbyllur derën. E pashë nga dritarja kur ai u largua. Prita që të kthente kokën, por kjo nuk ndodhi.

Një ditë, gjoja rastësisht, pyeta zonjën Klodetë se kur mund të vinte përsëri miku nga Shqipëria. Ndoshta për pushimet dimërore, m'u përgjigj ajo. Por ai nuk u duk më deri verën e vitit 1943. Lufta bëri të vetën dhe dalngadalë unë fillova të bind veten se nuk do ta shikoja më.

Kishin kaluar afro pesë vjet.

Kur Lysieni më telefoni për të më ftuar te Bliret që t'i bija pianos për një darkë shumë të veçantë, flegrat e hundës m'u drodhën si ato të një pele në pranverë, kur natyra i çon asaj kushtrimin e vjetër dashuror sa bota. Edhe unë u nisa me vrap drejt Blireve, si një pelë e hazdisur livadheve, që kërkon të shuajë afshin e pafajshëm dashuror. Nuk isha gabuar. Ishte ai. Para meje qëndronte tashmë një burrë edhe më i pashëm se djali i dikurshëm i viteve studentore. Në ato kohëra nuk i besoja Zotit dhe nuk e di kujt iu luta që të më falte. U rrëqetha e tëra kur e pashë dhe e preka. Ishte një rrëqethje aq e ëmbël, sa mend u lektisa. Nuk munda të fsheh dot asgjë.

– Po ai?

– Edhe ai e tradhtoi veten dhe unë e kuptova se njohja jonë e dikurshme nuk kishte kaluar pa gjurmë. Gjatë festës kërcyem bashkë dhe atë natë unë pashë një nga ëndrrat më të llahtarshme të jetës sime. Më të papërsëritshmen. Më tronditësen.

– Bëre... dashuri me të?

– Po. Në mes të një livadhi me lule. Ishte një akt i plotë dashurie. Çoroditës. Shkundës. Një sinfoni. U zgjova e sflitur nga kënaqësia dhe nuk munda të fle më. U binda brenda pak orëve se deri atëherë nuk kisha kuptuar asgjë nga dashuria. Ndërkohë kisha nisur një histori me Ludvigun, kryetarin e grupi tonë komunist, i cili më kishte premtuar se do të martoheshim kur të vinte fitorja e madhe. I isha dhënë. Kishim fjetur disa herë bashkë. Por kur të nesërmen e asaj ëndrre unë i hipa biçikletës dhe u nisa e shushatur për te shtëpia e zonjës Klodetë, u binda se njeriut i duhen prova për të kuptuar se kur dashuron me të vërtetë dhe kur gënjen veten.

– Pse shkove te Bliret?

– Nuk e kisha më veten nën kontroll. Doja ta shikoja sa më parë atë njeri. Me çdo kusht. U shtira sikur po kaloja andej rastësisht dhe Lysieni më ftoi për një shetitje me biçikleta në pyll. Ata ishin tre: gjyshi i Antuanit, Lysieni dhe Lizeta, e fejuara e tij. Vështrova drejt njeriut të ëndrrës dhe u skuqqa nga turpi. Është e mistershme të shikosh para teje mashkullin me të cilin ti ke kryer një akt ëndërror dashurie dhe atij të mos i shkojë mendja fare te ajo që ka ndodhur.

– E di. E kam provuar. Atëherë, kur e shihja Antuanin fshehurazi dhe pothuaj çdo mbrëmje shkruaja poezi.

– M'u duk sikur isha e zhveshur para tij, e shtrirë në livadhin me lule. Ai kuptoi diçka. Nuk kishte si të mos e kuptonte. Për të më shpëtuar nga ajo gjendje hutimi, e mbështeti Lysienin në ftesën që unë të bashkohesha me ta. Lizeta bëri të njëjtën gjë. Pranova në çast, duke harruar të jepja ndonjë shpjegim se ç'erë më kishte hedhur andej nga shtëpia e tyre.

Morëm drekën me vete dhe u nisëm. Tek ngisja

biçikletën pranë atij njeriu, më dukej se gjyshi i Antuanit kishte ardhur në këtë botë vetëm për mua. I buzëqeshja dhe e vështroja si e marrë. Gati po e trembja. Sikur ai të kishte mësuar për ëndrrën time në ato çaste, do të ishte tmerruar përfundimisht. Ndërsa Lysieni me të fejuarën e tij ishin futur thellë pyllit, unë u shtira sikur nuk e kisha mendjen, u lëshova tëposhtë një bregoreje me bar dhe u rrëzova buzë një përroi si një aktore e vërtetë. Ai më erdhi në ndihmë i trembur dhe më mori në krahë. U mbajta në supet e tij dhe mbylla sytë. U ulëm mbi bar, por unë nuk e lëshova. Isha gati të bëja dashuri me të. Prisja vetëm një shenjë.

– *Simonë, – më tha ai tërë fisnikëri, – unë jam këtu për pak ditë. Atdheu im është larg. Ti ndoshta s'ke dëgjuar kurrë për të. Njohja jonë duhet të mbetet thjesht një njohje feste. Shkojmë. Lysieni dhe Lizeta mund të merakosen.*

– Më fal! – iu përgjigja. – Nuk e di ç'po ndodh me mua.

– Po ai ... nuk u tundua aspak nga prania jote?

– E vërteta është që u tundua shumë, por këtë nuk mund të ma shprehte. Ma tregoi më vonë. Shumë më vonë. Atëherë kur unë nuk e prisja. Ishte njeri që fliste pak. Shumë pak. Por ato që thoshte, nuk harroheshin dot.

Ajo drekë e kaluar në pyll pranë tij ishte një magji. Isha gati të puthja çdo fije bari e lule aty rrotull, të përqafoja çdo trung peme, të përshëndesja çdo zog që kërcente dëgëve. Atë ditë e urreva marrëveshjen njerëzore për ndarjen e kohës në orë e minuta dhe zakonin e lashtë të rënies së diellit në perëndim. Doja që ajo ditë të zgjaste pa fund.

Kur u kthyem në qytet, ai më falënderoi që i kisha kushtuar kohën time të çmuar. Nuk guxoi të më prem-

tonte se do të tako-heshim përsëri. Vetëm atëherë unë torollakja u kthjellova se atje në vendin e tij atë mund ta priste ndonjë vajzë. Ndoshta më e bukur se unë.

– Dhe në të vërtetë e priste?

– Duhej të kishte torollake të tjera si puna ime, por ai nuk i ishte zotuar asnjërës.

– Po më tej, ç'ndodhi?

– Të nesërmen, natën vonë, Ivi, një nga shokët e grupit tonë komunist, ia mbërriti me vrap në shtëpinë time. M'u duk plotësisht i çoroditur. Ishim zbuluar.

– *Po na kapin nëpër shtëpi, – tha ai. – Duhet të largohesh brenda minutit.*

Vetëm kaq. Nuk e pashë më. Vеша një fustan, kërceva sipër biçikletës dhe ndërsa humba në një kthesë, pashë një makinë që u ndal para shtëpisë. Ishin njerëzit e Gestapos. Dikush, diku në ndonjë bar, duhet të më ketë spiunuar, sepse ata m'u vunë prapa. Pas një copë rruge, u detyrova të hedh biçikletën dhe të vrapoj.

Duke kaluar nëpër kopshte e parcela, dola nga qyteti dhe mbërrita te vila e zonjës Klodetë. Atje po flinin të gjithë. Dola prapa shtëpisë. Papritur, në një rën nga dritaret e dhomës së miqve, pashë gjyshin e Antuanit. Po tymoste një cigare. Nuk kishte gjumë. Ishte një natë e ngrohtë korriku. Rrotull cicëronin zogjtë. Kundërmonte një arómë dehëse bari të thatë dhe lulësh.

I fola. Ai nuk u besoi syve. Më pyeti se ç'kërkoja në atë orë aty. I tregova të vërtetën, pastaj nxitova të fshihesha në një kasolle të vogël në cep të oborrit. Kalova atje më shumë se një orë duke menduar se ia kisha hedhur. Rrotull shtëpisë nuk dëgjohej asnjë zhurmë. Atëherë gjyshi i Antuanit më foli. Më ftoi brenda. Nuk mund të rrish deri në mëngjes në atë kasolle, tha.

Por unë iu luta që të dilte ai. Ishte një natë me hënë,

nga ato netë kur gjithçka duket si e larë në argjend dhe yjet feksin lart në qiell si një mori e pafund xixëllonjash në një livadh. Doja të merrja fushat, pastaj të humbisja thellë pyllit. Pse të gënjej? Po më mbyste frika. Kisha dëgjuar lloj-lloj llahtarish për njerëzit e Gestapos. Dy grupe të rezistencës kishin përfunduar në duart e tyre.

Njeriu i ëndrrës sime sapo filloi të vishej kur ia mbërritën makinat e njerëzve të Gestapos dhe u ndalën para shtëpisë. U mata të futesha përsëri në kasolle, por gjyshi i Antuanit më ftoi në dhomën e tij.

– *Këtu do të dyshojnë më pak, – tha.*

Mora një shkallë pranë kasolles dhe u ngjita me anë të saj deri te parvazi i dritares. Aty i dhashë shkallës një të shtyrë dhe hyra brenda. Hoqa fustanin dhe u futa drejt e në krevat. Jam e vogël, thashë, do të fshihem mes këmbëve të tua. Ai pranoi i hutuar. Ishte vetëm në mbathje. U struka mes këmbëve të tij leshtore, mbuluar me çarçaf. Nëpër shkallë u dëgjuan zëra. Lysieni po fliste frëngjisht me një njeri që përdorte akcent të fortë gjerman. Na u krijua ideja se ata njiheshin. Trokitën në derë, pastaj e hapën atë pa shumë ceremoni dhe ndezën dritën. Gjyshi i Antuanit u ngrit ndenjtur në krevat. Përballë tij qëndronte një oficer i ri gjerman.

– *Lysien, ky është miku yt? – pyeti oficeri.*

– *Mund të them se dikur ka qenë edhe yti, – ia ktheu Lysieni.*

Për tmerrin tim oficeri e njohu gjyshin e Antuanit. Edhe ai u kthjellua. Filluan të qeshnin me të madhe.

– *Djema, sa e vogël është bota! – foli gjermani. – Vegim, o kalë Ballkani, të kujtohet se më ke përndrydhur këmbën kur po luanim një ditë futboll?*

– *Ernest! – thirri edhe Vegimi dhe u ngrit ta përqafonte, duke më zbuluar kështu mua.*

Lysieni në fillim ngriu. Por, çuditërisht, arriti ta mblidhte veten dhe tha nën zë:

– *Vegim, mos thirr shumë se do të zgjosh të fejuarën.*

Kur pa që në krevat ndodhej edhe dikush tjetër, oficeri kërkoi falje dhe doli nga dhoma.

– *Është e fejuara ime, – tha gjyshi i Antuanit qetësisht.*

– *Po fle. Sot jemi lodhur shumë andej nga pylli.*

– *Kuptohet, – qeshi tjetri. – Djema, zbresim të pimë diçka.*

*Unë nxitoj. Bekuar qoftë kjo rastësi!*

Vegimi u vesh dhe doli nga dhoma pa më folur. Dëgjova hapat e tyre nëpër shkallë ndërsa vazhdoja të dridhesha e tëra. Më vonë mësova se oficeri gjerman me emrin Ernest kishte studjuar në Paris në një kohë me Lysienin dhe Vegimin. Lufta e kishte prurë në Belgjikë, por për ç'arsye me trupat e Gestapos, këtë nuk e kuptova dot.

Ajo natë ka mbetur misteri më i madh i jetës sime. A e besoi ushtaraku gjerman vërtet se unë isha e fejuara e një bashkëstudenti të tij të dikurshëm? Vegimi këmbëngulte se ai e kishte besuar. Lysieni ishte i bindur që jo. Ernesti ishte shtirë krejt i pavëmendshëm thjesht për hir të asaj pak miqësie që ata kishin pasur dikur. Kur njerëzit e Gestapos kërkonin një të dyshuar, informatat nuk i gabonin kurrë. Fare mirë dhe me shumë takt, oficeri mund të kishte këmbëngulur për të më parë në fytyrë apo të më kërkonte ndonjë dokument identifikimi. Por nuk e bëri atë gjë. E kaloi gjithçka me të qeshur. Me sa duket, një komuniste më pak apo më shumë, për të nuk kishte edhe aq rëndësi, ndonëse ai mund të ishte i betuar në bindjet e tij. Ka raste, mbase të rralla, kur gjestet kalorsiake dalin mbi bindjet dhe ndjenjën e detyrës.

Nuk e kuptova dot kohën që rrodhi deri sa makinat



e Gestapos u larguan dhe ata të dy u ngjitën në dhomë. Dukej që ishin sqaruar mes tyre, por gjërat nuk ishin më njëlloj. Mbështetur në zakonet e vendit të tij, Vegimi mund të kishte vepruar drejt, ndonëse atë natë ishte mik në atë shtëpi. Ai kishte ndihmuar një njeri, aq më shumë një femër, që kërkonte strehë në çastet më të rrezikshme të jetës së saj. Por ai kod sjelljeje mund të dukej krejt absurd në Belgjikë.

Lysieni më qëndroi ftohtë. Prisja që ai të më pyeste: "Simonë, me ç'të drejtë erdhe në shtëpinë time? Po sikur të kishim përfunduar të gjithë në ndonjë kamp përqëndrimi?" Por:

*– Simonë, nuk e dija që ishe ngatërruar me rezistencën, – tha ai. – Shpresoj që jo me krahun e komunistëve. Nesër do të përpiqem të të gjej një pasaportë false. Flini tani. Në këtë kat ka edhe dy dhoma të tjera. Vegim, na shpëtoi Zoti të gjithëve. Do të përpiqem ta harroj atë që ndodhi.*

Ai zbriti shkallët i tronditur, ndonëse përpiqej të mos e jepte veten.

Gjyshi i Antuanit qëndroi para meje ende pa e besuar atë që kishte ndodhur. Unë vazhdoja të dridhesha. Pastaj fillova të qaja.

*– Shpresojmë të gjendet një zgjidhje, – tha ai. – Qetësohu tani. Mund të rrish këtu. Unë po shkoj në një dhomë tjetër.*

*– Jo, kam frikë, rri me mua, – këmbëngula.*

Nuk prita përgjigje. U vërsula drejt tij dhe fillova ta përqafoj e ta puth si e çmendur. Herën e parë gati e detyrova të bënim dashuri. Nuk dija si ta nxirrja tmerrin dhe ankthin. Një jetë e tërë erdhi më pas, por nuk mbaj mend të kem bërë dashuri si atë natë. Nuk doja të ndalesha. Vetëm i lutesha atij të më shtrëngonte në krahët e tij. Me sa duket e kapi edhe atë marrëzia. Sikur kërkonte të hynte i tëri brenda meje, të shkrihej me mua, të bëhej

njësh. Vazhduam ashtu deri sa zbardhi dhe jashtë filluan të këndonin gjelat. Na zuri gjumi në krahët e njëri-tjetrit pasi ai më pëshpëriti duke qeshur:

– *Simonë, bota nuk mbaron pas sinjalit të këtyre gjelave. Të jesh e sigurt për këtë.*

Nga ora 10 Lysieni na gjeti të kapërthyer me njëri-tjetrin dhe tronditja e djeshme, kur kishin ardhur njerëzit e Gestapos, iu rikthye.

– *Ç'po ndodh në këtë shtëpi çudirash?! – tha. – Simonë, çfarë i bëre mikut tim?*

– *Kot e ke Lysien, – iu përgjigja. – Nuk do të më kup-tosh dot kurrë.*

– *E pse?*

– *Sepse as vetë nuk e di çfarë ndodhi.*

– *Besoj se edhe ti Vegim nuk e di.*

– *Jo, – ia ktheu gjyshi i Antuanit. – Të betohem. Kot gënjehemi se e njohim veten.*

– *Po si mundët të flinit deri tani, xhanëm?! – Lysieni filloi të hapte krahët e të bënte gjeste habije. – Po sikur të ishin kthyer përsëri gjermanët?*

– *Ernesti nuk do ta bënte, – tha Vegimi.*

– *Të lutem, mos i mat njerëzit me kutin tënd! – u nervozua Lysieni.*

– *Në të vërtetë duhej të kishim shkuar në pyll, – thashë unë, duke e kuptuar se me familjen e zonjës Klodetë e kisha dreqosur përfundimisht.*

– *Nuk më duket ide e keqe, – nënqeshi Lysieni. – Gjetje vërtet romantike. Po ju bëj gati një shportë me ushqime, fruta dhe një shishe verë. Simonë, pasaportën do të ma sjellin vonë pasdite. Përpiqu të gjesh një zgjidhje deri atëherë.*

Pohova me kokë pa e vështruar.

Dolëm në pikë të diellit dhe morëm përmes parcelave që të mos na shikonte njeri. Hymë në pyllin e freskët

dhe në qilimin e parë me bar e lule që gjetëm filluam po me atë çmendurinë e natës të bënim dashuri. Rroku-lliseshim lakuriq mbi bar, rënkoni, thërrisni. Më kujtohet se kur hapa sytë, shtrirë në shpinë, pashë në degën e një peme një çift zogjsh që kishte zgjatur kokat dhe na vështronte. Ishte e çuditshme. Na vështronin si dy njerëz. Madje shikimi im ndeshi në shikimin e tyre. Na kishin parë tërë kohën të poshtrit!

Vetëm kur në pyll filloi të errej, e kuptuam se po i shmangeshim më kot një pyetjeje që e kishim menduar të dy tërë kohën.

– *Simonë, ku mund të fshihesh? – foli ai i pari.*

I vetmi vend i sigurt arratie ishte Anglia, por unë nuk e përmenda atë.

– A ka gjermanë në vendin tënd? – pyeta.

– *Ende jo, – që përgjigja.*

Atëherë e vështrova thellë në sy duke dashur që ai të mos më shmangej.

– A mund të më marrësh në vendin tënd? – e pyeta.

Siç e prisja, ai nuk iu shmang syve të mi.

– *Je e sigurt që do të vish? – pyeti.*

– Jam, – iu përgjigja. – Nuk mund të ndahem më nga ti.

Atëherë ai filloi të më bënte të ditur qetësisht se në Shqipëri ishte pak a shumë si në Algjeri dhe Marok.

– Le të jetë, – ia prita. – E rëndësishme është që të jemi bashkë.

– *Dhe... kush do të jesh ti në vendin tim, ndonjë bashkëluftëtare antifashiste apo partnere punësh avokatie?*

– Dua të martohem me ty, – thashë pa m'u dridhur zëri. – Dua të të kushtoj jetën time që mund ta kisha humbur në ndonjë kamp përqëndrimi.

Kurrë nuk e kuptova se si ai pranoi. Më vonë, në

çaste nga më të rëndat të jetës sime, e kam pyetur për atë zgjedhje dhe gjithmonë ai më dha të njëjtën përgjigje: "Ti ishe fati im. Më solli urdhri i këtij fati deri në shtëpinë e Lysienit për të të marrë ty". Por, në të vërtetë, ndonëse ai nuk e pranoi para meje asnjëherë, ishte kodi i tij i nderit, që e kishte në gen, i cili kishte dhënë urdhrin. Tashmë nuk mund të braktiste një femër të pambrojtur që i kërkonte ta merrte me vete në vendin e tij. Megjithëse ndodhesha me qindra kilometra larg shtëpisë së tij, ishte njëlloj sikur t'i kisha trokitur në portë. Kodi i tij i nderit ishte i hekurt. Nuk pësoi asnjë cen deri në vdekjen e tij. Ai brez burrash nuk do të vijë më, vogëlushe. Jam e bindur për këtë.

– Ndoshta as brezi i grave si ti, – tha vajza.

– Mundet. Lufta dhe rreziqet e mëdha i provojnë njerëzit. Brezat që nuk kalojnë luftëra dhe rreziqe, nuk kanë çfarë t'i provojnë njëri-tjetrit.

Gruaja e moshuar nxori një rënkim të mbytur që thellë genies së saj.

– Megjithatë, – vazhdoi pastaj, – atje në pyll ai më bëri të ditur se rruga deri në vendin e tij (nëse do të mbërrinim gjallë atje) do të ishte e gjatë dhe unë mbase do të kisha kohë të pendohesha. E drejta e pendimit kishte vlerë edhe pasi të ishim martuar. Sapo të mbaronte lufta, unë mund të kthehesha në vendin tim.

– *Ndodh që njerëzit pendohen, – më tha ai. – Është njerëzore. Unë do ta mirëkuptoja kurdo që të ndodhte.*

Në mbrëmje u kthyem në shtëpi. Qëndruam para Lysienit dhe zonjës Klodetë si dy të lajthitur të lumtur. Ata ishin qetësuar disi dhe Lysieni më krijoi idenë se në takimin tonë të fundit nuk kishte ndër mend të tregoj burracak. E ëma po ashtu nuk pranoi ta tradhtonte veten.

Gjyshi i Antuanit u tregoi atyre për vendimin që kishim marrë. Të zotërit e shtëpisë mbetën të shastisur.

– *Nuk ka ndodhur që në këtë shtëpi të çmenden njerëz, – tha Lysieni, – ju jeni të parët. Zoti ju bekoftë dhe e paçi me vete si ajo vela erën e mbarë!*

Ai më zgjati një pasaportë të sajuar jo edhe aq mjeshtërisht, që mbante fotografinë e një vajze me flokë të shkurtëra. Lizeta mori një gërshërë për t'u dhënë flokëve të mi një pamje pak a shumë të ngjashme. Zonja Klodetë qante aty pranë.

– Simonë, u rrite në këtë shtëpi dhe po del nuse prej saj, – mërmëriste. – Kujt ia kishte marrë mendja!

Pastaj, Lizeta u nis për në shtëpinë time të njoftonte nënën dhe të merrte një valixhe me rroba.

– *Mos harro dokumentet origjinale! – i foli zonja Klodetë nga pas. – Si do të martohet kjo çupë atje në vend të huaj?*

Nëna ia mbërriti me shaminë para gojës. Më tërhoqi mënjane duke më shkundur për krahu dhe më foli tërë qortim:

– *Simonë, a nuk e pe se si komunizmi e mori më qafë tët atë? Ai nxori tërë kohën nga zjarri gështenja dhe të tjerët i hëngrën. Kështu do ta pësosh edhe ti. Po i shkon prapa një njeriu që është edhe komunist, edhe mysliman.*

Ajo ishte e bindur se njeriu që po më merrte me vete ishte një komunist i flaktë dhe se vendi i tij binte diku andej nga Bashkimi Sovjetik. Nuk ia vlente asnjë lloj sqarimi. Zonja Klodetë e këshilloi të më thoshte fjalë të mira se unë po nisesha nuse larg.

– *E di, – rënkoi nëna. – Nuk do ta shoh më. Jam e bindur që nuk do ta shoh më.*

– *Jo, ata do të vijnë për pushime në anët tona, kur të mbarojë lufta, – i tha Klodeta.*

Por nëna nuk dëgjonte nga ai vesh. E përqafova e

përlotur. Ajo më la në dorë një varëse floriri, të vetmen gjë me vlerë që kishte. Pas pak i ra të fikët. Kur u përmend, kërkoi të thërrisnin një prift. Ne duhej të niseshim të bashkuar të paktën para Zotit. Ajo barrë i ra Lysienit. Për t'u ndarë me kokën lart me Vegimin, ai nuk u shmang. Pruri atë Vinsentin, famullitarin e zonës aty rrotull, i cili u mallëngjye keqazi kur mësoi se unë po martohesha me një mysliman dhe do të shkoja në një vend të largët. Ati e bekoi martesën tonë, nëna pranoi t'i jepte gjyshit të Antuanit një të puthur dhe ne u nisëm përmes fushave e pyjeve, drejt kufirit francez, ku Lysieni na kishte rekomanduar një bujtinë, pronarin e së cilës e njihte.

## IV

Vegimi kishte tre vjet që punonte pa bërë pushime. E dinte gjithashtu që në vendin e tij mund të mbesnim pa muaj mjalti, ndaj vendosëm që tërë rrugës t'ia kalonim me mjaltë e verë. Zoti im, sa çmenduri kemi bërë gjatë atij udhëtimit! Lamë gjurmë dashurie ngado, nëpër livadhe, pyje, kasolle druvarësh, lumejve, bujtinave apo shtëpive të fshatit, ku detyroheshim të strehoheshim. Një mesditë të llahtarshme, ndërsa rrotull të shurdhonin gjinkallat, bëmë dashuri poshtë një ujëvare të vogël, të kthjellët e të freskët. Vogëlushe, është një periudhë dalldie në jetë kur të duket se e gjithë bota është krijuar vetëm për dashuri.

Për fat, vetëm një herë na ndali një polic francez, me të cilin u ndamë miqësisht, megjithëse ai dyshoi te pasaporta ime. Unë mbaja tërë kohën veshur një fustan të bardhë dhe një kordele në kokë, për të treguar se sapa isha martuar. Fushave fshatarët na uronin jetë të mbarë kohë pas kohe. Atë rrugë të gjatë e të paharrueshme e quajtëm Rruga e Mjaltit. Puna shkoi deri atje sa e harruam fare Gestapon. Nuk kishim më frikë. Edhe sikur të na kapnin dhe të na nisin në ndonjë kamp përqëndrimi, ishim të bindur se do të vdisnim të lumtur.

Udhëtuam pothuaj tërë korrikun, nga qyteti im i vogël deri në Ankona të Italisë. Atje u strehuam në shtëpinë e një partneri në tregti të babait të Vegimit, kur kishim mbetur me qindarkat e fundit në xhep. Ndërkohë lufta

kishte marrë tepër mbrapsht për italianët dhe mezi mundëm të gjenim një anije për në qytetin tonë. Ishte anija e një tregtari shqiptar. E vogël. Nuk kishte ku të fshihehe për të bërë dashuri. Megjithatë, edhe ajo plotësoi kilometrat e veta të Rrugës së Mjaltit. Dy netë fjetëm jashtë, në kuvertë. Si mund të humbim rastin dhe të mos bënim dashuri në mes të detit, përkëdhelur nga flladi dehës, përkundur ëmbëlsisht nga valëza paqësore, nën Hënën e florinjte që na dukej si një pite rumbullake mjalti dhe nën yjet që na ngjanin me trëndafila të verdhë që nga çasti në çast do të shkundin petalet mbi ne?

Më kujtohet se nën atë qiell përrallor i bëra gjyshit të Antuanit pyetjen më naive dhe më të cekët që femrat e bëjnë shpesh: më do dhe sa. Ai vështroi i heshtur yjet.

*– Kurrë mos prit nga unë vjersha, – tha. – Janë ca gjëra që thuhën rrallë në jetë, fare rrallë, sepse kanë çmim tepër të lartë.*

Dhe ato fjalë që unë prita t'i dëgjoja atë natë në det, dolën nga goja e tij vetëm tri herë gjatë gjithë jetës sonë.

Mbërritëm në port një mëngjes të kthjellët. Atëherë, para meje u shfaqën vetëm disa kodrina të zhveshura, një manastir ortodoks përtej qytetit, minareja e një xhamie mes shtëpive të ulëta, këmbanarja e një kishe katolike jo shumë larg detit dhe fare pak ndërtesa ku të mbesnin sytë. Megjithatë, ajo pamje m'u duk tronditëse. Isha ende nën efektin e mjaltit. Por edhe kur dalldia dashurore më doli disi, nuk u zhgënjeva. Ai qytet ishte më i madh se qyteti ku unë isha rritur. Të kujtonte një qytet italian.

Në port kishin dalë të na prisnin prindërit e Vegimit, një nga çiftet më legjendarë të atij qyteti. Tashmë kisha dëgjuar shumë për ta. Kishin pasur një histori magjep-



sëse dashurie në kohërat kur dashuria futej në mëkatet e mëdha, sidomos po të rrëmbeje gruan e një tjetri. Shpesh gjërat shkojnë në fis, vogëlushe. Një natë vonë, ndërsa Vegimi më tregonte për prindërit e tij, unë e kuptova magjinë që kishte ndodhur me ne të dy.

Ime vjehrrë ishte bijë e një familjeje ortodokse. Në rininë e saj kishte qenë tepër e bukur, aq e bukur, sa i kishin kushtuar edhe këngë fshehurazi. Djemtë e dalldisur pas saj bëheshin shumë, myslimanë e të krishterë. Por më i marrosuri ishte babai i Vegimit. Time vjehrrë e kishin fejuar kundër dëshirës së saj me një burrë shumë më të madh në moshë dhe, më e keqja, dyshohej se ai ishte i prekur nga tuberkulozi. Bandën e djemve të dalldisur pas saj e kishte ndezur edhe më shumë ajo fejesë. Të gjithë ishin gati të bënin heroizma kalorësish mesjetarë për të fituar zemrën e saj.

Por ajo zgjodhi babanë e Vegimit. Dy herë ai i kishte hyrë natën në shtëpi dhe ajo i ishte lutur që ta rrëmbente. Rrëmbimi ndodhi dy ditë para dasmës. Ai e mori virgjëreshë, një fitore e paçmuar për ato kohëra. Shkuan në një fshat të vogël buzë detit, ku gjyshi i Vegimit kishte ngritur një çetë për t'i bërë ballë ndonjë sulmi nga ana e njerëzve të nuses. Ai plak i çuditshëm, i cili, kur vdiq, la në shtëpi disa shpata dhe shumë trofe të tjera lufte nga koha e Perandorisë Osmane, kishte qenë mbështetësi kryesor i rrëmbimit. Dikur ai kishte bërë të njëjtën gjë me një të krishterë diku andej nga viset e Rumanisë.

Por në çastet e fundit familja e nuses u tërhoq. Një njeri i zgjuar, me sa duket, i bindi të tjerët se historia e Trojës ishte e vjetër sa vetë njerëzimi dhe do të përsëritej gjithmonë. Çka nuk gëlltitej dot në ato kohëra nuk ishte edhe aq rrëmbimi i vajzës pak ditë para dasmës, sesa

futja e saj në një familje myslimane. Por koha i sheshon meritë...

Atje në port ata më pritën në mënyrë tepër miqësore, sidomos ime vjehrrë. Ishte një natyrë e dashur. Vetëm qau tërë kohën. Ishte një grua që të kujtonte një livadh në verë, kur lulet fillojnë të vyshken, por ama ngjyra e blertë dhe gjurmët e bukurisë pranverore mbeten ende. Më pyeti për nënën time me shumë sinqeritet dhe dhembje. Ajo e dinte mirë se si isha larguar unë nga shtëpia.

Ndërsa babanë e Vegimit munda ta shikoj në sy vetëm për pak sekonda. I gjatë, i veshur në stil europian, por me një pamje të sertë ballkanasi, ai kishte një vështrim goditës dhe pamje që të impononte respekt. Ndonëse merrej me tregti stofrash, mua më krijoi idenë sikur kishte qenë ushtarak dhe në trup e bezdisnin ende plagë të vjetra lufte.

*– Mirë se erdhe në familjen tonë! – m'u drejtua italisht.*

Kaq. Asgjë më shumë. Vura re se Vegimi u skuq para tij. I ati nuk e përqafoi. Vetëm i shtrëngoi dorën. Ata folën diçka në gjyhën e tyre. Duhej të ishte diçka tepër serioze. E kuptova që nga mënyra se si ata të dy vështroheshin. Shumë kohë më vonë, pasi im vjehrr kishte vdekur, e mësova brendinë e atij dialogu të shkurtër.

*– Bir, vetëm të mos jetë e varfër dhe familje komunistësh, – i kishte thënë të birit ai.*

*– Jo, – i qe përgjigjur im shoq. – Nuk është as e varfër e as familje komunistësh.*

Por im vjehrr e kishte nuhatur në çast se nuk kishte dëgjuar të vërtetën. Ishte hera e parë që Vegimi e gënjente. Megjithatë, i ati e pranoi atë gënjeshtër qetësisht. Në mes ishte dashuria. Ai e njihte mirë atë ndenjë.

U ngjitëm në një pajton që na priste në hyrje të portit. Im vjehrr nuk kishte pranuar ta mësonte makinën. Kuajt ishin një dobësi e tij e vjetër. Kur mbërritëm në shtëpi, unë mbeta e mahnitur. Gjeta një vilë më të bukur se ajo e Blireve. Vogëlushe, karakatina që ne lamë pas, ku ti ke hyrë aq shpesh, dikur ishte një mrekulli.

– E di, e kam parë nëpër fotografi.

– Ah, e harrova këtë detaj. Ishte ndërtuar nga mjeshtra italianë. Para kishte shtretër të tërë me lule, ndërsa prapa ullinj dhe agrume. Gjyshi i Antuanit nuk ma kishte thënë, por ata ishin një nga familjet më të pasura në qytet. Im vjehrr kishte një magazinë të madhe stofrash në Rrugën Tregtare, ku shiste kryesisht me shumicë. Familja kishte një fermë të vogël në fshat, ku ndodhej një shtëpi e vjetër, tepër e madhe, kati i sipërm i së cilës ishte i tëri i drunjtë. Një shtëpi tjetër ndodhej në plazh. Gjyshi i Antuanit ngiste një veturë italiane, prodhim nga më të fundit.

– Vegim, mos je gabuar? – iu drejtova e hutuar tim shoqi. – Unë nuk jam e sërës tënde.

– *Do të bëhesh, – ma ktheu ai qetësisht. – Kjo bisedë nuk duhet të hapet më mes nesh. Shpresoj që si komuniste që je, nuk do të urresh asgjë rreth e rrotull.*

– Unë luftoja për Rezistencën, – u mundova ta gënjeja.

– *Nuk të kanë mësuar të urresh pasanikët dhe pronat e tyre?*

– Jo.

Ai vetëm qeshi miqësisht dhe u largua.

– *Komunizmi nuk është gjë tjetër veçse një formë e veshur me teori e rrëmbimeve dhe plaçkitjeve që ndodhnin në lashtësi, – tha. – Atë fillojnë ta përçmojnë të parët pikërisht ata që marrin pushtetin dhe fillojnë të drejtojnë.*

Biseda për komunizmin nuk u hapën më në atë shtëpi

për muaj me radhë.

Dy javë pas mbërritjes sonë im. vjehrr bëri një dasmë që nuk ishte parë në qytet. Gjyshi i Antuanit ishte djalë i vetëm. Një motër e tij më e madhe ishte martuar në Tiranë me një publicist të njohur. Dasma zgjati gati një javë. Dy palë saze ciganësh dhe disa balerina që përdridheshin tërë kohën si të kurdisura bënë gara në oborr kush e kush të tërhiqte më shumë njerëz. Kushdo nga rruga ishte lirë të vinte për të ngrënë e për të pirë. Kujt i mbushej mendja edhe mund të kërcente. Madje nja dy pijanecë u bënë xurxull dhe filluan të kacafyteshin për njërën nga balerinat. Pa llogaritur fëmijët që bënë gara kush të hante më shumë llokume e bakllava.

Dreka kryesore e dasmës të kujtonte ato përrallat arabe. Vargane të tëra me gatime uleshin e ngriheshin nëpër tryeza, gati të paprekura. Pothuaj e tërë borgjezia e madhe e qytetit ishte aty. Më mbuluan me dhurata. Por më përrallorja ishte kur dasmorët bënë thirrje që nusja dhe dhëndrri të kërcenin vallen e Napolonit. Ishte një valle që nuk e pata të vështirë ta mësoja. Një tip me mustaqe, një kushëri i Vegimit, që fërshëllente si sirenë treni, u ngrit i pari dhe na la në duar nga një monedhë floriri. Në fillim nuk e kuptova atë veprim. Por kur dasmorë të tjerë, përfshi njerëzit e familjes, filluan të na ngarkonin me flori, e pata ta qartë se bëhej fjalë për një zakon tepër të vjetër, të cilit pakkush mund t'i shmangej.

Monedha dhe kartmonedha pa fund filluan të mbulonin dyshemenë rrotull këmbëve tona. Një vajzë e vogël filloi t'i mblidhte ato me një fshesë, pastaj i futi në një shportë. Ndërkohë mua duhej të më kishin shkuar sytë shtrembër, sepse Vegimi më tha duke qeshur:

– Janë të gjitha të tuat. Çfarë do të blesh me to?

Unë mend u përloja.

– Një piano.

– Dalin e teprojnë, – qe përgjigjja e tij.

Kur u larguan edhe dasmorët e fundit, u ngjitëm në dhomën tonë. Që nga mbërritja në shtëpi nuk kishim fjetur bashkë. Nuk shkante. Ishte një traditë që duhej respektuar. Por ndërkohë, të mësuar me Rrugën e Mjaltit, nuk kishim duruar dot dhe kishim shkuar me makinë te shtëpia në plazh. Dysheku i butë dhe i gjerë i dhomës sonë martesore qe stacioni i fundit i asaj rruge të dalldisur.

Pak ditë pas dasmës, kur ende vazhdonte ardhja e miqve, pihej e këndohej, ndërsa u ngrita me nge, gjeta në dhomën e madhe të ndenjies, në katin e dytë të vilës, një piano të mrekullueshem austriake. Qava mbi tastierën e saj. Gjyshi i Antuanit ishte ulur aty pranë dhe më shikonte. E përqavofa gjatë, pastaj luajta për të deri sa m'u lodhën gishtat.

– E kam parë atë piano në shtëpinë tuaj.

– Çfarë ke ndier?

– Keqardhje. Antuani më ka lejuar vetëm një herë ta prek.

– Eh, tani pianoja ime i ngjan një arkivoli që pret. Ka historinë e saj edhe ajo. U bë pjesë e jetës sime. Gjëja më e shtrenjtë që kam pasur. Ti nuk mund ta besosh sa lotë kam derdhur mbi tastierën e saj.

Gruaja e moshuar u mbush thellë me frymë dhe ngriti paksa kokën për të mbajtur vesh.

– Ja, sikur i dëgjoj tingujt e saj tek përhapen mbi det.

– Në qytet ty të gjithë të quanin “Pianistja belge”.  
Pakkush ta dinte emrin e vërtetë.

– Oh, zemër, unë isha një pianiste e zakonshme. Të

pazakonshmen e përbënte fakti që isha belge. Talentin përpiqesha ta zëvendësoja me dashurinë për pianon. Kaq.

– Ata që marrin vesh nga muzika nuk flasin kështu. Me aq sa të lejuan rrethanat, ti ishte një pianiste e madhe.

– Mbase. Kjo tani nuk ka më asnjë rëndësi. Muzika e bëri të vetën.

## V

– Nona, të ngjiti jeta në qytetin tonë?

– Çuditërisht, shumë. Duke filluar nga vila jonë e mrekullueshme. Merresha një pjesë të madhe të kohës me lulet. Gjeta disa rrënjë trëndafilash të bardhë dhe i mbolla. Më pëlqenin shumë. Ata i qëndruan kohës më shumë se lulet e tjera, ndaj shtëpinë tonë e quajtën Vila e Trëndafilave të Bardhë.

Deti ishte aty pranë. Ditëve me diell dilnim shetitje me anije deri te një kep shkëmbor diku në veri, ku ndodhej një kështjellë e rënuar. Në qytet kishte kinema dimërore e verore. Nuk mungonin gratë e huaja të martuara me shqiptarë, sidomos italianet. Në një festë, ku i rashë për herë të parë pianos për një grup të madh miqsh të Vegimit, u njoha me një moshataren time italiane që ishte martuar me një violinist.

– Është fjala për Sarën që i ngjante aktorese Alida Vali?

– Po, për atë.

– Pas njohjes në atë festë, fillova të shoqërohesha dendur me Sarën. Bënim ndonjë pazar të vogël bashkë. Nganjëherë dilnim shetitje deri buzë detit. Ndërsa veshjet i qepnim te rrobaqepsija "Parajsa e grave", të cilën e kishte hapur një mjeshtër i kthyer nga emigracioni në Francë, ku kishte qepur për vite me radhë vetëm për gra. Në atë rrobaqepsi mund të bëje veshje të modës më të fundit.

Festat te vila jonë u bënë të rregullta. Aty vinin moshatarë të Vegimit, shumica të shkolluar në Perëndim. Këndonim me sa kishim në kokë, pa e imagjinuar se ç'na priste. Ishte luftë. Në qytet kishin ardhur gjermanët. Por në të vërtetë asgjë e jashtëzakonshme nuk ndodhte. Më të rrallë dëgjohej ndonjë e shtënë. Jeta rridhte normalisht.

Për ca kohë gjermanët e boshatisën qytetin dhe ne u detyruam të shkonim te shtëpia e vjetër në fshat, rrethuar me pemë e gjelbërim. Nga veranda e saj e madhe dukej deti. Netëve të trazuara zhaurima e dallgëve mbërrinte deri te ne. Shëtisnim buzë tij me kuaj. Në një plevicë pranë shtëpisë mbareshin dy kuaj të mreku-llüeshëm të racës arabe. Ishin trashëgimtarë të një kali legjendar që e kishte prurë që larg nga Jemeni stërgjyshi i Vegimit.

– Ai i shpatave?

– Pikërisht, ai i fandaksuri i luftërave dhe i shpatave.

Gjermanët na detyruan të bënim një muaj të dytë mjalti. Kur u kthyem në qytet, gjërat ishin vështirësuar. Lufta po bënte të vetën. Flitej se partizanët ishin shtuar nëpër male dhe nuk do të vononte dita që ata do ta sulmonin qytetet. Tashmë unë dilja rrallë. Vazhdoja t'i trembesha përballjes me gjermanët. Në shtëpinë tonë mbahej një qëndrim krejt i paanshëm ndaj luftës. Im vjehrr e përçmonte atë. Një mbrëmje, ndërsa po hanim dhe jashtë u dëgjuan të shtëna, ai tha me neveri:

– *Kjo është një luftë e ndyrë. Mbarimi i saj nuk do të sjellë asgjë të mirë.*

Vazhdova edhe unë të qëndroja e paanshme deri sa një mbrëmje...

– ... u lidhe përsëri me komunistët?

– ... murin e oborrit tonë e kapërceu dikush që ra gati pa ndjenja në tokë. E pashë rastësisht nga dritarja.



Ndodhesha vetëm në shtëpi. Prindërit e Vegimit kishin shkuar në Tiranë tek e bija. Ai vetë punonte deri vonë në avokatore. Dola. Ishte një djalë i ri, i plagosur. Nuk duhej t'i kishte mbushur të njëzetat. Gjermanët po e ndiqnin. Ai më vështroi në sy dhe arriti të më thoshte fare pak fjalë: "Ju lutem, mos më dorëzoni!" Unë kisha ende probleme me shqipen, por atë lutje nuk ishte e vështirë ta kuptoje në çdo gjuhë të botës.

M'u kujtua nata e shkatërrimit të grupit tonë komunist dhe fshehja në Vilën e Blireve. E futa të plagosurin brenda, duke e tërhequr për krahësh. Në një rrugë aty pranë nesh banonte një mjek që kishte studjuar edhe ai në Francë. Vegimi e kishte mik të vjetër.

– Doktor Selita?

– Po, i ndjeri doktor Selita.

– Kur kam qenë e vogël, ai më ka operuar bajamet.

– Oh, në qytetin tonë janë të paktë ata që ai nuk i ka vizituar. Kur rruga ra në qetësi, shkova ta merrja. Ai e mjekoi djalin me ndihmën time. Me sa u kuptua, ishte një plagë jo fort e rrezikshme. Djali u përmend dhe na vështroi i trembur. Iu luta doktor Selitës t'i thoshte se nuk do ta dorëzonim te gjermanët. Pas atyre fjalëve ai m'i nguli sytë sikur të kishte para Shën Marinë. I gjori! E kuptoja fare mirë gjendjen e tij.

Selita po më vështroi i menduar.

– *Nuk mund të lëvizet, – tha. – Ka nevojë për mjekim. Të paktën pesë ditë.*

– Do ta gjejmë një zgjidhje, – iu përgjigja. I nxora diçka për të pirë dhe u ulëm të prisnim Vegimin. Kur ai mbërriti, vështroi i merakosur nga unë, por Selita e sqaroi se bëhej fjalë për një të plagosur.

– *Po pse nuk e çoni në spital? – pyeti Vegimi i hutuar.*

– Sepse është komunist, – iu përgjigja unë.

– Po ti nga e njeh?! – u habit ai.

– Nuk ishte e vështirë për ta njohur, – iu përgjigja.

I tregova si kishin rrjedhur ngjarjet dhe ai më kërkoi t'i mbushja një gotë. Iu luta ta çonim të plagosurin në shtëpinë e plazhit, por ai nuk pranoi.

– Le të rrijë këtu, – tha. – Njëlloj është.

– Gjithsesi, do ta paguajmë një çmim, – tha doktor Selita i menduar.

Pandeha se e kishte fjalën për gjermanët.

– Nuk kam për ta kuptuar dot ndonjëherë racën e tyre, – shtoi ai, duke treguar me kokë nga dhoma ku ndodhej i plagosuri.

– Le të flasim për diçka tjetër, – tha Vegimi duke i mbushur gotat përsëri.

Unë po prisja tërë ankth mbërritjen e prindërve të tij. Ata u kthyen të nesërmen. Im vjehrr shkoi drejt e te magazina në Rrugën Tregtare. Të plagosurin e pa vetëm në mbrëmje, kur hyri në shtëpi bashkë me të birin.

– Mirë bëtë, – tha. – Një njeriu të Perëndisë i duhet dhënë strehë e duhet shpëtuar nga e keqja. Por komunistët nuk janë njerëz të Perëndisë. Dijeni mirë këtë. Ata do të na e bëjnë gropën shumë shpejt.

I biri nuk e kundërshtoi. Ime vjehrrë vetëm bëri kryqin dhe mërmëriti një lutje. Ajo ishte shumë fetare. Mbante në dhomën e saj një ikonë të madhe të Shën Marisë me Jezuin në krahë. Të shoqin nuk e shqetësonte fare ai detaj. Për të kishte vetëm një Zot mbi kokat tona. Kurrë nuk munda t'i harroj fjalët e tij për komunistët.

Pak ditë pasi i panjohuri u shërua dhe u largua nga shtëpia jonë, një vajzë e re me emrin Sadete, që banonte diku përballë nesh, m'u afrua në rrugë dhe më tha duke u skuqur se njeriu që kishim strehuar më ishte

thellësisht mirënjohës. E pyeta në ishte komunist. Ajo pohoi me frikë.

– Edhe unë jam komuniste, – i thashë. – Kam mbajtur bomba në xhep.

Sadetja më vështroi me mosbesim të hapur. Nuk e kuptonte se si një grua e martuar me një borgjez mund të ishte komuniste.

– Do t’ju ndihmoj sa herë të keni nevojë, – vazhdova.

Dhe ashtu, si pa kuptuar, nisi lidhja ime me komunistët e rinj të qytetit. Ata më ftuan të hyja në organizatën e tyre. Pranova. Lidhjet i mbaja nëpërmjet Sadetes. Në atë kohë ajo ishte vetëm 16 vjeçe, shumë më naive se unë. Atëherë mua më dukej se i ndrisnin sytë dhe bëhej ëndërrimtare e sëmurë kur nëpër mbledhje flitej për botën e re që po agonte.

– Por, në të vërtetë, ajo ishte dashuruar me kryetarin e grupit, – tha vajza.

Gruaja e moshuar nënqeshi.

– Sigurisht. Nuk ishte e vështirë ta kuptoje. Njeriu që ne kishim strehuar në shtëpi drejtonte atë grup të rinjsh për të cilët komunizmi ishte vetëm një përrallë ruse. E takova një ditë në një mbledhje. U përlot kur më shtrëngoi dorën. M’u duk njeriu më i sinqertë në botë. Gjatë tërë mbledhjes, kur unë flisja për ato që kisha lexuar mbi komunizmin, ai më vështroi i mekur. Ishte një vështrim që nuk m’u shqit më.

E ndihmova atë grup djemsh e vajzash me sa munda. Bleva për ta ushqime, ilaçe, u dhashë flori nga ai që më kishin dhuruar në dasmë. I konsideroja të racës sime. Për muaj me radhë mbajta në shtëpi dokumente sekrete futur në sirtarin e ndërresave të mia. Verën e vitit 1944 ata, pothuaj të gjithë, dolën partizanë. Nuk mund të qëndronin më në qytet. Për habinë time, para

se të ndaheshim, Sadetja më kërkoi të braktisja burrin dhe të shkoja me ta. U përpoqa ta bindja se ajo gjë nuk mund të ndodhte.

– *Komunistët e vërtetë nuk duhet të ndalen para asnjë pengese, – recitoi ajo tepër serioze.*

Atëherë ia mora dorën dhe ia vura mbi barkun tim. Isha shtatzënë me time bijë. Ajo u skuq dhe u mundua të buzëqeshte. I dhashë një çantë me rroba që t'i kishte për në mal. Nuk më përqafoi. Vetëm më përshëndeti me grusht.

Gjatë luftës, ajo u kthye vetëm një herë në shtëpi. M'u lut të bëja diçka për familjen e saj. Ishin njerëz të varfër. I ati përpiqej të fitonte ndonjë lek duke punuar me një karrocë shkatarraqe. I premtova se do t'i ndihmoja. Dhe i mbajta rregullisht me ushqime ata njerëz.

Nga mesi i nëntorit partizanët hynë në qytet. Dola edhe unë në bulevardin kryesor për t'i përshëndetur. Shumica e njerëzve i shikonin të hutuar. Nuk e kuptonin se ç'merita kishin ata njerëz që parakalonin me kokën lart si çlirimtarë. Andej rrotull nuk ishte bërë ndonjëherë luftë. Partizanët të dhimbseshin. Ishin të veshur e të ushqyer keq. Kishte edhe vajza. Ato ecnin me pushkët varur krahëqafë dhe buzëqeshnin të hutuara. Kërkova për Sadeten, por nuk ma zuri syri.

Ishte hera e dytë që shikoja partizanë. Për herë të parë i ndesha ata në shtëpinë tonë në fshat. Ishin një çetë e sfilitur dhe e uritur. Kërkuan strehë. Im vjehrr i pranoi pa mëdyshje. Por në mëngjes, kur ata po largoheshin, komandanti i tyre vështroi nga shtëpia dhe iu drejtua babait të Vegimit tërë urrejtje:

– *Feudal i poshtër! Do të vijë shumë shpejt dita e larjes së hesapeve.*

Im vjehrr nuk u habit aspak nga ajo sjellje.

– Unë nuk kam hesape për të larë me ju, – tha qetësisht.  
– Largohuni nga kjo shtëpi dhe mos u ktheni më!

Komandantit i kërceu damari.

– Të pushkatohet! – urdhëroi. – Shtëpia të digjet!

Partizanët ngrinë. Pjesa më e madhe e tyre ishin fshatarë të zonave aty rrotull dhe e njihnin mirë familjen tonë. Ndërkohë, një djalë i ri me pamje prej shkollari, që duhej të ishte komisar, e mori komandantin mënjanë dhe filloi ta bindte që të tërhiqej nga urdhrat e dhënë. Me sa dukej nuk ishte koha e përshtatshme për pushketime dhe djegie shtëpish. Komandanti sikur u bind.

– Do të më dalësh përsëri në shteg! – e kërcënoi tim vjehrr duke u larguar.

Mbeta e shushatur nga ajo ngjarje. Atëherë nuk e kuptoja se si tjetri mund të pushkatohej e t'i digjej shtëpia sepse ashtu i tekej një komandanti të vogël partizan...

Kur shikoja partizanët në bulevard, nuk doja ta besoja se ata djem e vajza do të pushkatonin njerëz e do të digjin shtëpi. Nuk mund të ndodhë, mendoja.

Në mbrëmje babai i Vegimit na mblodhi pranë vatrës së ndezur, në dhomën e madhe të zjarrit.

– Nuk keni kohë për të humbur, – na u drejtua. – Gjëni një mënyrë për t'u larguar nga ky vend. Ndryshe do të pendoheni për gjithë jetën. Komunistët do të na fusin në dhe. Shpëtoni të paktën atë fëmijë.

Ime bijë ishte një copë foshnjë dy pëllëmbë.

Ndërkohë ime vjehrrë vetëm lutej e tmerruar.

– Baba, ç'punë kanë me ne?! – iu drejtua Vegimi të atit.

– Nuk kemi bashkëpunuar se me italianët e as me gjermanët.

– Ata kanë punë me mallin dhe pasurinë tonë, – këmbënguli im vjehrr. – Bir, kam frikë se nuk do të kem kohë të të

*këshilloj më. Besoj se nuk e ke harruar atë që ndodhi në fshat.*

Atë natë unë dhe gjyshi i Antuanit menduam gjatë për ikjen. Por rreth e rrotull vazhdonte lufta. Për në Itali nuk gjeje anije edhe sikur të paguaje anijen të tërë. Porti kishte rënë në duart e partizanëve. Njëpër daljet nga qyteti ishin vendosur postblloqe. Të dyshimtët pushkatoheshin pas një gjyqi shpejt e shpejt, të mbajtur në këmbë. Ku mund të shkonim ne me vajzën kërthi?

Megjithatë, Vegimi filloi të interesohej për ndonjë anije. Bashkë me disa miq arritën ta planifikonin arratinë me një anije të vogël ushtarake, që drejtohej nga një kapiten i marinës së dikurshme mbretërore, e cila do të na merrte diku në një plazh të shkretë. Por ndërkohë që ne prisnim me valixhet gati, na njoftuan se kapitenin e kishin arrestuar. Për fat, ai nuk i njihte njerëzit që do të çonte në Itali. Ndoshta njihte ndonjërin prej tyre. Por nuk nxori emra.

Pas asaj ngjarjeje u përpoqa ta bindja gjyshin e Antuanit të hiqte dorë nga arratia. U detyrova t'i tregoja se familja jonë i kishte ndihmuar komunistët. Vetëm futjen time në grupin komunist, që drejtohej nga njeriu i plagosur, i strehuar në shtëpinë tonë, nuk ia thashë. Për habinë time, ai m'u përgjigj qetësisht:

*– Simonë, e di këtë histori. Por mos të të gënjejë mendja se për atë ndihmë ata do të të jenë mirënjohës.*

*– Patjetër që do të më jenë, – këmbëngula unë. – U kam dhënë napolonat e dasmës.*

Ai nuk foli më.

*– U ankua ndonjëherë për bindjet e tua komuniste? – pyeti vajza.*

*– Kurrë. Edhe në ditët e tij më të zeza. Ishte njeri*

tepër i çuditshëm për kohën. Gjatë rrugës për në Shqipëri unë i tregova për të kaluarën time politike. Ai e pranoi atë pjesë të jetës sime fare qetësisht. Kishte respekt për bindjet e njerëzve, qoftë fetare, qoftë politike. Ama deri në atë pikë ku ato nuk cenonin nderin dhe interesat e të tjerëve.

## VI

Gruaja e moshuar dhe vajza u detyruan të heshtnin një copë herë, sepse Antuani lëvizi dhe ndërroi krah. Një burrë aty pranë u ankua se djali kishte zënë shumë vend. Gjyshja u mundua ta tërhiqte ca të nipin nga vetja.

– Më vjen keq, – tha. – I ka këmbët e gjata.

– Rëndësi ka të mbërrijmë në Itali shëndoshë e mirë, – ia ktheu burri me ton pajtimtar.

– Fli i qetë, do të mbërrijmë.

– Nuk bëhet fjalë për të fjetur, zonjë.

Gruaja buzëqeshi.

– Oh, kisha kaq kohë pa e dëgjuar fjalën zonjë, – tha duke u kthyer nga vajza.

– Nona, si qenë muajt e parë pas luftës? – pyeti ajo.

– Të vështirë, vogëlushe. Tmerrësisht të vështirë.

Gruaja e moshuar ndërroi papritur ton. Ai iu rëndua.

– Rreth e rrotull kishte shkatërrime, uri, sëmundje. Bënte kërدينë sidomos një tifo e morrit të kuq. E hëngri morri i kuq, thuhej për ndonjërin që ndërronte jetë nga tifoja. Unë u futa në organizatën e Gruas Anti-fashiste. Çuditërisht, nëpër mbledhje partie nuk më thërrisnin më. Megjithatë, dilja shpesh nëpër aksione rindërtimi apo bujqësie, larg në fshat. Jepja leksione për higjienën te shoqata “Nëna dhe fëmija” apo koncerte bamirësie, bashkë me burrin e Sarës, nëpër kinematë e qytetit, shtëpinë e kulturës apo atë të ushtarakëve.



Drekave shkoja të puñoja në një ngrënëtoze që u ngrit për të vobektit dhe jetimët. Gatuaja supë.

Në qytet u vendos një rrjet i rreptë triskash, sidomos për bukën. Nuk dije kë të ndihmoje më parë. Familjeve të kamura iu bë thirrje që të jepnin veshje dhe mallra ushqimore për partizanët e zbritur nga malet. Në shtëpinë tonë bamirësia ishte një traditë e vjetër. Çuditërisht, im vjehrr pranoi t'u jepte partizanëve metra të tërë me stof për t'u veshur. Vegimi fali një pallto. Ime vjehrrë këpucë dhe shalle. Unë një çantë me të brendshme për disa vajza partizane, të cilat u hutuan kur i panë dhe në fillim patën turp t'i vishnin.

U krijua ideja se pushteti i ri që po vendosej nuk kishte gjë kundër borgjezisë së qytetit. Një mbrëmje im shoq dhe i ati diskutuan gjatë për disa artikuj, botuar në gazetën e vetme të regjimit të ri, ku theksohej se komunistët e respektonin pronën dhe lavdëroheshin tregtarët e shkathët shqiptarë që kishin krijuar rezerva të mëdha malli në vend.

*– Ti po të duash besoji këto dokrra, – iu drejtua i ati me inat Vegimit. – Ata na e kanë nevojën edhe ca kohë. Nuk ngrihet shteti për dy javë.*

Ishte e habitshme, por ai njeri nuk gaboi kurrë në parashikimet e tij. Kaloi ndonjë vit dhe neve na u kërkua të dorëzonim të gjitha rezervat e tepërta të ushqimeve. Duhej të mbanim vetëm sa për të plotësuar nevojat për tre muaj. Na shtetëzuan shtëpinë në plazh dhe fermën e vogël në fshat. Pas pak muajsh nisi reforma agrare. Im vjehrr u mundua të shpëtonte njërin nga kuajt e mrekullueshëm të racës arabe dhe e solli në qytet, në plevicën ku mbanim pajtonin dhe kalin e tij. Por edhe ajo zgjidhje zgjati fare pak. Humbëm kuajt, pajtonin, pastaj edhe makinën. Mbetëm me dy biçikleta.

Dhe pas të gjitha këtyre tim vjehrrri i kërkuan të paguante një tatim të jashtëzakonshëm për sipërfitimin e kohës së luftës. Bëheshin disa qindra mijëra franga.

– I pagoi?!  
– Sigurisht. Kishte dy rrugë: o tatimin, o kokën. Por

tërë ajo shumë e paguar nuk ia vlejti. Një ditë, para magazinës së tij ndali një xhip ushtarak. Dy oficerë jugosllavë, të shoqëruar nga një shqiptar, hynë brenda dhe filluan të zgjidhnin stofrat më të shtrenjtë. Metra pa fund. Shkruan një pusullë, ia lanë vjehrrit mbi banak, pastaj urdhëruan shoferin t'i çonte mallrat në makinë. Por gjyshi i Antuanit ia ngjeshi banakut me grusht dhe me fare pak fjalë u bëri të ditur se nuk do të merrej asnjë metër stof pa paguar. Jugosllavët nënqeshën. Në ato kohëra ata mund të shkelnin me këmbë këdo. Askush nuk guxonte t'i kundërshtonte.

– *Borgjez i fëlliqur, nuk na njeh kush jemi ne? – iu drejtuan tim vjehrrri.*

– *Nuk më intereson fare, – ua ktheu ai ftohtësisht.*

Ushtaraku shqiptar u përpoq ta bindte tim vjehrr të mos kundërshtonte se mund të djallosej gjithçka, por më kot. Atëherë ata u larguan duke kërcënuar se do të shiheshin shumë shpejt.

Atë mbrëmje stërgjyshi i Antuanit urdhëroi të shoqen të fshihte gjithë gjërat e çmuara që kishin. Ato që nuk mund të fshiheshin, ajo i çoi te fisi i saj. Ishte një mbrëmje e llahtarshme. Im vjehrr kërkoi t'i gatuanim gjërat që i pëlqenin më shumë. Piu verë dhe tymosi duhan deri vonë. Të nesërmen vura re se i dridheshin mollëzat e faqeve. Ra në gjunjë dhe puthi pragun e shtëpisë.

– Nuk do të kthehem më, – na tha. – Mbeçi me shëndet!

E arrestuan pas dy orësh në magazinë, e cila që nga

ajo ditë kaloi në sekuestro bashkë me mallin. Për dy javë tim vjehrr e torturuan egërsisht. I kërkonin të tregonte gjëra qesharake, lidhjet që kishte pasur me gjermanët dhe me një grup armiqësor që ishte dënuar para pak kohësh. Ime vjehrrë kthehej nga godina ku ishin vendosur njerëzit e Sigurimit të Popullit, një ndërtesë katërkatëshe, me rroba të përgjakura. Shumë gra të tjera para saj kishin kaluar nëpër duar rroba të atilla dhe ne e dinim fare mirë ç'po ndodhte.

E binda Vegimin që të shkonim te njeriu që drejtonte seksionin e Sigurimit të Popullit. Bëmë një kërkesë, por ushtaraku që na e mori na tha se ai takim zor se mund të ndodhte. Ne nuk bëjmë takime të tilla, na sqaroi. Por, për habinë tonë, takimi u bë. Na futën në një dhomë të madhe zjarri të mobiluar bukur. Pallati ku ishin vendosur njerëzit e Sigurimit kishte qenë pronë e njëjës prej familjeve më të pasura në qytet. Dhe a mund ta imagjinosh se kë gjetëm në atë dhomë zjarri?

– Atë djalin e plagosur që i shpëtua jetën?

– Po, vogëlushe. Jeta shpesh është e çuditshme.

– A ishte martuar me Sadeten?

– Po. Ai na priti fare shkurt. Ftohtë. Nuk lëvizi fare nga një tryezë e madhe ku ishte mbërthyer me të dyja duart duke imituar kushedikë kokë të madhe të komunizmit botëror. Për supëve të tij, lart në mur, ishte vendosur fotografia e një gjenerali me fytyrë rrumbullake, që qeshte i lumtur. Njeriu që i kishim shpëtua jetën ishte shndërruar në një krijesë tmerrësisht fodulle dhe arrogante.

– *Ky është një revolucion, – na tha. – Nuk mund t'i kursejmë dot njerëz reaksionarë si babai juaj. Veç kësaj, ai quajti armiq shokët tanë jugosllavë.*

Vegimi këmbënguli se e vërteta ishte krejt ndryshe.

Shefi i Sigurimit e vështroi shtrembër.

– Unë u besoj shokëve jugosllavë, – tha, duke na lënë të kuptonim se ajo bisedë ishte e mbyllur.

– Nuk dua t'i dalësh më para atij njeriu, – më tha Vegimi kur ndodheshim jashtë në rrugë. – Mënyra se si të vështronte ishte e neveritshme.

Duke menduar se një femër mund t'ia dalë të zbusë një burrë, unë shkova te Sadetja. Tashmë ajo dhe i shoqi jetonin në vilën e një tradhtari të pushkatuar. Nuk më ftoi të ulesha. U tremb nga vizita ime.

– Më vjen keq, – tha. – Im shoq nuk më pyet për të tilla punë.

Atëherë vendosa të trokisja në shtëpinë e prindërve të saj. Ata m'u ngritën në këmbë. Nëna e Sadetes më puthi dorën. Dinin gjithçka për tim vjehrr. U vinte keq, nuk shtireshin. Kur u kërkova ndihmë për t'i shpëtuar të paktën jetën, ata heshtën gjatë.

– Ime bijë dhe ai krimieli i saj, ai bir kurve, nuk do të shkelin më në shtëpinë time, – tha pastaj babai i Sadetes. – Zonjë, unë nuk e dija ç'ishte komunizmi, se po ta kisha ditur, e kisha mbytur Sadeten me duart e mia. Ata kanë dalë nga rruga e Zotit dhe nuk do të shkelin më në këtë shtëpi. Nëse do të kesh ndonjë hall tjetër, trokit në këtë derë edhe në mes të natës.

Dola e hutuar.

Të nesërmen, natën vonë, vjehrrin tim fisnik e flakën poshtë në rrugë nga kati i katërt i godinës së Sigurimit dhe përhapën lajmin se ai kishte dashur të arratisej. Qava për atë njeri si për babanë tim.

Pak ditë më vonë na urdhëruan të zbrisnim në katin gjysmë nën dhë të vilës, i cili gjatë kohërave të bollëkut kishte shërbyer si depo drush, plaçkash që përdoreshin rrallë dhe vend për të mbajtur zahiretë. Gjatë dimrave

të egër të atyre kohërave atje kishte shumë lagështi dhe bënte tmerrësisht ftohtë. Kur ti, vogëlushe, fillove të hyje në shtëpinë tonë, ishte disi më ndryshe. Tani dimrat kanë filluar t'i ngjajnë vjeshtës.

Në dy katet e vilës lamë shumicën e plaçkave tona. Morëm vetëm rrobat e gjumit, disa nga sendet më të nevojshme dhe një pjesë të bibliotekës. Unë nuk pranova ta lija pianon time atje. E zbritëm poshtë në depon e druve dhe e mbuluam me një batanije, ndonëse gjyshi i Antuanit ishte i bindur se koha e asaj pianoje kishte përfunduar përgjithmonë. Në katin gjysmë nën dhe sajuam një kuzhinë primitive. Për banjo as që bëhej fjalë. U detyruam të ndërtonim një kthinë jashtë në oborr. Në vilë u strehuan dy familje ushtarakësh dhe e një ekonomisti të ardhur nga Tirana, që punonte në Komitetin Ekzekutiv.

Një natë dimri, ndërsa ishim mbledhur rreth sobës, gjyshi i Antuanit më kërkoi papritur të dilnim. Lashë vajzën e vogël në krahët e sime vjehrrë dhe u veshë. Në bulevardin kryesor lëviznin pak njerëz. Ishte hapur vetëm ndonjë hotel dhe ndonjë restorant, pa llogaritur lokalet e ndriçuar me fenerë, ku të mbyste bloza dhe luhej bixhoz fshehurazi. Një patrullë e Policisë Popullore kishte ndalur te lokali i famshëm "Kafe-aheng Erzeni i qetë", ku dikur kishte pasur edhe këngëtare italiane, por pas luftës gjithçka përfundoi te valltaret cigane dhe në depon e prasmë mund të gjeje edhe ndonjë prostitutë. Patrulla e policisë arrestoi disa tipa që kishin bërë sherr.

Një patrullë tjetër na ndali në sheshin e qendrës dhe na kërkoi dokumentet. Na pyetën ku po shkonim.

– Thjesht po shetisim, – iu përgjigj Vegimi.

Ata na lejuan të largoheshim duke na vështruar me dyshim. Morëm Rrugën Tregtare në heshtje, siç kishim

dalë nga shtëpia. Shkuam deri në breg të detit, ndonëse atje ishte njëlloj si t'i afroheshe kufirit. Frynte një erë e ngatërruar. Klithmat e pulëbardhave nëpër errësirë të ngjethnin. Dallgët që ndiqnin njëra-tjetrën si të tërbuara nuk e linin korin e zhaurimave të reshtte.

E ndjeva ç'bisedë më priste.

– *Simonë, të huajt po i lejojnë të largohen, – tha gjyshi i Antuanit. – Të lutem, ik edhe ti! Merr edhe vajzën. Mbase do të gjejmë një mënyrë për t'u bashkuar.*

– Kurrë! – iu përgjigja pa lëkundjen më të vogël. – Sikur ta di se më dërgojnë në fund të detit.

Ai m'u lut të mendohesha. Dyshonte se fati ynë do të merrte tatëpjetën edhe më keq. Ia bëra të ditur e prekur se do të ndihesha tmerrësisht e fyer nëse do ta hapte më atë bisedë. Më puthi gjatë, shumë gjatë, ndoshta sa njëqind dallgë që erdhën dhe u shuan në breg të detit. Megjithatë, nuk foli asnjë fjalë. Vdekja e të atit e kishte ndryshuar jashtë mase. Një periudhë kohe m'u bë gati i panjohur. Edhe mënyra se si bënte dashuri më dukej ndryshe.

Papritur u shtrëngua fort pas meje dhe u shkreh në një të qarë të frikshme. Atëherë e lashë të qante. Ndërkohë e përkëdhelja, i flisja për ta qetësuar. Vogëlushe, nganjëherë burrat janë si fëmijët. Kërkojnë te gruaja nënën. Kjo ndodh në çaste dobësish, zhgënjimesh, dëshpërimi. Ai e kishte nënën e tij në shtëpi, por nuk guxonte as të psherëtinte para saj. I dukej sikur hija e të atit e përgjonte. Burrit nuk i lejohej asnjë lloj dobësie apo dorëzimi. Ky ishte kodi me të cilin im vjehrr kishte jetuar dhe kishte vdekur. Edhe i biri duhej ta respektonte deri në fund atë kod.

Nuk e dëgjova kurrë as time vjehrrë të ankohej apo të rënkonte, ndonëse ishte rritur dhe kishte jetuar deri

vonë si një zonjë e madhe. Ajo vetëm lutej para ikonës së Shën Marisë, e bindur se Zoti e kishte vënë para një prove që duhej kapërcyer.

– *Para fatit duhet të nënshtrohemi deri në fund, – më tha një ditë. – Përgatitu mirë për këtë.*

Ajo nuk e kuptonte dot se ku besoja unë, megjithatë, kurrë nuk më kërkoi të gjunjëzohesha para ikonës së saj. Po priste në heshtje ato që do të ndodhnin. Provën time të dashurisë ndaj të birit. Ne i ngjanim njëra-tjetrës. E nuhasnim në ajër atë detaj.

Në një nga ato ditë të trazuara takova te merkatoja e madhe e qytetit Sarën. Kishim kohë pa ndenjuri bashkë. Ajo më përqafoi me dhembshuri. Duket se i bëri shumë përshtypje pamja ime, sepse më pyeti e trembur:

– *Simonë, je mirë?*

– Mbahem, – iu përgjigja.

– *Më vjen keq për atë që ju ndodhi, – tha.*

E falënderova për ngushëllimin, pastaj e pyeta për gjendjen nga familja e saj.

– *Të paktën deri tani të gjithë janë gjallë, – m'u përgjigj.*

Bëmë pazarin bashkë, duke diskutuar gjëra krejt të zakonshme të shtëpisë dhe kuzhinës. Asnjëra nuk guxonte të pyeste për ikjen, ndonëse e lexonim në sytë e njëra-tjetrës atë mendim. Vetëm kur po ndaheshim dhe ajo m'u largua disa hapa, unë i fola:

– Sara, ti do të'ikësh?

Ajo u kthye. Flokët e gjatë ia ngatërronte era. Mollëzat e ngritura të faqeve i ishin skuqur. Më vështroi gjatë me sytë e saj të ëmbël e të bukur.

– *Jo, – u përgjigj pastaj. – Nuk e bëj dot. Po ti?*

Tunda kokën gjatë në mënyrë mohuese. Atëherë, ajo u kthye dhe më përqafoi. Ndenjëm gjatë ashtu në krahët e njëra-tjetrës. Ishim të huaja në atë qytet. Të huaja.

Vogëlushe, do ta provosh edhe ti ç'do të thotë të jesh e huaj diku dhe atëherë do të më kup-tosh, ndonëse jetën do ta kesh më të lehtë, shumë më të lehtë.

Unë dhe Sara ndanim të njëjtin fat. Asaj i kishin burgosur vjehrrin, një studjues dhe profesor gjimnazi. Me të shoqin nuk dihej ç'do të ndodhte. Edhe Sarën e kishte prurë në Shqipëri një dashuri nga ato fatalet, të çmendurat, kur të duket se popullsia e botës përbëhet vetëm nga dy vetë. Prindërit e saj ishin përpjekur deri minutën e fundit ta pengonin që të largohej nga Italia. Por... jetët e njerëzve janë romane të përfunduar. Askush nuk mund t'i ndryshojë dot ngjarjet e tyre.

Ajo u bë vetvetiu ndër njerëzit e mi më të afërt. Trokisja në derën e saj në ditët e mia më të vështira. E gjeja gjithmonë të qeshur. Ëmbëlsia nuk mungoi kurrë në sytë e saj. Ky ishte një mister. Nuk e shpjegoja dot. Me sa dukej, ajo futej tek ata pak njerëz që Zoti i sjell mbi tokë për të përhapur rrotull ëmbëlsinë dhe ngrohtësinë e tij.

– Pra, nuk ishte një ëmbëlsi thjesht femërore?

– Jo, vogëlushe, jo vetëm aq. Ishte njerëzore. Rrallë, shumë rrallë e kam ndeshur tek të tjerë.

Një ditë më rastisi të takohesha me të në çastet më humnerore të jetës sime. Unë po dilja nga ndërtesa e Komitetit Ekzekutiv. Më kishin thirrur atje për të më vënë në dijeni se si shtetase e huaj isha e lirë të largohesha, përderisa nuk kisha bashkëpunuar me pushtuesit. Në rast të kundërt, duhej të hiqja dorë nga nënshtetësia belge dhe t'u nënshtrohesh ligjeve të shtetit shqiptar si gjithë të tjerët. Vogëlushe, që të mos dalë vetëm heroinë para teje, në ato çaste jam trembur po njëlloj si atëherë kur njerëzit e Gestapos erdhën te Bliret. Kërkova kohë të mendohesha. Ma dhanë.



Kur kisha dalë jashtë, në sheshin para ndërtesës së komitetit, u ndesha me Sarën. Edhe atë e kishin thirrur. Fytyra ime duhej të kishte marrë një pamje krejtësisht të vajtur, sepse mikja ime m'i nguli sytë e tronditur. Nuk më foli. As unë.

Ai takim i llahtarshëm u përsërit pas disa ditësh. Këtë herë në një korridor. Ajo po dilte. Unë po vija. E kuptova se, njëlloj si unë, edhe Sara kishte kërkuar kohë të mendohej. Kuptohet, ia kishin dhënë. Ajo u ndal dhe më vështroi. Sytë iu njomën nga lotët tek më buzëqeshi. Do të ndjek fatin tim deri në fund, më thanë ata. Çdo dashuri e madhe ka një çmim. Atëherë edhe unë i buzëqesha. Kishim vendosur të dyja të hiqnim dorë nga nënshtetësitë tona.

– Dhe... jua hoqën?

– Në të vërtetë, jo. Atëherë vetëm na provokuan. Heqja e nënshtetësisë ndodhi shumë më vonë, nga fundi i viteve '60.

Atë ditë, kur mbërrita në avokatoren e gjyshit të Antuanit, ai e kuptoi se kisha hedhur hapin më fatal të jetës sime. Më qe lutur të mos e bëja. Ashtu si atë natë në breg të detit, më kishte kërkuar të merrja vajzën dhe të ikja. Ai do të arratisej dhe do të bashko-heshim shumë shpejt. Por unë e dija se ai nuk do të vinte më në Belgjië. Nuk mund ta braktiste nënën e tij. I thoshte ato fjalë për të më shpëtuar nga ferri që më priste.

– Nuk iki, – iu përgjigja rishtazi. – Nuk dua që ty të të vrasin kur të arratisesh.

Ai më përqafoi si i mpirë.

– *Simonë, më fal! – tha. – Nuk e parashikova se ngjarjet do të rridhnin kështu.*

– Do të jemi bashkë çfarëdo që të ndodhë, – iu përgjigja.

Pastaj ... eh ... nuk kishim bërë ndonjëherë dashuri në avokatore. Ti e kupton. Ndodhin nganjëherë ngjarje në jetë që të shtyjnë të bësh dashuri sikur do të ishte hera e fundit. Si atë natë kur erdhën njerëzit e Gestapos. Një avokatore është vendi më pak romantik për dashuri. Megjithatë, gjyshi i Antuanit arriti të mbyllte derën ndërkohë që ne ishim kapërthyer me njëri-tjetrin në mënyrë të pandashme, sikur të kishim ardhur në këtë botë ashtu, të bashkuar, si një guackë dhe një copë shkëmbi detar. Këto lloj dashurish nuk harrohen dot më, vogëlushe. Ashtu siç nuk do ta harrosh ti dashurinë e sotme para nisjes.

## VII

Gruaja e moshuar e përkëdheli vajzën në supe. Vështronin të dyja të heshtura një copë të papërcaktuar qielli, ku tashmë Hëna kishte humbur. Diku larg vetë-tinte. Deti po ngrinte dallgë gjithnjë e më shumë.

– Nona, si rrodhi jeta më tej në shtëpinë tuaj? – pyeti vajza, duke e ndier se atë natë nuk do të kishte gjumë.

– Si kjo pjesë udhëtimi, vogëlushe, – u përgjigj gruaja e moshuar. – Dallgët sa vinte e shtoheshin. Gjithçka u katandis në luftë për mbijetesë. Nuk kishte bukë, sapun, rroba për t'u veshur. Ne ishim familje reaksionare dhe këshilli popullor nuk na jepte triska. Me një triskë, një njeri që nuk punonte mund të merrte 400 gramë bukë, ndërsa punëtorët e fronteve të vështira 700.

– Po si jetonit?!

– Ashtu. Ka periudha kur stomaku tregohet miqësor, ngushtohet. Hanim pak. Lufta kryesore bëhej për të ushqyer time bijë. Bukën dhe miellin i gjenim në tregun e zi. Unë bëja një lloj kontrabande me një fshatar që vinte rregullisht në merkato. Më kujtohet edhe emri tij. Sherbet e quanin. Blija tek ai zarzavate, bulmet dhe më të rrallë fruta. Sherbeti e fshihte mjeshtërisht bukën ose miellin në shportën time. Ndërkohë edhe vjehrra ime bënte të njëjtën kontrabandë me një furrëtar të lagjes. Në ato kohëra, të shisje bukë pa triskë ishte një krim i rëndë. Por furrëtarin ia doli për ca kohë. Pastaj e spiunuan dhe e burgosën. Ndërsa një shofer ku blenim

sheqer dhe oriz të vjedhur e pushkatuan.

Ishte një klimë e frikshme. Zhurma më e vogël të dëgjohej jashtë dhe ne ngrinim. Arrestimet nëpër qytet ishin bërë gjëja më e zakonshme. Mbyllja brenda ishte më e ankthshme, ndaj ne dilnim edhe kur ishte ftohtë apo shi. Mezi prisnim të dilte ndonjë film i ri. Nëpër depot e kinemave kishte ende me shumicë filma amerikanë, francezë dhe italianë. Ndonjërin prej tyre detyroheshim ta shihnim për herë të dytë: Shtrengoheshim pranë njëri-tjetrit në sallën e ftohtë, duke ngushëlluar veten se të paktën deri në fund të historisë që po shikonim nuk do të na e prishte njeri qetësinë.

Por një mbrëmje zhurma gërricëse e aparateve u ndërpre, u ndezën dritat dhe në kinema ia behën disa policë. Kapën një vjedhës që kishte hyrë në një banesë. Ndërkohë unë ndjeva se si dora e tim shoqi u mbulua me djersë të ftohta. Nuk do të ndodhë sonte, mërmëriti ai.

Kur rastiste që filmin ta kishim parë dy herë, atëherë detyrohe-shim të shëtisnim në këmbë ose shkonim nëpër miq. Që pas ngjarjes me tim vjehrr, nëpër taverna dhe lokale ku kërcehej nuk shkonim më. Megjithatë, nata mbeste e gjatë, tmerrësisht e gjatë. Arrinim të flinim vetëm pasi kishte kaluar mesi i saj.

Një mbrëmje ia mbërriti një mik i Vegimit dhe na njoftoi se pritëshin kontrolle për librat që intelektualët mbanin nëpër shtëpi. Duheshin asgjësuar të gjithë shkrimtarët reaksionarë. Dhe më e keqja ishte se në atë kohë ne nuk njihnim ndonjë shkrimtar revolucionar. Vumë librat para dhe u ulëm pranë sobës. Na vinte keq t'i flaknim. Ata mund të bënin shërbimin e fundit dhe më fyesin, të na ngrohnin. Filluam të zgjidhnim ata që na dukeshin më të rrezikshmit, por nuk mbeti asnjë i parrezikshëm, përveç Hygoit dhe rusëve të famshëm,

me në krye Tolstoin. Fillimisht u dogjën shkrimtarët italianë, pastaj ata anglezë dhe amerikanë. Armiqësimi me Amerikën dhe Anglinë ndërkohë po vinte në rritje.

Më kujtohet kur i erdhi radha romanit "Tesi e Debërvilëve". Iu luta gjyshit të Antuanit të më lexonte pjesën që ai mendonte se ishte më e bukura. Ai e zgjodhi. Filloi të lexonte me një zë kumbues e të dridhur. Unë isha pështetur në supin e tij dhe qaja. Ishte fragmenti kur Tesi bën për herë të fundit dashuri, para arrestimit. Kur libri përfundoi në sobë, shkëlqimi që lëshuan flakët e tij sikur më përzhiti lëkurën.

Pastaj i erdhi radha Floberit, Mopasanit. Lexonim pjesët më të bukura të romaneve dhe pastaj i digjnim. Nuk ndienim gjumë. Nuk e kuptonim se si orët kalonin pa u ndier. Por ajo masakër u ndërpre kur i erdhi radha librit "Gargantua dhe Pantagryel". Ishte një vepër për të cilën ne mbaronim të dy. Sa herë ishim të dëshpëruar ku s'mbante më, lexonim kapituj të tij dhe humori na ngrihej. Vegimi më lexoi kapitullin ku Gargantuaja rrënon kështjellën e Ge dë Vedës duke shkukur një trung peme dhe duke e përdorur atë si kopaçe. Kalova nga e qara në të qeshur. E si mund të mos qeshje kur Gargantuanë e godisni me gjyle topi dhe ai pandehte se ishin kumbulla? Po kur u hyn flokëve me krëhërin e tij me dhëmbë elefanti dhe pas çdo krehjeje rrëzonte përdhe shtatë pirqje me gjyle topash që i dilnin nga flokët?

– E di, nona, e kam lexuar këtë kapitull bashkë me Antuanin.

– Papritur im shoq u ngrit.

– *Jo, mjaft! – tha i prekur. – Nuk do të djeg më asnjë libër. Do t'i fus në një thes dhe do t'i çoj diku.*

Iu luta ta mbanim "Gargantuanë". Ai pranoi.

Pak ditë pas atyre librave të djegur, një natë dimri të

vitit 1947, njerëzit e Sigurimit erdhën e morën gjyshin e Antuanit në shtëpi, pas mesit të natës. Nuk i lanë kohë as të lidhte këpucët. Unë hodha pallton krahëve dhe vrapova duke thirrur pas njerëzve që e arrestuan. E dija mirë ku do ta çonin. Mbërrita duke dihatur te ndërtesa ku kishte humbur jetën im vjehrr dhe vazhdova të çirresha e të kërkoja shpjegime.

Ndërkohë, nga dritarja e ndriçuar mirë e një zyre diku në kat të tretë dikush po më vështronte. Pas pak zbriti një oficer dhe më mori deri në shtetë. Unë e kisha shpëtuar jetën. Gëndrova para tij e ngashëryer me flokë të shpirtshkur. Këmisha më dilte nën pallto. Ai ia nguli sytë asaj pjese të zbuluar të këmbëve të mia, pastaj e ngriti vështrimin te jaka e hapur e palltos. Sy ujku në pranverë, që kërkojnë një femër për t'u çiftuar. U mek gjatë. Gëlltitej kohë pas kohe. M'u duk vetja e zhveshur para atij vështrimi. Nganjëherë meshkujt të përdhunojnë me sy. Ndodh rëndom. Te meshkujt e uritur ose të pakënaqur seksualisht. Është gjëja më e neveritshme që duhet të durojë një femër e bukur.

– Jo tim shoq, – i folta, – ai nuk ka bërë asgjë kundër jush.

Ai nënqeshi.

– Faktet flasin ndryshe, – tha. – Për fatin tënd të keq...

U ngrit, bëri disa ecejake rrotull zyrës, pastaj u ndal pas meje. Unë nuk lëviza. Ndieja se si flegrat e hundës së tij thithnin aromën e trupit tim ende të ngrohtë.

– Por këtë herë do të përpiqem të të ndihmoj, – vazhdoi.

– Simonë, ti nuk e di, por... unë u marrosa që atë natë kur ti kujdeseshe për plagën time. Nuk kisha parë grua si ti. Deri atë ditë kisha shkuar vetëm me një kurvë që më kishte ngjitur një sëmundje...



M'u kujtua magjepsja e tij kur unë flisja nëpër mbledhje për komunizmin, sytë e perënduar dhe goja e hapur. Kujt mund t'i shkonte nëpër mend!

– Kam fjetur shpesh me ty, – vazhdoi ai, duke qëndruar gjithmonë pas kurrizit tim. – Më ikte mendja. Edhe pasi u martova me Sadeten. Të kisha ty para syve, pastaj hidhesha mbi të. Një natë thirra pa dashur emrin tënd. Ajo e dëgjoi, por u shtir sikur kishte qenë ndryshe. Ajo e di që mendjen e kam te ty...

Dora e tij më preku në emër. Atëherë u ktheva me vrull dhe ia ngjashëm me gabullë durratim me tërë fuqinë e krahut tim të djathtë.

– Po guxove përsëri të më prekesh, do të t'i nxjerr sytë më thonj! = ulërita.

Çuditërisht, ai u duk i kënaqur.

– Më godit përsëri, – tha. – Unë vetëm tregova disa gjëra.

E kërcënova se do ta padisja. M'u përgjigj se po të ndodhte ashtu, tim shoq e priste plumbi dhe pastaj do të më vinte radha mua.

– Unë desha të të ndihmoja, – tha.

– Nuk e dua atë lloj ndihme! – i ulërita në fytyrë. – Nuk e vë në pazar nderin tim dhe të tim shoqi.

– Atëherë, ti mbaj nderin dhe ai le të kalbet në burg, – qe përgjigjja.

– Ju nuk jeni komunistë, por terroristë! – thirra. – Vrasës! Ju nuk ju lidh asgjë me komunizmin.

Ai nënqeshi.

– Edhe raca e tët shoqi do të na kishte vrarë si mizat po të merrte pushtetin, – tha qetësisht. – Kjo është provuar. Pse të mos vrasim ne të parët? Tani, dil nga zyra ime! Do të të shoh kur të të vijnë mendtë. Kuçkë! Mos m'u hiq mua si e ndershme.

– Kriminel! – ia ktheva.

– Oh, kjo fjalë për mua është një dekoratë kur e thonë bushtrat e borgjezëve, – qeshi ai.

Dola në rrugë duke u dridhur dhe deri në të zbardhur ndenja zgjuar, duke pyetur veten se a i duhet hapur dera kujtdo që kërkon ndihmë dhe a i duhet bërë mirë një të panjohuri. Kisha marrë një shpërblim shumë të hidhur. Kafshim gjarpëri që shkarkoi helm. Për vite me radhë.

– A e denoncove atë njeri?

– Nuk guxova.

– Po ai, u hakmor?

– Jo. Ndoshta e pengoi nënshtetësia ime. Ndoshta priti që unë të dorëzohesha. Më shumë ka të ngjarë të jetë kjo e dyta. Atyre nuk u bëhej shumë vonë për nënshtetasit e huaj.

– A munde ta takoje ndonjëherë gjyshin e Antuanit në hetuesi?

– Nuk bëhej fjalë. Gjatë atyre hetimeve shkatërruese unë dhe ime vjehrrë, për herë të dytë, filluam të çonim në burg rroba të lara dhe të merrnim mbrapsht rroba të përgjakura. Më të rrallë na pranonin ndonjë ushqim. Më kujtohet si sot një ditë me shi kur nuk m'i pranuan as rrobat e as ushqimet. U tmerrova. Vendosa të prisja e t'i lutesha ndonjë polici të më tregonte ç'kishte ngjarë. Aty pranë meje prisnin edhe të tjerë.

Nuk e harroj dot një djalë 10-vjeçar, i cili ishte përkulur mbi një korrocë fëmijësh, për të mbrojtur me trupin e tij nga shiu një foshnjë që qante sa të therte në shpirt. Kishte orarin e të pirit. Djali e kishte prurë që e ëma ta ushqente. Ajo ndodhej në burg. E kishin arrestuar bashkë me të shoqin për ta trembur, që të tregonte flarinjtë e fshehur. E qara e foshnjës u bë e padurueshme. E mora, zbulova gjoksin dhe u përpoqa ta mash-



troja duke i futur thithkën në gojë. Ia arrita për disa minuta. Por foshnja e kuptoi mashtrimin dhe iu rikthye të qarës. Më në fund njëri prej policëve e njoftoi djalin të futej brenda. Iu afrova policit dhe duke i kujtuar gruan e tij, iu luta të më tregonte ç'po ndodhte me tim shoq.

– Është gjallë, – m'u përgjigj ai. – Kjo ka rëndësi.

Pas pak kohësh gjyshin e Antuanit e dënuan me 12 vjet punë të rëndë. E çuan në një kamp të llahtarshëm pune të detyruar mes mushkonjave dhe sëmundjeve. I vetmi ngushëllim i atij dënimi qe afërsia. Diku mes ca fshatrave të humbur nëpër kënetat po hapej një kanal i madh kullimi. Kur shkuam për herë të parë në atë kamp bashkë me time vjehrrë, m'u duk se përshkuam tërë baltërat e botës. Papritur ngecëm në një humbëtitë gri në të verdhë, rrethuar nga një erë mbytëse. Shikonim vetëm disa sorra të mbledhura në degët e një akacieje të zhveshur. Edhe qielli kishte marrë ngjyrën e baltës. Krakavitjet e sorrave të ngjethnin. M'u duk se nuk do të na gjenin më. Do të mbesnim aty palosur mbi baltë si dy rosa të vrara. Fillova të thërrisja e tmerruar. Më përmendi vetëm shtrëngimi i vjehrrës në krah e cila tha qetësisht se nuk ishin rrethuar nga ujkit. Më në fund, një fshatari që po kalonte me qerre aty pari, i tërhoqën vëmendjen thirrjet e mia dhe erdhi e na ndihmoi.

Mbërritëm rrëzënjë kodrine të zhveshur, te disa kapanone të ulët e të pistë, me skelete druri, veshur nga jashtë me rrogözë dhe mbuluar me letër katrama, rrethuar me tela me gjemba. Ngjanin si breshka gjigante në një gjumë të thellë. Dukej sikur atje nuk jetonte njeri, ndonëse ishte e dielë, e vetmja ditë kur nuk punohej. Vetëm një oxhak i shtrembër llamarine nxirrte tym. Sheshi mes kapanoneve ishte kthyer në baltovinë. Një polic zgjati kokën nga dritarja e një kolibeje, si ajo

breshka kur nxjerr kokën nga zhgualli i saj kështjellor dhe na pyeti me bezdi ç'kërkonim. Ime vjehrrë iu përgjigj.

– Ja, të flas me të madhin, – tha ai dhe doli nga kolibja. – Nëse yt bir s'i ka bërë naze punës, edhe mund ta takosh.

Polici shkoi diku në një zyrë duke u lëkundur nëpër baltë. U detyruam të prisnim gjatë. Më në fund ai u kthye dhe pasi kaluam një portë që gërviste si një tufë korbash, na futën në një kthinë të errët ku kryheshin takimet me të dënuarit. Kur im shoq erdhi aty, në fillim nuk e njoha. Rrobat e ndotura i vëshnin në trup. Në kokën e qethur mbante një kasketë të zhubrosur. Mjekra e parruar i binte në sy në fytyrën e hequr, si shkurret në një livadh. Fytyra kishte filluar t'i merrte ngjyrën e baltës. Buzët i ishin çarë, ashtu si edhe lëkura e duarve. Kishte ethe. Dridhej dhe kohë pas kohe dhëmbët i kërcisnin. Shikimi i ishte zbehur, sytë i kishin humbur në zgavra dhe dukeshin si të ngarkuar me trishtimin e një shkretë-tire të tërë. Na u duk sikur na shikonte që nga një botë tjetër.

Unë fillova të qaja. E humba besimin se ai do të dilte më gjallë nga ai vend. Ia ngula sytë sikur të kisha para një fantazmë. Vetja m'u duk e braktisur, e mbetur në mes të një oqeani, mes errësirës dhe dallgëve. Më mbërtheu një ndjenjë paniku, filloi të më mbahej fryma dhe mend klitha. Por në ato çaste gjyshi i Antuanit zgjati dorën, më shtrëngoi në sup dhe buzëqeshi.

– Simonë, dukem kështu se jam sëmurë, – tha. – Duhet të jetë malarje. Do të kalojë. Më sill një kurë mepakrine dhe të jesh e bindur që do të më kalojë. Këtu ka vetëm aspirina. Të lutem, mos më shiko ashtu! A më ke sjellë ndonjë gjë të mirë për të ngrënë?

Edhe unë i buzëqesha mes lotëve. Gjoja buzëqesha. Në të vërtetë duhet të jem ngërdheshur për lemeri. Por ankthi filloi të më lëshonte.

– *Në jetë ka edhe më keq, – foli papritur ime vjehrrë me një zë të akullt. – Duhet të mbahemi. T’i nënshtrohemi fatit deri në fund. Një burrë duhet t’i dalë vdekjes përballë. Ta ndalojë, ta trembë. Shporru shtrigë, t’i thotë. Nuk ke punë me mua.*

Deri atë çast ajo nuk kishte dhënë asnjë shenjë dobësie. M’u duk e e mermertë. Sikur të kishte pasur tre djem dhe dy prej tyre t’ia kishin kryqëzuar me gozhdë. I biri ia mori dorën dhe ia puthi. Do t’ia dalësh mbanë, i foli ajo, do të kthehesh në shtëpi. Vegimi hëngri pak nga gatimet e mia, i lavdëroi, pastaj më buzëqeshi përsëri dhe m’u lut t’i flisja për vajzën. Më pyeti në ishte bërë e bukur dhe unë e ndjeva se jeta nuk mund të ndërpritej aq lehtë. Fillova t’i tregoja. E binda dalngadalë atë dhe veten time se nuk ishim vetëm.

Ime vjehrrë doli e para nga ajo kthinë e zymtë për të na lënë bashkë. Arritëm të përqafoheshim vetëm një herë, duke u dridhur, sepse nga jashtë zgjati kokën një polic.

– *Simonë, do të mbijetojmë, – më pëshpëriti gjyshi i Antuanit në vesh.*

– Do të mbijetojmë, – iu përgjigja.

Vetëm në çastet e fundit, kur duart tona po ndahehin, ai e tradhtoi veten. U skuq si adoleshent, buzët iu drodhën, në cepat e syve i feksën dy pika loti. Dhe a e di çfarë më tha?

– *Simonë, e shtrenjta ime, të dua.*

– ... përjetësisht.

Ajo ishte hera e parë që m’i tha ato fjalë. Dhe pas atyre fjalëve unë u ktheva në përbindësh. Isha gati ta

shqyeja me thonj këdo që do të guxonte të më ndante prej tij. U hyra baltërave me gjunjë. Ai shteg i humbur mes moçaleve m'u bë bulevard. Vende-vende e mbajta edhe time vjehrrë në shpinë, deri sa kalonim moçalin e radhës. Me të mbërritur në shtëpi, nxora diku thellë mes ndërresave të mia dy nopolona nga ato të dasmës, të cilat tani nuk tringëllinin më me njëra-tjetrën, sepse po mbaroheshin. Me njërën prej tyre bleva ilaçet më të domosdoshme që mund t'i duheshin një të dënuari që punonte mes moçaleve. Ndërsa me tjetrën mish dhe disa ushqime. Të dielën tjetër çava përsëri mes baltërave.

Por atë ditë të burgosurit e mjerë i kishin nxjerrë në punë për dënim. U detyrova të prisja në afërsi të kampit bashkë me disa gra të tjera të dënuarish, deri sa ata u kthyen në të errur. E bëmë një copë rrugë përbri tyre, ndonëse policët na shikonin shtrembër dhe na bërtisnin që të largoheshim. Ata ecnin të sfilitur brenda në kanal. Në të vërtetë, lëkundeshin si ata kallamat buzë moçalit që i rrihte era. Ishin llangosur me baltë ngado. Policët godisnin me bishta lopate këdo që guxonte të ngadalsonte hapin. Herë pas here ndonjëri rrëzohej. Para se policët të afroheshin për ta goditur, shokët e ngrinin, mundoheshin ta përmendnin, pastaj e tërhiqnin gati zvarrë nëpër baltë. Secila nga ne gratë uronte që i rrëzuari të mos ishte burri i saj dhe të gjitha mendonim se burrat tanë ishin aq të fortë, sa të mos ia lejonin vetes të rrëzoheshin ashtu.

E njoha gjyshiin e Antuanit lehtësisht mes asaj morie gjethesh të thara që era mund t'i shkundte nga çasti në çast drejt baltës. Ai çante përpara me gjunjë të thyer dhe i kërrusur. Ndërsa e vështroja, për herë të parë ëndrra e vjetër e komunizmit krisi brenda meje, u zbeh, u kthye në një përrallë me shtriga dhe shtriganë.

Ndoshta që atë ditë fillova ta urreja atë diell që dikur më kishte magjepsur. Nëse duan ta ndërtojnë komunizmin mbi vuajtjet e këtyre njerëzve, për të lumturuar gjysmën tjetër revolucionare, kurrë mos u ndërtoftë, mendova.

Më pa edhe im shoq. Fytyra e perënduar ngjyrë balte prej malariku i qeshi. Të paktën ashtu m'u duk mua. Duhej ta njihje thellësisht një njeri që të dalloje të qeshurën në atë gjendje që i ishte katandisur fytyra. Ndoshta edhe ai mund të ishte rrëzuar atë ditë. Por nuk ndodhi. Ndoshta e dinte se unë do të vija me ilaçet shpëtimtare.

*– Simonë, mos i lër ata të më vrasin, – m'u ut ai. – Këtu jeta nuk ka asnjë vlerë.*

I premtova se ajo gjë nuk do të ndodhte.

Atë natë, ne, grupi i grave të të dënuarve, u kthyem nëpër errësirë. Shtrëngonim në duar gurë dhe hunj. Qentë na lihnin ngado. Na ndiqnin pas. Kaluam përmes dy fshatrave, por askush nuk guxoi të nxirrte kokën në derë. Ndërsa çanim përmes pellgjeve dhe baltës, nën një qiell që ishte varur i errët deri mbi kokat tona si një kapak i rëndë pusi, m'u duk se jeta është vetëm udhëtim. Kur dolëm tutje, në rrugën e makinave, me armët tona shpëtimtare ende shtrënguar në duar, një shofer u ndal. Ndoshta nga frika, ndoshta nga habia. Por kur mësoi nga vinim, nuk na mori. U detyruam të flinim jashtë, ngjeshur shpinë më shpinë si një grup luftëtarësh spartanë kur priste sulmin e armikut, me armët tona primitive nxjerrë në pah. Eh, kushedi sa herë u përsëritën ato të fjetura jashtë!

Tani nuk mundem ta them dot me saktësi se sa kilometra mund të kem bërë nëpër baltë në ato vite. Krahas dhunës që kishte rënë mbi familjen time, balta do të ketë qenë shkak i dytë që fillova ta urreja komunizmin,

bashkë me mushkonjat, malarjen dhe sëmundje të tjera të shpifura që im shoq duroi mbi trupin e tij në atë kamp të ndyrë dhe në disa kampe të tjerë.

\*

\*

\*

Vajza afroi dorën te fytyra e gruas së moshuar dhe i largoi nga fytyra një tufë flokësh.

– Nona, nuk të ndodhi kurrë që të... lëkundeshe?

Tjetra nguroi të fliste një copë herë.

– Ti, si mendon?

– ...

– Vogëlushe, vendosëm të jemi të sinqerta me njëra-tjetrën!

– Them se duhet të ketë ndodhur.

– Nuk mund të ishte ndryshe. Të gjitha ne gratë lëkundemi, vogëlushe, tundohemi. Jemi bija të Evës. Bija të mëkatit të parë. Por fisnike janë ato që fitojnë mbi lëkundjet dhe tundimin.

Ndërkohë unë u detyrova të filloja punë si rrobaqepëse te "Parajsa e grave", tek ai lokali i modës në Rugën Tregtare, ku pas martesës shkoja shpesh me Sarën për t'u veshur me gjëra të zgjedhura. Mjeshtri i rrobave për gra, që dikur kishte qepur për parizianet, vazhdonte të mos dorëzohej. Vetëm lokali i tij dhe pak të tjerë kishin mbetur pa hyrë në kooperativën e artizanatit, pra në vathën shtetërore. E mësova zanatin e rrobaqepëses po me inatin dhe këmbënguljen time prej mushke, me të cilën kisha mësuar dikur pianon. Rroga që merrja atje ishte i vetmi burim jetese për katër vetë. Pothuaj çdo javë nisesha me çantën me ushqime për tek im shoq.

Një paradite, ndërsa mjeshtri po pinte kafe diku aty

pranë, në rrobaqepsi hyri një tip që më habiti. Nuk e kisha parë ndonjëherë në qytet. Ishte i gjatë, diku te të tridhjetepesat, natyrë e qeshur, me flokë bjond të prerë karë. Kishte veshur një pallto të gjatë dhe mbi gjoks kishte lidhur nyje një shall leshi. Mbante nën krah një copë stofi. Përshëndeti frëngjisht me një pamje të ndrojtur. Iu përgjigja miqësisht. Atëherë, me një frëngjishte që shartohej shpesh me italisht, ai më bëri të ditur se donte të qepte një kostum.

Që nga mënyra se si më vështronte e kuptova se kostumi ishte vetëm shkaku për të hyrë në rrobaqepsi.

– Oh, më vjen keq, këtu qepim vetëm për zonja, – i thashë.

Ai mori një pamje ankuese.

– *Është e pamundur që një rrobaqepës të mos qepi edhe për zonja, edhe për zotërinj, – tha.*

– Ja që ndodh, – ia ktheva.

– *Atëherë, do të pres mjeshtrin, – këmbënguli ai.*

E ftova të ulej.

– Kush ishte ai tip?

– Një inxhinier portesh, kroat. E quanin Miodrag, por shkurt e thërrisnin Drago. E kishin sjellë me shërbim në qytetin tonë, ku porti po thellohej dhe sistemohej.

Kur mjeshtri u kthye dhe u unë i tregova se zotëria ishte një shok jugosllav dhe kërkonte të qepte një kostum, ai u zverdh. Pandehu se kishte të bënte me ndonjë njeri të shërbimeve sekrete.

– *Patjetër, – tha plotësisht i gatshëm.*

Dragoja vështroi nga unë ngadhnyes dhe buzëqeshi. Edhe unë u detyrova t'i buzëqeshja. Ishte një njeri pas të cilit femrat mund të tërhiqeshin në mënyrë fatale. E ndjeva atë gjë që në takimin e parë. Pasi mjeshtri i mori masat dhe tashmë i duhej të largohej, që nga

mënyra se si ma shtrëngoi dorën unë e kuptova se do të më bëhej rodhe.

Dhe ashtu ndodhi. Vinte çdo dy ditë për të bërë provën e kostumit. Një mbrëmje më priti para rrobaqepsisë dhe më ftoi të pinim diçka. U detyrova t'i tregoja me pak fjalë historinë time. Ai uli kokën.

– *Simonë, unë di gjithçka për ty, – tha. – Jemi të dy të huaj këtu dhe... mendova se...*

– Por unë jam e martuar! – ia preva duke u larguar.

Megjithatë, ai nuk m'u nda. Një mbrëmje tjetër me shi m'u lut të ngjitesha në makinën e tij. Ishte rrebesh dhe dukej se do të zgjaste. Isha tmerrësisht e lodhur dhe e mërëzitur. Më pëlqeu të shfajësohesha me detajin e shiut. U ngjita. Por nuk doja të kthe-hesha në shtëpi. Ai e ndjeu këtë dhe më ftoi të shkonim në kinema.

– *Është një film i mrekullueshëm amerikan me Fred Aster dhe Xhinxhi Roxhers, – tha për të më bindur. – “Marrëzi dimri”.*

Atë film unë e kisha parë dy herë, megjithatë pranova, duke e ndier se mund të ndodhte ndonjë marrëzi. Por kur mbërritëm te kinemaja, nën një strehë llamarine pamë një copë kartoni ku qe pikturuar një ushtar sovjetik me mitraloz. Poshtë tij qe shkruar me gërma të mëdha: “Ne nga Kronshtadi – asnjë qytetar të mos mbetet pa e parë këtë film të madh sovjetik”. Dragoja filloi të shante dhe më kërkoi falje.

– *I duron dot filmat sovjetikë me luftë? – pyeti i pasigurt.*

Unë qesha.

– Më mirë shkojmë diku tjetër, – thashë.

Ai më la të zgjidhja. Por mundësitë ishin fare të pakta. U ndalëm në një piano-bar për të pirë diçka. Lokali ishte ndriçuar zbehtë, megjithatë unë e dija se do të më njihnin. Paç lufte, kur njerëzit përpiqeshin të gëzonin



në një farë mënyre, kisha luajtur në piano aty. Çdo fundjavë në atë vend organizoheshin festa. Kërcehej. Pianoja vazhdonte të qëndronte në një cep të lokalit. E vështrova në bisht të syrit. M'u duk si ata kuajt e bronxtë të monumenteve të vjetër që nuk lëvizin kurrë. Nuk doja që njeriu pranë meje ta merrte vesh lidhjen time me atë instrument. Por ai e kishte mësuar edhe atë detaj.

– *Simonë, të lutem, luaj diçka, – tha.*

– Nuk mundem, – iu përgjigja. – Do të bëja gabimin e dytë pas ardhjes me ty këtu. I njoh mirë zakonet e këtij vendi.

Dragoja uli kokën.

– *Ç'ke ndër mend të bësh me këtë vend? – pyeti papritur.*

– Do të qëndroj.

– *Mendova se do të doje të largoheshe.*

– Nuk e besoj të ndodhë.

Vështronim të dy shiun që përplasej më furi në qelqet e lokalit duke shformuar lehtazi pamjet përtej tyre si nëpër pikturat e impresionistëve. Para se të largoheshim, ai më tregoi se ishte ndarë nga gruaja dhe se do të kthehej në vendin e tij sapo të mbaronin disa punë të rëndësishme në port.

E pata të qartë atë që do të ndodhte: Ai zgjodhi një ditë tjetër po me shi për të më kërkuar që të më merrte me vete kur të largohesh. Kundërshtova prerë.

– *Edhe mund të mendohesh, – këmbënguli ai. – Një jetë është kjo.*

Gruaja e moshuar psherëtiu.

– Dhe ndodhi lëkundja? – pyeti vajza.

– Po. Ndodhi në mënyrë tinzare. Njeriu është pjellë egoiste. Mendova gjithçka që më priste përpara: katin nën dhë ku jetonim, urinë, rrobaqepsinë, burgun, baltërat, vajzën që do të rritej me damkën e një reaksionareje

të vogël, vendin tim që nuk do ta shikoja më kurrë. Që nga mbarimi i luftës dhe ringritja e rrjetit të postave kisha shkëmbyer me nënën vetëm dy letra. Tashmë kisha frikë t'i shkruaja.

Kur hyra në shtëpi, ime vjehrrë më vështroi në një mënyrë që më rrëqethi. E kishte nuhatur ç'po ndodhte. Ishte grua e zgjuar.

*– Nesër unë do të shkoj tek im bir, – tha duke përplasur dorën mbi tryezë.*

Ia ktheva me të njëtin veprim.

– Edhe unë do të shkoj tek im shoq!

*– Po ta kishe pasur këtë mendje, nuk do të ishe vonuar kaq gjatë! – vazhdoi ajo.*

– Më duket se unë punoj! Apo jo?

Ajo më ktheu kurrizin. Ka qenë një nga rastet e rralla që i kemi ngritur tonet me njëra-tjetrën. U mata të gatuaja diçka, por në raftin e ushqimeve kishte vetëm qepë.

*– Mund të blejmë diçka jashtë, – tha ime vjehrrë.*

Po qëndronim të dyja me kurriz nga njëra-tjetra, kur në derë u dëgjua një trokitje e ndrojtur. E hapa. Ishte babai i Sadetes, fqinji ynë. Në dorë mbante një bohçe të vogël lecke. Ma zgjati atë duke thënë:

– Zonjë, këto janë për avokatin. Nuk kishim mundësi më tepër. Zoti e bëftë kollaj që të kthehet gjallë!

E falënderova e prekur. Brenda në bohçe ishin vënë disa copa byreku me fasule dhe një ëmbëlsirë. Nën to dy palë çorape leshi. Ime vjehrrë, që nuk kishte nxjerrë lotë kur e kishte parë të birin e vetëm t'i ngjante një kufome, filloi të qante papritur. Erdhi dita që të na japin, mërmëriste nëpër shtëpi e përhumbur. Mbase Zoti do të na i shpërblejë mirësitë që kemi bërë.

Të nesërmen u nisëm të dyja. Vazhdonim të mos i flisnim njëra-tjetrës. Vetëm kur po i afrohemishim kampit,

ajo më tha me një zë të akullt:

– *Simonë, nëse guxon dhe e braktis tim bir në këto ditë halli të zi, Zoti do të të përzërë me gurë tërë jetën!*

E vështrova qetësisht.

– Dëgjo, unë nuk kam ndër mend ta braktis tët bir, ndonëse ai më është lutur ta bëj këtë gjë, – iu përgjigja.

– Nuk e bëj, sepse e dua. Sa për Zotin tënd, atij nuk i trembem fare.

– *Këtë të fundit e dija, – tha ajo. – Zoti nuk është i imi. Ai na sheh të gjithëve nga lart. Të jesh e bindur për këtë. Dhe një ditë na jep shpëtimin e merituar.*

Gjyshi i Antuanit e lexoi lehtësisht lëkundjen që kisha kaluar.

– *Simonë, se si më vështron kështu, – më tha kur mbetëm vetëm. – Ka ndryshuar gjë?*

Nuk i mbajta dot lotët.

– Asgjë nuk do të ndryshojë, – iu përgjigja.

Pas pak ditësh Dragoja kaloi si rastësisht nga rrobaqepsia. Me kostumin kishte mbaruar punë. U fut dhe përshëndeti. Mjeshtri e priti miqësisht dhe e pyeti mos kishte ndonjë gjë tjetër për të qepur.

– *Mbase ndonjë këmishë, – tha ai.*

E pa se kisha ndër mend t'i ktheja një përgjigje dhe më ftoi te piano-bari.

– *Më mirë mos fol, – ia bëri duke u lëshuar i tëri. – E kam të qartë ç'do të më thuash.*

– Nuk do ta braktis kurrë tim shoq, – thashë. – Do të të lutesha të më qëndroje larg. Ky qytet nuk është as Brukseli e as Zagrebi. Drago, të respektoj shumë. Të jesh i bindur për këtë.

– *Edhe unë të respektoj. Një vendim është një vendim. Veç... ndihem shumë i vetmuar. Kam frikë se kisha filluar të dashurohesha me ty. Nuk duhej të ndodhte. Por... ky qytet*

Natën vonë spitali binte në qetësi dhe ne patëm rast të mbeteshim disa herë vetëm në dhomë.

Gruaja e moshuar qëshi.

– E shkelëm edhe rregulloren e spitalit. Malli i një burri të burgosur për gruan e tij është i jashtëzakonshëm. Ai nuk ngopet duke thithur me flegra të shqyera aromën e trupit të saj, si një kalë në livadh që ngre hundën drejt qiellit dhe hingëllin. Duket sikur gjithçka nis nga fillimi. Është e dhimbshme, vogëlushe, shumë e dhimbshme. Ndërsa gruaja dhuron më të mirën e saj, duke e ditur se ai akt dashurie është si uji i pirë në shkretëtirë, që vetëm e ndez etjen më keq. E provova këtë kur im shoq u largua drejt kampit.

– Po me Dragon, ç'u bë? – pyeti vajza.

– Pas pak muajsh ai u largua. Ndodhi prishja me Jugosllavinë. Erdhi te rrobaqepsia të më jepte dorën.

– *Ndoshta rastis që ndonjëherë të takohemi përsëri, – tha. – Kushedi ku.*

– Ndoshta, – ia ktheva.

Por kjo gjë nuk ndodhi kurrë.

## VIII

– Ndryshoi gjë prishja me jugosllavët? – pyeti vajza.

– Fare pak gjëra. Pati vetëm një ndëshkim të ashpër për njeriun që i patëm shpëtuar jetën, ndëshkim që na ngushëlloi disi. Atë e masakruan shokët e vet. Përfundoi në burg për krimet që kishte bërë me urdhër të atyre që po e dënonin. Ky është ligji i madh i botës së krimeve. Sadetja e ndau për të shpëtuar veten dhe fëmijët e saj nga damkosja. Atë e dëbuan nga vila ku jetonte. Përfundoi në një dhomë të pistë diku në të dalë të qytetit, andej nga fillonin shkurret e pellgjet dhe verës bënin dasmë bretkosat. Në atë kohë ajo u pajtua përsëri me prindërit. E ndeshja kohë pas kohe në rrugë. Më vështronte me sy të pikëlluar, por nuk ndalej.

Një ditë i fola. Ajo mbajti hapat. Iu afrova. U skuq e tëra dhe uli kokën.

*– Zonjë, na zuri mallkimi yt, – më tha. – Atje lart paska Zot, por ne na gënjyen. Na thanë se nuk ka. Na mësuan se Zoti i vërtetë ishte tjetërkund. Shkelte mbi tokë. Tani... më përçmo, zonjë! Nuk meritoj asgjë më shumë.*

Nuk më la kohë t'i përgjigjesha. U largua.

– Po ndihma që i dha ai tekniku i kampi gjyshit të Antuanit, a ndikoi për keq pas prishjes me jugosllavët?

– Për fat, jo. Ushtarakët që drejtonin kampin u ndërruan. Më vonë të dënuarit lëvizën nëpër kampe të tjera, edhe më larg. Rrugëtimi nëpër baltëra u shtua. Era moçalore e tyre më mbeti në këpucë e rroba e pandarë.

Të më pyesësh sot se sa zgjati ai rru-gëtim, do të thoja se në botë ka pasur edhe një Epokë të Baltërave. Deri sa një ditë tim shoq e çuan në një burg ku merrrej me përkthime në kushte shumë më njerëzore.

Për herë të parë që nga burgosja më lejuan të kaloja një natë me të, në një dhomë të zhveshur që quhej me demek "dhoma e takimeve speciale". Bëmë dashuri të përgjuar nga një polic, që ishte ngjeshur pas derës dhe na shikonte me sy lakmitarë nga një dritarezë, e cila nuk duhej zënë nga ne që ndodheshim brenda. Tim shoq e nervozoi prania e atij idioti, por unë e binda që të mos e vriste mendjen. Fundja ndodheshim në burg.

Në vitin 1954 u dha një falje e madhe dhe Vegimi u kthye në shtëpi. Vendosëm të bënim një festë, por rafti i ushqimeve tundej i tëri po ta prekje me një gisht. Ime bijë kishte kaluar një sëmundje dhe kishim mbetur trokë fare. Atëherë, ime vjehrrë nxori që thellë nga një baule e madhe një pallto të vjetër dhe më ftoi të afrohesha. Shqepi në një vend astarin e trashë të palltos, futi dorën brenda tij dhe nxori një monedhë floriri të mbledhur me një copë gazete.

*– Ky astar do të shqepet vetëm në ditë të hallit të madh, – më tha. – Brenda në pallto janë 50 monedha të këtilla. Më premtova që, kur unë të mos jem gjallë, pesë monedhat e fundit nuk do t'i prekësh.*

I premtova. Pastaj e pyeta se përse duheshin ruajtur ato të pesta.

*– Do të ta mësojë jeta, – m'u përgjigj ajo.*

E shtrëngova monedhën në grusht dhe dola ta këmbëja në tregun e zi te një tip që merrej me ndonjë kontrabandë të vogël. Bleva mish, verë, një tortë dhe disa ushqime të tjera. Gatova gjërat që gjyshit të Antuanit i pëlqenin më shumë, mes të tjerave edhe

kërmij, gatim që vjehrrën time e tmerronte. Megjithatë, ajo pranoi të vinte me mua nga kodrinat mbi qytet për të mbledhur kërmij. Na u përvëluan duart nëpër hithra e na u gërricën nëpër ferra për t'i gjetur ata. Megjithatë, unë nuk ndjeja asgjë. Isha si e dehur. Më drithëronte mendimi se do të bëja dashuri me tim shoq.

Ndërkohë kisha qepur një fustan të ri, kisha rregulluar flokët dhe kisha përgatitur pjesët që do të luaja në piano. Kati i nëndheshëm i shtëpisë sonë na u duk një mbretëri e tërë atë mbrëmje. Kishim fituar mbi perëndorinë e baltërave dhe telave me gjemba. Ishim përsëri bashkë. Ime bijë recitoi një vjershë frëngjisht për babin e saj. Ishte rritur. Shtrënguar për duarsh, ne të tjerët qanim si fëmijë bashkë me të. Ishim të lumtur. Vogëlushe, lumturia ka një çmim. Nuk është dhuratë. Ne e kishim paguar atë çmim.

Pastaj, kur festa mbaroi dhe time bijë e zuri gjumi në krahët e gjyshes, ndodhi si atë natën e llahtarshme të Gestapos. Bëmë dashuri deri afër mëngjesit. Por ajo nuk ishte dashuri e zakonshme. Mbase e kapërceu natën e Gestapos. Ishte përtej dashurisë. Nuk bëhej fjalë për kënaqësi. Ishte më shumë mall dhe dhimbje. Klithma dhe rënkime që vinin kushedi sa thellë qenieve tona, që kishin qenë brenda nesh dhe ne nuk e kishim ditur. Lëngje pranverorë që vërshonin pas ndrydhjes torturuese të dimrit të gjatë që kishte vazhduar me vite. Humbje e mendjes. Një si pragvdekje e ëmbël. Kurrë më në jetën tonë nuk u përsërit ajo natë.

Ti nuk mundesh ta kuptosh, vogëlushe. Janë të pakta ato femra që do ta kuptonin. Vetëm ato që kanë pritur për vite të tëra kthimin e burrave të tyre nga lufta apo nga burgu, duke u shndërruar në murgesha të rrepta, pa guxuar t'i ngrenë sytë drejt burrave të tjerë, pa tradh-

tuar as me mendje, pa tentuar të prekin veten për të arritur pak kënaqësi, vetëm ato që kanë punuar si kalë lëmi për të dërmuar trupin e tyre, që ai trup, nga lodhja, të mos kishte nevojë për dashuri. Ashtu u shndërrova edhe unë, në një mushkë pune, që, natën vonë, pasi kisha qepur në rrobaqepsi dhe në shtëpi deri sa koka më përplasej pas makinës nga përgjumja, kërkoja vetëm dy kafshata bukë dhe gjumë. Dhe trupi nuk më torturohej nga valët përvëluese të epshit, por nga malli dhe pritja. Vetëm ashtu 7 vjet kthehen në shtatë muaj, shtatë muaj në shtatë javë dhe shtatë muaj në shtatë ditë.

Por, kur i kujtoj sot ato që ndodhën, them se nuk duhet të ketë qenë vetëm fati, inxhinier Dragoja apo doktor Selita që e kthyen tim shoq gjallë në shtëpi. Ishte edhe dikush tjetër që qëndronte mbi ne. Në trurin tim të infektuar që në fëmijëri nga komunizmi ndodhi befaz një përmbysje. Nga ato që ndodhin vetëm një herë në jetë dhe i detyrojnë njerëzit t'i kthehen një besimi të ri. Nëna ime nuk ishte ndonjë besimtare fort e thekur, megjithatë, deri nga mosha 10-vjeçare arriti të më çonte në kishë. Rrallë vërtet, por e kisha shkelur atë vend.

Një natë, pas kthimit nga baltërat e kampit, ku e kisha lënë tim shoq sëmurë dhe në sy i kisha lexuar mendimin e vetvrasjes, mendim që burrat i mbërthen shumë më lehtë se gratë, pra, atë natë dëshpërimi, ime vjehrrë, që ishte gjunjëzuar para ikonës së saj, më ngjethi duke thënë:

– *Simonë, ëshhtë edhe dikush tjetër që ti nuk i je lutur ende për ndihmë.*

– Kush? – pyeta me padurim.

– *Zoti, – m'u përgjigj ajo.*

– Zonja mama, pse ty që je lutur që fëmijë, Zoti nuk ta shpëtoi tët shoq? – iu ktheva me ankim.



Ajo i duroi qetësisht ato fjalë të pamenduara.

– *Im shoq ishte njeri i mirë, – tha. – Iku pranë Zotit që të na shpëtonte ne të tjerëve. Dhe dije se do të na shpëtojë deri në fund.*

Pas atyre fjalëve ajo filloi të qante. I kërkova falje. Të nesërmen shkova në kishën katolike të qytetit. Prifti u befasua kur më pa. Më pyeti në isha besimtare.

– Jo, – iu përgjigja. – Por kam ardhur t'i lutem Zotit për tim shoq.

– *A nuk je vonë? – më pyeti ai me qërtim.*

– Më mirë vonë se kurrë, – ia ktheva.

Ai më çoi para sankristisë ku u gjunjëzova dhe fillova të lutesha duke qarë. Sot, kur e kujtoj atë ditë, jam e bindur që Zoti më dëgjoj. Të pasnesërmen, gruaja e një të dënuari, me të cilën e bëja shpesh maratonën e baltës, erdhi në shtëpi dhe më njoftoi se im shoq ishte më mirë.

Para se të largohesha, prifti më la në duar një Bibël në frëngjisht. Më këshilloi të gjeja kohë për të. E mora. Fillova të lexoja nga dy faqe çdo natë, shtrirë, duke kafshuar gishtat që të mos më zinte gjumi nga stërlodhja. Ajo Bibël e vjetër, me kapakë të rrjepur, faqe të zverdhura, që kishte filluar të merrte erë myku e igrasie, filloi të bënte pluhur e hi me dhjetra libra marksizmi. Fragmente të tëra i mësova përmendësh. I përsërisja rrugës, gjatë ecejakeve nëpër baltëra, në punë, në shtëpi.

Fillova të shkoja në kishë rregullisht. E binda edhe Sarën të vinte. Ajo kishte rënë në një familje tërësisht myslimane, por në atë qytet ishe njëlloj i respektuar edhe sikur të shkoje një javë në kishë e një javë në xhami, apo të mbaje fenë primitive të ndonjë fisi indigjenësh andej nga Afrika. Ndodhnin gjëra të çuditshme. Kishte raste që, sipas një zakoni të vjetër, ime vjehrrë bënte byrekë dyfetarësh. Gjysma e tyre ishte me mish

derri e gjysma me mish viçi apo dashi. Unë dhe ajo hanim gjysmën e krishterë, kurse i shoqi i saj dhe Vegimi gjysmën myslimane.

Dhe papritur, një ditë, ndërsa kisha mësuar përmendësh pjesë të tëra nga Bibla, e kuptova se ëndrra e madhe e komunizmit nuk ishte gjë tjetër veçse një kopje e zbehtë e krishtërimit të parë, e mësimeve të Jezuit. M'u kujtuan fjalët e sime motre se komunizmi ishte një fe pa Jezu Krisht. Të tjerë ishin përpjekur ta dëbonin atë me dhunë, t'i zinin vendin në shoqërinë njerëzore dhe gati ia kishin dalë. Por Jezui u kthye edhe më fitimtar. Shumëkush e kërkoi. Vogëlushe, ai është me ne, të jesh e sigurt për këtë. Do të na japë dorën dhe do t'i prijë rrugës sonë. Sepse kemi vuajtur për të. Ti duhet t'i besosh atij. Ma jep dorën. Fute te ky xhepi i madh i palltos.

– Është Bibla?!

– Po.

– Do të doja të ta dhuroja.

– Nona, do të jetë një dhuratë e shtrenjtë për mua.

– Më premtan që do ta lexosh?

– Të premtoj!

Gruaja e moshuar rënkoj e lehtësuar dhe me një buzëqeshje të ngrirë në buzë u përhumbe në kohë të largëta.

\*

\*

\*

– Nona, do të vazhdojmë? – e përmendi vajza.

– Po, vogëlushe.

– Po më tej, si rrodhi jeta juaj?

– Erdhi një periudhë qetësie. Gjyshi i Antuanit filloi

punë si llogaritar në një ndërmarrje mekanike, ndonëse nuk e lidhte asgjë me ekonominë. Unë vazhdoja të qepja dhe të jepja leksione pianoje për ndonjë djalë apo vajzë që donte të ndiqte shkollën e muzikës. Kur më jepej rasti, jepja edhe leksione frëngjishteje. Na mjaftonte pak lumturi. Një shëtitje në breg të detit në mbrëmje ishte e barabartë me një rrotullim rreth botës me anije. Një e diel e kaluar në plazh bashkë me vajzën tonë na zëvendësonte javë të tëra vuajtjesh e mundimesh. Thjesht donim të na linin të jetonim në hallet tona. Asgjë më shumë. Në mëngjes, i buzëqeshnim rrezes së parë të diellit që hynte nga dritarja e vogël e dhomës sonë gjysmë të nëndheshme. Kishim kaluar një natë të qetë. Asnjë makinë nuk ishte ndalur te porta.

Por, për të na kujtuar se ishim pandërprerë nën çizmen e pushtetit popullor, na kishin bërë dhuratë mbi krye Pelivan Memo Pelivanin.

– Ç'ishte ky?

Gruaja e moshuar qeshi.

– Një tip Tartarini Taraskone. Komandant topash. Eh, çudi! E di që më ka marrë malli për të? Sa na nxinte jetën, aq edhe na bënte për të qeshur. E kishin prurë në katin e parë të vilës nga fillimi i viteve '50, pasi ishin larguar dy familje ushtarakësh të tjerë. Pelivani ishte një ushtarak nga ata të luftës që nuk dinte të lexonte as gazetën. Komandonte ca topa të ndryshkur andej lart nga kodrinat e qytetit. I kisha parë ata kur shkoja për të mbledhur kërmij. Më i madhi prej tyre kishte një grykë të gjatë dhe lëshonte ca predha të mëdha, që, sipas fjalëve të Pelivanit, mund ta bënë edhe Italinë përshesh. Rreth atyre topave vërtitej e gjithë bota e fqinjit tonë, ndërsa ne nuk e kuptonim se si mund t'i besoheshin atij njeriu armë artillerie. Por e

shoqja mburrej se Pelivani kishte bërë një kurs artilerie në Bashkimin Sovjetik dhe kishte pasur rast t'i shtrëngonte dorën Stalinit vetë. Të gjorës i ishte mbushur mendja se nga ata tre topa varej fati i luftës së ardhshme botërore.

Pelivani mburrej se kishte bërë heroizma të papara në luftë dhe kishte vrarë me dorën e tij 12 italianë dhe 7 gjermanë. Madje një gjermani të vrarë i kishte marrë edhe orën. Borgjezët dhe bejlerët i urrente për vdekje. E dëgjonim shpesh të kërcënonte se do të na i shtypte kokat. Si për të na e kujtuar për ditë atë kërcënim, ai mbathte me të gdhirë një palë çizme me pafta metalike dhe bënte ecejake nëpër shtëpi. Pelivan, na e bëre kokën dauille me ato çizme me gozhdë potkojsh, i ankohej e shoqja, një fshatare dede. Hajde moj, dhi mali, të m'i lustrësh, ia kthente ai. Kam një takim pune me rëndësi sot. Vijnë ca sovjetikë nga bateria e topave. Pas lustrosjes ai vazhdonte edhe ca çapitjet deri sa e shoqja i bënte gati kafënë. Pas atij zgjimi ushtarak ne nuk na zinte më gjumi. Detyroheshim të ngriheshim.

Më e bukura ishte kur topçiu ankohej se ne i bënim zhurmë! Ju more, borgjezët e m..., mos i tërhiqni këmbët zvarrë kur ecni se më acaroni nervat, thërriste. Mos flisni me zë të lartë. Sakën se shani pushtetin popullor, se ju zura me hu! Unë nuk luaja kurrë në piano kur komandanti i topave ndodhej në shtëpi. Edhe radion e ulnim deri në zë të mizës. Por një mbrëmje po festonim ditë-lindjen e sime bije dhe ai i dëgjoji tingujt e pianos. Goditi dyshemenë me shkop.

*– Ç'është ajo drange-drunge atje poshtë? – thirri. – Nuk dua zhurma unë se kam qenë tërë ditën në mbledhje me shokët sovjetikë.*

U detyrova të ulja kapakun e tastierës.

Në çdo mbledhje të këshillit populor që bëhej në lagje Pelivani bënte thirrje për forcim të luftës së klasave dhe kërkonte që ne borgjezëve të na internonin. Sa ishte komandant i topave nuk e provoi dot atë kënaqësi, por arriti të na linte pa energji elektrike. Armiqtë nuk e meritojnë dritën që prodhon populli, ky qe argumenti i tij. Na i prenë telat e energjisë dhe na lanë në errësi. Filluam të përdornim përsëri, si pas lufte, qiri dhe kandilë me vajguri që lëshonin një tym mbytës.

Por ligësia dhe urrejtja njerëzore jo gjithmonë kultivohen nëpër shpirtëra. Ato lindin bashkë me njeriun. Nuk kanë të bëjnë me luftën e klasave dhe biografitë. Lufta e klasave dhe biografitë vetëm përgatisnin terrenin që fëlliqësitë njerëzore dhe komplekset më të ulëta të shpërthenin me një egërsi të pashembullt. Rrotull nesh jetonin edhe fqinj me zemër të madhe. Një ditë vere, njëri prej tyre, ndërsa komandanti i topave kishte shkuar në fshatin e lindjes me pushime, na dha energji elektrike nga shtëpia e tij. Sajuam një lidhje të fshehtë që kalonte nën tokë. Bëhej fjalë sa për të mbajtur ndezur dy llampa. Radioja u harrua.

Ajo lidhje e fshehtë na dha dritë për dy vjet, deri sa, një natë, për shkak të pakujdesisë së sime bije, Palivani na zbuloi. Lajmëroi policinë, ushtrinë, përfaqësuesit e këshillit të lagjes. Kuptohet, me ne u morën këta të fundit. Energjia që ne harxhonim paguhej, nuk kishte vjedhje. Por fqinjin tonë e akuzuan se ndihmonte armiqtë dhe nuk mbante të ndezur luftën e klasave. Mbledhjet u bënë telenovelë. Pritej që atë ta dënonin.

Atëherë u detyrova të trokisja për ndihmë në derën e njërit prej shokëve të grupit komunist të qytetit ku dikur kisha bërë pjesë. Tashmë ai ishte bërë drejtues i rëndësishëm partie. Ndër të paktët që kishte ecur përpara në

karrierë. Dy nga grupi ynë ishin pushkatuar për qëndrime antiparti, tre të tjerë kishin përfunduar nëpër burgje, një tjetër e kishin përjashtuar nga partia. Ky ishte shpërblimi për idealizmin dhe ëndrrat e mëdha.

Orest Bregu, shoku i dikurshëm, më priti njerëzisht. Kur mësoi për punën e energjisë elektrike, e quajti dënimin tonë me errësirë sektarizëm dhe ajo histori u mbyll. Energjia na u kthye. Edhe fqinji ynë shpëtoi nga ndëshkimi. Ndërsa qëndroja përballë tij, në një zyrë të mbushur me vepra të marksizmit, shoku i vjetër më pyeti:

– *Simonë, ç'mendon tani për komunizmin tonë?*

Nuk m'u duk se po më provokonte. Ishte njeri i sinqertë, idealist.

– Duhet plotësuar ëndrrat e njerëzve, – iu përgjigja.

– *Më duket se ne po e bëjmë këtë gjë, – ma ktheu ai.*

– Eh, po e bëni vetëm me gjysmën e popullit. Pjesën tjetër nuk po e lini as të shohë ëndrra.

Ai u vrenjt. *Nuk i pëlqeu përgjigja.*

– *Nuk mund të jenë të gjithë të lumtur, – tha. – Ne nuk jemi një shoqëri kristiane. Por do të mbërrijmë në komunizëm shumë shpejt. Atëherë, edhe armiq nuk do të ketë më. Ata do të jenë riedukuar. Askush nuk do të ketë arsye ta kundërshtojë rendin tonë të lumturisë së përgjithshme.*

Ia ngula sytë e shtangur. Ai i besonte vërtet ato fjalë. Besonte te Bibla e tij e kuqe, ashtu siç kisha filluar unë të besoja te Bibla e dhuruar nga prifti i kishës katolike. Ndërsa po ngrihesha, më shkuan sytë te fotografia e një vajze mbi tryezën e tij. Ishte e bija. I kërkova t'i mësoja asaj frëngjishten. Ai më falënderoi.

– *Rusishtja është më e bukur, – tha.*

Ja, kështu, vogëlushe.

– Po komandanti i topave, ç'bëri më tej?

– Kur dëgjoji muzikë nga radioja jonë, ai u tërbua

dhe filloi t'i binte dyshemesë me takën e çizmeve. Filloi të shkruante letra kundër nesh. Por një mëngjes, për habinë tonë, nuk i dëgjuam çizmet të kërcisnin nëpër dërrasa. E kishin liruar nga ushtria atë dhe shumë oficerë të tjerë që vinin nga shkolla e dhive. Ndërsa po përcillja tim shoq për në punë, dëgjova Pelivanin që ankohej në verandë:

– *Të poshtrit! I harruan plagët e mia. E harruan trimërinë time që hidhesha në sulm i pari. M'i morën topat zuzarët, më lanë rrugëve.*

E shoqja e këshilloi të qepte gojën e të mos fliste shumë se mund ta plasnin brenda. Ai ia vërviti filxhanin e kafesë fytyrës. Atëherë ajo iu kthye me një mllef të vjetër, që me siguri buronte nga bezdia që i shkaktonte lustrimi i çizmeve të komandantit dhe shkëlqimi i spaletave të tij:

– *Mirë ta bënë, se aq tru kishe. Kthehu në fshat tani, te dhitë.*

Ai iu vërsul dhe e rrahu aq egërsisht, sa i theu dy brinjë. Eh, i ranë pendët Pelivan ziut! Na dukej qesharak me rroba civile. Ishim mësuar ta shikonim tërë kohën me uniformë. Edhe kur shkonte në fshat me pushime, nuk e hiqte uniformën. Madje edhe te dera e bukur e vilës sonë kishte vënë një pllakë metalike ku shkruhej: "Familja kapiten Pelivan Memo Pelivani".

– Ç'u bë me atë pllakë?

– Mbeti aty deri vonë, ndonëse komandanti përfundoi punëtor në portin detar.

– A kërkoi më që t'ju internonin?

– Eh, urrejtja për ne nuk iu zbut. Tashmë bënte zhurmë mbi kokat tona me nallane. Nallanet ishin më të poshtra se çizmet. Ta jepnin në çaçkë të kokës. Sime vjehrrë iu shpif migrena nga ato nallane. Të paktën



kështu thoshte ajo kur ankohej. Pelivani nuk linte mbledhje partie apo të këshillit popullor pa kërkuar që ne të internoheshim. Ai dhe të tjerë. Deri sa një ditë, duhet të ketë qenë dimër i vitit 1964, na urdhëruan të bënim plaçkat gati. Do të na internonin në një fshat të humbur. Sapo dëgjoi emrin e tij, tim i shoqi i shpërthyen të vjella. Do të jetonim diku pranë njërit prej kampeve ku ai kishte kryer dënimin.

U detyrova përsëri të trokisja në zyrën e shokut të vjetër të grupit komunist, që punonte në Komitetin e Partisë.

*– Më vjen keq, Simonë, – tha Oresti. – Këtë dënim nuk e kthej dot. Është vullneti i popullit.*

*– Cilit popull? – pyeta unë e nxehur. – Popullit të gjysmës së lumtur? Ju nuk mund të internoni një ish-komuniste që ndihmoi luftën.*

*– Ti nuk ke qenë komuniste, – qe përgjigjja e tij.*

*– Nëse ju të grupit më keni gënjyer, kam qenë në vendin tim.*

*– Desha të them nuk ke qenë komuniste e vërtetë, por një oportuniste.*

*– E pse?*

*– Sepse, përndryshe, nuk do të kishe bashkëjetuar kaq gjatë me një borgjez. Pse nuk e ndave kur ai hyri në burg? Pse nuk e ndan tani? Ndaje tani dhe unë do të bëj çmos që ti dhe jot bijë të qëndroni këtu. Do t'ju japim edhe shtëpi. Vajza mund të shkojë në universitet.*

*– Nuk e di se nga më doli një “Kurrë” e llahtarshme, sepse edhe qelqet e dritareve u drodhën.*

*– Atëherë, shko në internim, – ma preu Oresti. – Mbase andej ndërron mendje.*

Dola nga zyra duke përplasur derën. Atë ditë shkrova tri letra drejtuar qeverisë së vendit tim, një tjetër ambasada-



dës franceze dhe një të tretë OKB-së. Isha e vendosur t'i postoja për të protestuar për padrejtësitë që po na bëheshin. Por gjyshi i Antuanit m'i grisi ato para syve pa ngurimin më të vogël.

– *Simonë, këtu ka edhe një burg që quhet Burgu i Grave, – më tha.*

– Po unë jam qytetare e huaj! – thirra.

– *Aq më keq për ty. Të lutem, bëj plaçkat gati!*

M'u kujtuan fjalët e sime vjehrrë se fatit i duhet nënshtruar deri në fund dhe u binda.

## IX

Kështu rifilloi maratona e baltës. Ngarkuam në një kamion të gjitha plaçkat që kishim. Kur i erdhi radha pianos, fillova të qaja pështetur mbi tastierën e saj. Isha e bindur se nuk do ta shikoja më. Por, papritur, më shkrepri një ide shpëtimtare. E mbulova me një çarçaf të madh dhe u thashë policëve se ishte makinë qepëse. Vrit veten me gjithë të, ma ktheu njëri prej tyre. Vegimi më shikonte sikur të kishte para një të lajthitur.

– *Simonë, nuk mund të luash më, harroje, – më tha.*

– Nuk bëhet fjalë për të luajtur, por për ta shpëtuar, –  
iu përgjigja.

Ai nuk kundërshtoi më.

Ikëm nëpër shi. Na dëbuan. Ime bijë nuk arriti ta mbaronte maturën. E mori çantën e shkollës me vete, por ajo nuk i hyri më në punë për vite me radhë. Mbeti pa dëftesë pjekurie.

Kamioni na la me gjithë plaçka në rrugë, rreth tri kilometra larg vendit ku do të jetonim. Nuk shkonte dot më tej për shkak të baltës. U detyruam të kërkonim një qerre. Por kur i erdhi radha pianos, qerrexhiu nuk pranoi të merrej me të. Kishte hall se mos ajo bina, që në të vërtetë nuk e bindi aspak se shërbente për të qepur, i merrte qetë me vete në rrëpirë. Ia prisha mendjen duke e paguar dyfish.

Më në fund mbërritëm në një luginëz të ngushtë mes kodrave, ku ndodheshin dy ndërtesa të ulëta, që dikur

duhej të kishin shërbyer si depo. Ato i kishin ndarë në dhoma dhe neve na dhanë njërën prej tyre. Nuk ishte më shumë se 3 metra me 4. Aty do të jetonim të gjithë. Gjysma e plaçkave mbeti jashtë. Të parën futëm pianon dhe asnjëri nuk kundërshtoi. Pastaj gjërat më të domosdoshme. Unë dhe ime bijë vazhdonim të qanim në krahët e njëra-tjetrës. Kullonim ujë, ndërkohë që jashtë shiu vazhdonte të binte me një ritëm të shtruar e acarues. Im shoq e kishte humbur fare. Vetëm fliste me vete. Vetëm ime vjehrrë qëndronte në këmbë si një e mbijetuar në kohëra epidemie, kur sheshet dhe rrugët mbusheshin me kufoma dhe mendonte si mund të sistemonte sa më shumë plaçka brenda asaj kthine.

Nëse më ka shkuar ndonjëherë mendja për t'i hequr vetes një plumb kokës, ka qenë pikërisht ajo ditë. M'u duk se nuk do të bëheshim më njerëz. Por një grua e veshur në stilin e viteve '30, me një kapelë strehëgjere që binte ndesh me gjithçka rreth e rrotull dhe një pipë të gjatë në dorën e djathtë hyri brenda dhe na përmendi. Ishte Dalila, e shoqja e një fabrikanti të pushkatuar pas luftës, e cila dikur mbahej në qytet si një nga femrat më të bukura dhe thashethemet e ngritura për të kapnin një roman të tërë të tipit Bövारी. Që nga mënyra se si e tymoste pipën, m'u duk e shkarë. Na pyeti a kishim sobë, sepse shiu, sipas saj, do të zgjaste për ditë me radhë. Ne u kujtuam të fusnim sobën brenda dhe të nxirrnim jashtë një komo. Fqinja na solli dru të thata dhe ca prush. U ndërruam dhe pastaj u mblodhëm duke u dri-dhur rreth zjarrit.

*– Ka edhe më keq, – na tha Dalila kur na pa se ishim katandisur të vajtur për këtë botë. – Zonja Lefteri, bën mirë t'i lutesh Zotit dhe të gatuash ndonjë supë.*

Ime vjehrrë tundi kokën për t'i treguar se e kishte

menduar atë gjë dhe u ngrit të nxirrte ikonën e saj nga një baule. Mua m'u kujtua Bibla, por në ato çaste nuk e kuptoja pse duhej të përfundoja ashtu pas gjunjëzimesh pa fund para sankristisë së kishës.

– *Simonë, Zoti na kërkon të vuajmë akoma, – më foli ime vjehrrë. – Jemi në provë gjithë jetën. Mos e harro këtë.*

Por unë nuk isha në gjendje të ngrihesha. Ndenja shtrirë për ditë me radhë, e mbledhur kruspull, me kokën mbuluar. Vetëm në mëngjes herët dhe në mbrëmje isha e detyruar të ecja në këmbë ndonjë orë për t'u paraqitur në emërthirje, në qendrën e kooperativës, ku na kishin internuar. Ideja se mund të çmendesha, më tmerroi. Kushedi si do të kishte marrë shëndeti im po sikur shiu të mos kishte pushuar dhe moti të kthente në ca ditë të mrekullueshme me diell.

Një mëngjes gjyshi i Antuanit m'u lut të ngrihesha.

– *Simonë, duhet të shikosh patjetër diçka, – më tha.*

Dola jashtë. Poshtë, ku mbaronin kodrat, shtrihej një fushë e paanë, pastaj, përtej një brezi të gjerë pishash, deti. Sipërfaqja e tij e lëmuar shkëlqente nën diell. M'u duk se ajri i tij, me atë aromën tipike të jodit dhe algave, më zgjeroi mushkëritë. Një çift pulëbardhash erdhi ndoshta gabimisht deri pranë kodrave, pastaj bëri një hark dhe mori përsëri drejt bregut.

Mbulova sytë me duar, duke mos e besuar atë peizazh që shtrihej para meje dhe për t'i mbrojtur ata nga drita e diellit. M'u morën mendtë. Gjyshi i Antuanit më hodhi krahun dhe më mbajti pranë vetes. I hapa sytë përsëri. Bluja magjepsëse e detit ishte po aty. Hapa krahët duke qeshur dhe i tunda si një pulëbardhë. Ashtu si edhe im shoq, kisha vetëm një ëndërr të vjetër, të çmendur për ato kohëra: ta kaloja atë det. Ia thoshim atë ëndërr njëri-tjetrit sa herë që dilnim shetitje nga plazhi.

– Simonë, do të vijë ajo ditë, – më tha ai. – Të jesh e sigurt që do të vijë.

E kapërceva shpejt atë gjendje dëshpërimi. Fillova të punoja si një mushkë stani. E di ti, zemër, ç'është një mushkë stani?

– Jo, nona. Nga ta di?!

– Është një kafshë heroike që mund ta bëjë rrugën e stanit, lart në mal, edhe tri herë në ditë. Ngarkuar, si në vajtje, ashtu edhe në ardhje. Edhe unë u shndërrova në një mushkë. Bëja normën në kooperativë bashkë me tim shoq dhe time bijë, pastaj qepja nën dritën e kandilit, punoja triko. Kur kthehesha nga puna, mblidhja degë të thata e dru ku të mundja. Ishte e vështirë të gjeje vajguri. Drutë përdoreshin dimër e verë. Kishte raste që shkoja nga bregu i lumit dhe mblidhja drutë që sillte rrjedha. I lidhja ato me tërkuzë dhe i mbaja në shpinë kilometra të tëra. Por ti edhe tërkuzën nuk e di se ç'është. Oh, vogëlushe, është një nga shpikjet e thjeshta të njerëzimit të lashtë që mua më ka shërbyer shumë.

Por angaria më e rëndë ishte ishte mbajtja e ujit. Nuk kishim pus. Burimi më i afërt ishte rreth 300 metra nga shtëpia. Kushedi sa kova e gjyma kam mbushur në atë burim! Një ditë, kur veshja një fustan, m'u duk se krahët më ishin zgjatur. Ndodhte që rrëshqisja në baltë dhe rrëzohesha bashkë me gjymat apo kovat. Shaja e mallkoja një copë herë për të shfryrë nervat, pastaj kthehesha përsëri në burim.

Vogëlushe, përpjekjet për mbijetesë zgjojnë te njerëzit energji të mistershme dhe një vullnet të hekurt. Të bëjnë të ndërtojnë një botë të tërë nga e para. Ashtu si ata shtegtarët e dikurshëm të Perëndimit të Largët, që nguleshin diku me një karrocë plaçka, për t'iu hyrë punëve të mëdha, edhe unë me tim shoq ndërtoam një kasolle

me dërrasa e llamarina për ta përdorur si kuzhinë, një haur për të mbledhur ujrat e shiut dhe një nevojtoare mbi një kanal që kalonte aty pranë shtëpisë. Zaptuam një copë tokë rrotull shtëpisë, ngritëm një gardh me thupra dhe e kthyem në oborr. Në një pjesë të tij filluam të rrisnim njomishte e zarzavate. Prapa shtëpisë mbo-llëm pemë dhe një pjergull.

Por gjëja më e bukur e asaj jete në internim qenë pulat e mia. E nisa me një dhe arrita në dyzet krerë. Kotecin e kisha me dy kate. Vezët i mblidhja me shportë. Vogëlushe, ti nuk mund ta besosh se si një njeri mund të dashurohet me pulat. I doja si budallaqe. Disave, atyre më të bukurave, u kisha vënë edhe emra.

– Ç'emra?!

– Emra aktoresh të njohura të kinemasë, Greta, Xhina, Grejsi ose emra që lidheshin me ngjyrën e pu-plave. Pse, harrohet Greta ime e shtrenjtë?

– Mbante emrin e Greta Garbos?

– Dora vetë. Ishte një pulë elegante, këmbëgjatë, gri, me cikla të bardha. Herë-herë rrinte e trishtuar. Por ama i bënte vezët me dy të kuqe. Eh, ç'vezë ishin ato! Ç'pula ishin ato! U shndrisnin pu-plat. Unë ua pastroja kotecin çdo javë. I ushqeja për merak. Një ditë ra një shi si i verdhë dhe bukuroshet m'u bënë pis. Ngroha ujë dhe fillova t'i laja me sapun. Ime vjehrrë dhe Dalila, fqinja jonë që tymoste me pipë, u shkulën së qeshuri.

– *Simonë, mjaft se do të hysht në historinë e kësaj krahine, – më foli Dalila. – Nuk lahen pulat me sapun, moj zemër. Ato dinë vetë të pastrohen, mos ua qaj hallin.*

Eh, u shkoi nami deri larg pulave të mia! Vinin më kërkonin vezë për të shtruar klloçka. Por më i bukuri, më legjendari e më i pakrahasueshmi ishte Napoleoni. Trimi i nënës!

– Qeni juaj?

– Jo, vogëlushe. Qenin e quanin Kauboj. Napoleoni ishte gjeli im. Oh, të lutem, mos qesh! Boll kanë qeshur me mua për atë gjel. Por ti nuk e ke njohur atë mrekulli të natyrës. Kishte ardhur në këtë botë për të qenë perandori i shpezëve. Nuk kishte ngjyrë që të mos ndodhej në puplat e tij. Ia kalonte një papagalli. Dukej sikur kishte veshur një uniformë perandori. Ishte trupmadh, me ecje të rëndë prej ushtaraku, bishti i ngrihej përpjetë si një hark ylberi, lafsha e kuqe dhe e lartë i qëndronte mbi krye si një përkrenare romake. Kur këndonte mbi pullazin e kotecit duke shkundur krahët e duke zgjatur qafën si një tenor kur arrin notën më të lartë, ia kalonte çdo shpendi këngëtar.

Pulat përgjërroheshin pas tij, ashtu si edhe unë. Napoleoni çukiste ushqim mbi dorën time. Më ndiqte pas kur nisesha për në punë. Aq shumë u lidha me të, sa një ditë, tek po i flisja tërë përkëdheli, lexova në sytë e tim shoqi gjurmë xhelozie. Qesha me gjithë shpirt. Raca njerëzore është e çuditshme. Ai që nuk ishte bërë kurrë xheloz për ndonjë burrë tjetër, mori inat një gjel! Eh, meshkujt!

Edhe Napoleoni ishte xheloz dhe tip zotërues mbi pulat e tij. I kontrollonte si një inspektor i frikshëm. I trajtonte me butësi dhe ngrohtësi si ata pashallarët e dikurshëm haremin e tyre. S’kishte skenë më të bukur sesa kur Napoleoni bënte dashuri me pulat e tij. Fillimisht ngrefosej, gafronte puplat, ngrinte kokën, nxirrte gjoksin para, njërin krah e shtrinte gati përdhe dhe i vinte pulës rrotull. Ajo tulatej e bindur dhe e kënaqur. Ai me një vrull të shkurtër i kërcente sipër. Eh, dashuri shpezësh! E shkurtër, as dhjetë sekonda. Por ama ishin sekonda kulmore. Dhe pastaj Napoleoni tërhiqej duke

u shpupuritur.

Por edhe atij, si çdo mashkulli në këtë botë, i doli një rival. Në fillim unë i therja gjelat. Nuk doja ta shqetësoja Napoleonin në mbretërimin e tij. Deri sa një ditë gjyshi i Antuanit më tha duke qeshur se tërë ai harem pulash ishte i madh për një gjel të vetëm. Ato mund të mbeteshin të pakënaqura. Dhe kështu rrita një bukurosh tjetër me pendë të kuqe e të blerta. Napoleoni filloi të kacafytej me të sapo i riu hyri në fazën e dashurisë. Ishin kacafytje të egra që shkonin deri në përgjakje. Napoleoni ishte më i fortë, por tjetri kishte zemër dhe nuk dorëzohej. Për shkak të grindjeve dhe armiqësisë mes tyre, gjelin e ri e quajta Duka i Uellingtonit.

– Duka i famshëm që munda Napoleonin në Vaterlo?

– Ëhë. Por, dalngadalë, Napoleoni filloi ta lëshonte një pjesë të haremit. Deri sa një mbrëmje, deri te hundët e mia mbërriti aroma ngacmuese e një shpendi të pjekur. Atë aromë mund ta lëshonin vetëm shpezët e mia. Shkova te koteci të numëroja pulat, kur, ç'të shoh! Napoleoni mungonte. Fillova ta kërkoja sikur të ishte ndonjë fëmijë i humbur në plazh apo në stacion të trenit. Napoleon, thërrisja më duart para gojës, Napoleon ku je? Thirra aq shumë, sa gjysma e lagjes sonë të vockël të të internuarve dolën jashtë.

– *Zonja Simonë, ç'është ky Napoleon? – më pyeti një ish-profesor liceu.*

– Më ka humbur ai, – iu përgjigja. – Ai...

Por nga nervat harrova se si quhej gjeli shqip.

– *Kush ka humbur, zonja Simonë? – vazhdoi profesori.*

– Ai, dreqi ta hajë! Burri i ...

– *Yt shoq?*

– Jo, jo. Burri i pulave.

– *Ah, gjeli!*



– Po, gjeli.

– *Këtej rrotull do të jetë, mos u shqetëso, – më ngushëlloi profesori.*

– E kishin vjedhur? – pyeti vajza me keqardhje.

– Po, ma kishin grabitur të shtrenjtin tim. Ma kishin masakruar Tri Madalenat.

– Kush ishin këto?

– Oh, atëherë i quanin brutalisht thjesht kurva. I kishin internuar për sjellje imorale në shoqëri dhe prostitucion. Unë dhe gjyshi i Antuanit i quanim me shaka Tri Madalenat në pritje që të vinte Jezui shpëtimtar, t'i ndeshte në rrugë dhe t'i shpëtonte, siç ndodhi me të famshmen Maria Madalena. Në këndvështrimin klasik të zanatit të prostitucionit, ato vajza nuk ishin prostituta. Nuk shkonin me pagesë. Kërkonin vetëm liri për të bërë dashuri me kë t'ju ndizte. Por si të gjitha liritë, edhe ajo dënohej. Ato i kishin larguar nga qyteti sepse njollosnin moralin e tij.

U nisa andej nga vinte aroma e mishit të pjekur shpezëror dhe mbërrita te dhoma ku jetonin tri nimfat. Ato po bënin festë. U kishin ardhur për vizitë disa djem, edhe ata të internuar diku gjetkë. Kërkova rreth e rrotull dhe i gjeta puplat e Napoleonit në një kanal. I mblodha, u ktheva në shtëpi, rrëmbeva sëpatën e druve dhe vendosa të hakmerresha. Ia ngjesha me shkelm derës së dhomës ku po bëhej festa dhe hyra brenda me sëpatën ngritur. Duhej të kisha marrë një pamje prej amazone, sepse festuesit dionizianë ngrinë. Vështrova tryezën. Mbi të qëndronte i copëtuar barbarisht i bukuri im. Sytë m'u mbushën me lotë.

– Shtriga, pse ma vratë Napoleonin tim? – thirra.

Në fillim vajzat u mallëngjyen dhe bënë be e rrufe se gjeli mbi tryezë nuk ishte imi. Por kur unë u tregova

puplat, filluan të fshiheshin pas djemve. Sëpata dridhej në duart e mia.

– Kishit pula plot, moj shtriga, – thirra përsëri. – Pse ju vajti dora te mbreti?

– *Na fal, zonja Simonë, – foli njëra prej Madalenave. – Ti je e mirë. Do të na falësh.*

Djemtë u prekën. Njëri prej tyre nxori ca lekë.

– Nuk dua lekë! – ia preva unë.

– *Atëherë, zonjë, ju premtoj se do t'ju sjell një gjel deti, – tha ai. – Fjalë burri. Ju lutem, uleni sëpatën dhe hajdeni të pini një gotë bashkë me ne. Nuk jemi aq të degjeneruar sa na tregojnë. Vetëm kemi lindur në kohën dhe vendin e gabuar.*

– Nuk mund të marrë pjesë në një masakër, – iu përgjigja dhe u largova.

U ktheva në shtëpi duke qarë. Vajza dhe ime vjehrrë lanë mendjen. Ia mbërriti edhe Dalila. Nuk dinin si të më ngushëllonin.

– *Kulmi! Edhe sikur të kishe qenë dashuruar me Napoleonin e vërtetë, nuk do të kishe qarë kështu, – tha Dalila. – Simonë, mjaft, të lutem! Kështu qahet vetëm shpirtërat e shtëpisë.*

Por ajo nuk mund ta kuptonte se Napoleoni kishte qenë një shpirt i shtëpisë. Pendët e tij i lava me shkumë sapuni dhe i thava pranë sobës. Bëra me to një fshirëse pluhurash. Eh, ajo nuk ishte një fshirëse, ishte një ylber i lidhur me fjongo. Ka qenë rrotull nëpër shtëpi deri vonë. Mbase e kam futur në ndonjë baule dhe e kam haruar. Atë fshirëse e quajta napolonkë. Askush nuk guxonte të ma prekte.

Eh, ja kështu hyn në histori njeriu. Deri në fshatrat rreth e rrotull u përhap e forta ime me burrin e pulave. Kur ndokush donte të më nxehte, më pyeste nga pas:

“Zonja Simonë, ku e ke burrin e pulave?” Por mua nuk më mbeste hatri. Vetëm qeshja.

– Po ai djali, e solli gjelin e detit?

– Po, u tregua burrë.

– Dhe jeta në kotec vazhdoi pa Napoleonin?

– Eh, pa Napoleonin vazhdoi jeta në Francë e jo më në kotecin tim. Pulat kishin Dukën e Uellingtonit. Vazhduan të shumoheshin. Me vezët e tyre ne jo vetëm ushqeheshim, por bënim edhe pazar primitiv te dyqani i kooperativës. Çonim vezë dhe merrnim sapun, vaj, oriz, sheqer, miell.

Por erdhi një ditë dhe koteci im shkaktoi mërinë e pushtetarëve të fshatit. Kryetari i këshillit popullor tha në një mbledhje se ne armiqtë po bënim pallë me mish pule dhe verë. Pas atyre fjalëve një rojë i kooperativës kapi dy nga pulat e mia në një parcelë me grurë dhe pasi më gjobitën, më urdhëruan të prishja kotecin dhe t’i hiqja pa vonesë të gjitha pulat. Ato i shkaktonin dëme pronës së përbashkët.

U detyrova ta zbatoja atë urdhër. I shita pulat ku munda. Ca i thera. Mbajta fshehurazi vetëm dy prej tyre, të cilat e kalonin natën strehëve rrotull shtëpisë. Kotecin e bukur me dy kate e prishëm, por ndërkohë mua më kishte lindur një ide tjetër e mrekullueshme. Më dërrasat e tij ndërtoam një kafaz lepujsh. Fillova të rrisja veshgjatë. Më kishte mësuar Sara t’i gatujta. Sidomos polenta e gjuetarit me miell misri bëhej tepër e shijshme. Sa për kërmijtë, ata nuk ishin problem. Kishte rreth e rrotull me bollëk. Filluan t’i hanin edhe të internuarit e tjerë të kolonisë sonë të vogël. Madje ai profesori i liceut shpiku një metodë ballkanase gatimi, i piqte në prush.

Eh, ç’kohëra!

Gruaja e moshuar u mbush një copë herë me frymë, duke thithur me tërë mushkëritë ajrin e detit.

– Po në plazh, shkonit ndonjëherë? – pyeti vajza.

– Rrallë. Shumë rrallë. Verës, kur na rastiste të punonim në parcelat afër detit. Një të internuari nuk i tepëronte kohë për plazh. Veç kësaj ishte fanatizëm i madh në ato vite. Në fshat nuk mund të zhvisheshe para meshkujve. Jam larë në det vetëm dy herë. Të dyja herët me fustan. Zbulova vetëm krahët dhe pulpat.

Detin e vështronim vetëm nga larg, sidomos netëve të ngrohta me hënë të plotë. Uleshim jashtë mbi bar dhe qëndronim të mekur para asaj hapësire të frikshme, të larë në argjend. Imagjinonim si do të ishte dita kur do ta kalonim atë det. Vogëlushe, netët me hënë të plotë janë vetëm për të menduar gjëra të ndaluara e për të bërë marrëzira. Të gjitha ëndrrat e kalimit të detit përfundonin me fjalët: “Dhe ata bënë dashuri deri në mëngjes, të lumtur”.

Ishte e llahtarshme të flije brenda netëve me vapë dhe ne shfajësoheshim me atë vapë për të kryer arrati të vogla dashurore. Merrnim batanijet dhe shtriheshim rrëzë ndonjë mullari. Aty, rrethuar nga aroma dehëse e luleve dhe e barit të thatë, e kashtës, që verdhonte si flori nën dritën e hënës, e tokës që në verë të kujton aromën e gruas bardhoshe me gjinjtë plot qumësht që mëkon fëmijën, kapërtheheshim në krahët e njëri-tjetrit nën qiellin e hapur që fekste tërë lajle-lule si një jorgan ciganësh.

Rrallë bëmë dashuri në dhomën tonë të vogël e mbytëse, ndarë me perde, ku ime vjehrrë dhe mamaja e Antuanit flinin në njërën ndarje, kurse unë dhe im shoq në tjetrën. Kjo ndodhte kur ato të dyja shkonin mbrëmjeve për vizitë te Dalila ose te ndonjë familje tjetër e

internuar. Ndërsa kur moti ftohej dhe nuk flinim dot jashtë, shkonim natën nga burimi, gjoja për të mbushur ujë më shpejt, sepse nuk kishte radhë. Por gjithmonë vonoheshim dhe ime bijë pyeste me keqardhje dhe naivitete: gjithmonë ka radhë në atë burim? Ne qeshnim me kokat ulur. E po, edhe burimi nuk është fort afër, thoshte pa vonesë ime vjehrrë, që, sigurisht, kuptonte gjithçka.

– Po me pianon si shkoi puna?

– Më shumë qëndroi mbuluar. I bija vetëm kur organizonim ndonjë festë, nga frika se mos na dëgjonin dhe spiunonin. Veç kësaj, pas tërë atyre që kishte hequr, ai instrument kishte pësuar një çakordim të rëndë. Ishin të rrallë njerëzit që akordonin piano. Duhej t'i kërkoje me qiri. Le që aty te ne nuk guxonte të vinte njeri edhe sikur ta paguajë me flori.

Një natë, ndërsa festonim Vitin e Ri, vera bëri të vetën dhe ne harruam se kush ishim dhe ku ndodheshim. Erdhën edhe Dalila me profesorin e liceut dhe filluam të këndonim këngë të vjetra franceze e italiane. Ndodhi që pianoja dhe zërat tanë u dëgjuan deri larg, apo dikush aty nga kolonia na spiunoi, këtë nuk mund ta them. Pas pak ditësh erdhën njerëzit e këshillit të fshatit dhe ma morën. Më kujtohet që kryetari i këshillit, i cili mbante në brez një kobure dhe një palë pranga, simbolet më të spikatura të pushtetit, m'u drejtua me fjalët:

– *Ti, armike, nxirre shpejt atë qemane! Nuk lodheni sa duhet ju, prandaj merreni me muzikë.*

Ai nuk kishte parë kurrë piano, e mendonte atë diçka të ngjashme me kitarën. Kur i thashë se duheshin dy burra dhe një qerre për ta marrë, pandehi se po tallesha.

– *Allah, Allah! – ia bëri kur e pa. – Me se i bihet kësaj?*

Pianon e çuan në shtëpinë e kulturës së kooperativës, kurse brigadierin tonë e urdhëruan të na caktonte vetëm në hapje kanali me lopatë. Por ai ishte një tip babaxhan, me shpirt fetar dhe lufta e klasave i dukej lodhëse dhe pa bërëqet, më keq se lufta e Trojës. Veç kësaj, kishte një vajzë të fejuar dhe unë i kisha qepur asaj goxha rroba për pajën. Brigadieri na futi ca ditë në kanal, deri sa puna e pianos u harrua, pastaj filloi të na trajtonte njëlloj si të tjerët.

– Po fshatarët, si silleshin me ju?

– Ishin të paktë ata që na urrenin e na shanin. Unë dhe ime bijë u miqësuan me të gjitha gratë dhe vajzat e brigadës. Ato na sillnin shpesh nga shtëpia qumësht dhe fruta. Mua më shikonin si perëndi. U qepja fustane, u prisja flokët, i mësoja si të kujdeseshin për lëkurën; si të zbatonin rreptësisht higjienën vetjake. Mos harro, vogëlushe, se në ato vite, atyre anëve gjeje ende gjurmë të Mesjetës.

Nuk e harroj një ditë me shi kur familjen tonë e thirrën në vatrën e kulturës për demaskim.

– Ç'ishte ky demaskim?

– Një lloj teatri i shëmtuar ku fshatarët shanin armiq-të e internuar. Në sallën e mbushur plot nuk pranoi njeri të hapte gojë kundër nesh. Atëherë, njerëzit e këshillit filluan të urdhëronin ca të gjorë, që kishin ndonjë cen në biografi, të ngriheshin. Ishte për të qeshur kur njëri na quajti caristë e bjellogardistë. Në fund na pyetën ne në kishim gjë për të thënë. Unë vështrova nga salla dhe fola e mallëgjyer:

– Ju dua shumë të gjithëve.

Ato fjalë e shushatën kryetarin e këshillit.

– *Ata nuk kanë nevojë për dashurinë tënde, – thirri ai.*  
Të nesërmen në mëngjes unë gjeta te pragu i derës

një enë me qumësht dhe një shportë me fruta. Me siguri i kishte lënë aty ndonjëri nga ata që na kishte sharë me urdhër.

– Po me pianon, ç'u bë?

– Mbeti në një qoshe të shtëpisë së kulturës për disa vjet. Askush nuk vuri dorë mbi tastierën e saj. Njerëzve u dukej si një anije kozmike. Shkova një ditë, e përkëdhela me mall, e mbulova me një perde të vjetër dhe iu luta përgjegjësit të shtëpisë së kulturës që ta kishte kujdes.

– Oj Simone, a ta mbuloj lala me libra e gazeta që të mos duket fare? – ma ktheu ai.

Pranova duke qeshur. Megjithatë, instrumenti nuk shpëtoi nga dëmtimi. E gërryen krimbat. E mbytën pluhurat. Disa taste iu shkulën, kushedi nga kush. Madje, kur e mora përsëri, gjeta në të një fole minjsh.

– Arrite ta merrje përsëri?!

– I erdhi radha një batice fati, fat që unë nuk e prisja kurrë. Një shok i vjetër sindikalist i babait ishte bërë anëtar i komitetit qëndror të një partie komuniste belge, nga ato partitë e tipit marksist-leninist. Ishte pranverë e vitit 1970 kur një delegacion i vogël i asaj partie erdhi për vizitë në Shqipëri. Nëna i qe lutur shokut të babait që të interesohej për mua. Ajo ishte e vetmja që vazhdonte të më shkruante në adresën e vjetër dhe të më kërkonte. Por letrat e saj nuk më binin në dorë. I kishte kërkuar qeverisë belge që të më gjente dhe të më kthente në shtëpi, por kishte marrë gjithmonë përgjigje burokratike që vetëm e përcillnin sa në një zyrë në tjetrën. Është e lehtë të harrohet një njeri, vogëlushe. Fare e lehtë. Raca njerëzore është egoiste. Të gjithë shohin punët e tyre dhe ti mbetesh e vetme në fatkeqësinë tënde. Madje as nuk përmendesh më për e gjallë.

Veç nëna nuk të braktis. Ajo më kishte dërguar një pako me dhurata. Kur e preka atë pako me duar, fillova të qaja si fëmijë. Qau edhe Frederiku, shoku i babait. Ai më mbante mend vajzë të vogël me gërsheta. Vinte në shtëpinë tonë për mbledhje të fshehta dhe për të lexuar literaturë komuniste. Dikur kishte pasur ca flokë dhe mustaqe të bukura, të kuqerremta, por kur e takova unë e kishin mbuluar thinjat.

Krejt papritur erdhi në fshat një makinë. Dy njerëz, me sjellje tepër miqësore, më morën në mes të parcelave. Megjithatë, unë kërkova me sy gjyshin e Antuanit dhe vrapova drejt tij e trembur, për ta përqaftuar.

– Shoqja Simonë, kemi një lajm të mirë, mos u tremb, – më foli duke qeshur njëri prej burrave që kishin ardhur të më merrnin.

– *E dashur, nuk bëhet fjalë për arrestim, – më pëshpëriti im shoq. – Shko e qetë.*

Më lanë kohë vetëm të ndërrohesha dhe t'u kaloja një krehër flokëve. Kur mbërritëm në qytet, në një nga hotelet e plazhit dhe unë pashë xha Frederikun që po më priste, klitha nga gëzimi.

– *Simonë, ç'të ka ndodhur? – më pyeti ai i trembur. – Pse nuk më lejuan të vija në shtëpinë tënde?*

– Oh, jetoj ca larg, – iu përgjigja duke buzëqeshur.

– *Ata më premtuan se do të të sillnin këtu afër detit.*

– Të premtuan vërtet?!

– *Po. Dije se nuk do t'i lë të më gënjejnë. Do të këmbëngul deri në fund për afrimin tënd. Nuk largohem pa të rregulluar.*

Ai e lexoi gjithçka në fytyrën time.

– *Simonë, të kanë çuar në ndonjë kamp pune? – më pyeti me zë të dridhur.*

– Jo, – iu përgjigja. – Është një kooperativë bujqësore



nga ato që ëndërronit ju dhe im atë. Jetohet, xha Frederik. Me ca vështirësi, por jetohet.

Ai më vështroi i mallëngjyer.

– *Simonë, për dashuritë e mëdha paguhet gjithmonë një çmim, – tha. – Ndoshta andej nga ne ti do të kishe pasur një jetë krejt të rëndomtë.*

– Oh, nuk jam fare e penduar, – iu përgjigja. – Të lutem, mos dysho për këtë! Thuaji nënës që jam e lumtur.

Të nesërmen e atij takimi drejtuesit kryesorë të kooperativës u treguan me mua jashtë mase të dashur e të respektueshëm. Më quajtën “shoqja Simonë”. Më uruan jetë të mbarë në qytet. I vështrova e qetë, pa pikë mllefi. Madje disave prej tyre u shtrëngova dorën miqësisht. Kisha filluar të lakohesha sipas mësimëve të Biblës. Ndërsa brigadierin e përqafova si vëlla. Ti nuk e beson, por gratë e vajzat e brigadës qanë kur u ndamë. Disa prej tyre më puthën dorën. Në ato çaste e kuptova se nuk i kisha gënjyer, i doja ata njerëz. Në thelb ata ishin si ne, armiqtë. Të internuar të mjerë. Nuk kishin të drejtë të largoheshin nga fshati për të jetuar në qytet. Nuk kishin të drejtë të punonin në vend tjetër përveç bujqësisë. Vogëlushe, duhet të dish se komunistët nuk i kanë dashur kurrë fshatarët. Gjithmonë i kanë mbajtur si armiq të mundshëm, sepse shpirti i fshatarit është i lidhur me pronën. Ndaj i kthyen në të internuar të pa-deklaruar.

Ndërsa po stivonim në kamion rrangullat tona të fundit, gjyshi i Antuanit më pyeti mos kisha harruar gjë. Vetëm atëherë u kujtova për pianon. Iu kërcënova kryetarit të këshillit se nuk largohesha pa më dhënë qemanen time. Ma kthyen pa kundërshtimin më të vogël. E kishin harruar fare që në fshatin e tyre ndodhej një piano.

– *Shoqja Simonë, nuk ma ha mendja të më mbash inat, – m'u drejtua kryetari. – Një qemane ishte e shkreta.*

Eh, uroj që ai njeri të mos largohet nga kjo botë pa e marrë vesh se ekziston një instrument muzikor me emrin piano.

U ndava me të internuarit e tjerë e përlotur, pastaj me lepujt, qenin, dy pulat ilegale, përkëdhela hardhinë dhe pemët e tjera që i kisha mbjellë vetë. Kur kamioni u nis dhe gjithçka mbeti pas, bashkë me brezin e pishave atje poshtë dhe detin, papritur ndjeva një mall mbyttës për atë vend. Eh, ndodhin çudira në jetë!

– *Simonë, ti e bërë të bukur atë vend, – më pëshpëriti im shoq në vesh. – Pa ty asgjë nuk do të kishte kuptim. Nuk ia kaluam keq, apo jo?*

– Mbase këta do të jenë vitet më të bukur të jetës sonë, – ia ktheva. – Të presim e të shohim. Jeta vazhdon.

– *Simonë, kurrë nuk do ta marrësh vesh se sa shumë të dua, – tha ai papritur, duke i nxjerrë ato fjalë gati si i torturuar e duke u skuqur deri në rrënjë të fokëve.*

– Ishte hera e dytë në jetë e atyre fjalëve të mëdha? – pyeti vajza.

– E saktë. U pështeta në kraharorin e tij dhe e putha gjatë. Ishim vetëm majë karrocerisë së kamionit. Ime vjehrrë dhe vajza ishin ulur në kabinë. Isha si e dehur, ndonëse në qiell nuk kishte yje dhe hënë të plotë.

– Vegim, më duket se nuk kemi bërë ndonjëherë dashuri në ndonjë kamion, – i thashë duke qeshur.

Ai u tremb nga ajo ide.

– *Simonë, të lutem, ja, mbërritëm në shtëpi, – tha.*

– Jo, tani! – thirra.

– *Atëherë, dije se kemi bërë një herë dashuri në një kamion. Të kujtohet në Itali, atë natë që na zuri shiu në rrugë? Kemi fjetur në karrocerinë e mbuluar të një kamioni.*

- Po ai nuk ishte në lëvizje!
- *Në lëvizje apo në vend, ishte kamion.*

Filluam të qeshnim si budallenj dhe unë u tregova e duruar.

- Nona, je fantastike, – qeshi vajza.
- Është jeta fantastike, vogëlushe. Është liria. Një njeriu që ka fituar lirinë i falet çdo marrëzi dashurore.

## X

– Po kamioni ku ju la?

– Na kthyen përsëri në vilën tonë. Kur mbërritëm atje, gjetëm në oborr komandant Pelivanin. Po mbushte një arkë me vogëlsira pa pikë vlere. I kishin dhënë një apartament diku larg qendrës dhe nga ajo lëvizje ai dukej tepër i pakënaqur. Nuk na foli. Vetëm na vështronte në bisht të syrit me një urrejtje përvëluese.

– *E kanë gabim shokët drejtues që e zbusin luftën e klasave, – e dëgjova t’i thoshte një anëtar i të këshillit të lagjes.*

– *Këta borgjezë m... armiq do të ngelen gjithmonë. Por nuk kanë faj ata atje lart. Harruan plagët tona...*

– *I di partia ato punë, – ia preu tjetri shkurt.*

Neve na dhanë në katin e parë të vilës dhomën e madhe të ndenjies, një dhomë gjumi dhe banjon, të cilën duhej ta ndanim me një familje tjetër, një çift i ri me një fëmijë të vogël, që kishin zënë pjesën tjetër të katit. Pas zaptimit që i kishte bërë katit nën dhë komandanti i topave, ai na u kthye po neve si pronarë të vilës. Vetëm atëherë e kuptuam ngulmimin e topçiuat për të na dëbuar nga qyteti e për të na internuar. Në strehën tonë ai kishte futur ca njerëz të tij nga fshati, që synonin të nguleshin me çdo kusht në qytet për t’iu shpëtuar dhive. Kjo është raca njerëzore, vogëlushe.

Ime vjehrrë ra në gjunjë dhe duke lavdëruar Zotin, puthi pragun e derës, pastaj filloi të përkëdhelte muret. U fliste sikur ata të ishin të gjallë dhe do t’i kthenin për-

gjigje. U trishtua shumë që muri rrethues i vilës dhe porta e saj e madhe ishin dëmtuar. Askush nuk kishte vënë dorë për t'i meremetuar. Edhe nga jashtë vila kishte mbetur pa lyer që nga koha e dasmës sime. Vende-vende suvaja ishte gërryer. Ullukët e shiut ishin shtrembëruar e këputur. Anët e oborrit i kishte mbuluar bari. Rrotull nuk shikoje asnjë lule.

*– Eh, nuk i dhimbset njeriu ky truall, – rënkoi ime vjehrrë. – Është e lehtë të jetosh në shtëpi të botës. Por një ditë haka kthehet te i zoti. Mund të duhen jetë njerëzore, por një ditë kthehet.*

Kështu nisi për ne një periudhë qetësie e mbarësie. Im shoq u kthye në punë me një rrogë të mirë. Mua më pranuan mësuese pianoje në Shkollën e Muzikës. Shoqëroja nxënësit gjatë studimit. Mamaja e Antuanit filloi punë në Ndërmarrjen e Plastikës që sapo ishte hapur. U martua me një agronom dhe në krye të vitit lindi djalin. Ndërkohë mbaroi maturën gjatë mbrëmjes dhe e lejuan të ndiqte filialin e Inxhinierisë Mekanike, edhe këtë në mbrëmje.

Pas tërë atyre viteve heshtjeje fillova t'i shkruaja përsëri nënës, e cila jetonte e vetme që pas largimit tim. E ftova të vinte për vizitë dhe ajo më premtoi se do ta bënte atë gjë. Por pas disa javësh u sëmur dhe nuk u ngrit më nga shtrati. Ia vonuan vizën hyrëse për në Shqipëri pafundësisht. Vazhdonin të dyshonin rregullisht tek unë. Nëna vdiq pa e takuar kurrë time bijë dhe Antuanin. I pa vetëm nëpër fotografi. I shkrova sime motre, por ajo nuk m'u përgjigj. Kështu fillova ta harroj gjithnjë e më shumë vendin tim.

Jeta shkonte përpara. Ne arritëm të blenim orendi të reja për shtëpinë, të cilën e meremetuam pjesërisht dhe e lyem. Unë dhe ime vjehrrë iu kthyem përsëri luleve.

Gjetëm rrënjë trëndafili të bardhë dhe ai filloi të zburonte rishtazi oborrin tonë nga pranvera e deri nga mesi i tetorit. Pianon e çova në një repart ku riparonin vegla muzikore dhe ajo mori përsëri pamjen e dikurshme. Tashmë luaja pa frikë mbi tastierën e saj, duke u mëshuar gishtave me tërë forcën, pa ankthin e vjetër se do të më dëgjonin e do të më spiunonin, pa atë ndjenjën e përhershme të terrorit se ndonjë makinë do të ndalej te porta për të na çuar rishtazi drejt burgut apo internimit.

Në ato vite paqeje dhe qetësie arrita të kompozoja edhe disa këngë, shumicën për fëmijë. Disa prej tyre iu kushtuan Antuanit. Tekstet e tyre m'i shkruante një tip i çuditshëm, i hutuar pas librave, të cilin nuk e lejonin të botonte për shkak të biografisë. Autorësinë e vargjeve ma dhuronte mua. Orkestrimin e këngëve e bënte burri i Sarës, i cili kurrë nuk arriti të jepte koncerte me violinën e tij, por përfundoi një mësues i rëndomtë muzike në një shkollë 8-vjeçare. Për çudi, ai dha koncerte vetëm për të shoqen. Kur luante para saj, ishte një mrekulli e vërtetë. Kishte kompozuar shumë, por gjithçka e mbante në sirtar.

– Po jeta e Sarës, si shkonte?

– Ajo vazhdonte të bënte një jetë krejt të heshtur. Nuk punonte. I ishte kushtuar shtëpisë. Erdhi e para të na takonte pas kthimit tonë nga internimi. Gatoi për ne picë me këpurdha dhe makarona me fruta deti. Këto ishin gatime që në atë kohë pakkush i njihte. Sara e dinte që mua më pëlqenin. Papritur ia ngulëm sytë njëra-tjetrës të përlotura dhe pamë se tashmë ishim gra në moshë kritike. Ajo kishte filluar t'i mbante flokët të mbledhura topuz. E kishin sulmuar thinjat dhe rrudhat e para, por, gjithsesi, më pak se unë.

Filluam të shoqëroheshim më dendur bashkë. Ditëve

të ngrohta uleshim në breg të detit dhe bisedonim gjatë. Edhe ajo ishte shkëputur pothuaj plotësisht nga njerëzit e saj në Itali. Shkëmbente më të rrallë ndonjë letër. Trembej se komunizmi do të zgjaste me shekuj dhe nuk do të kishte kurrë më rast të shkelte në vendin e saj.

– *Dhe të mendosh që është kaq afër!* – *psherëtinte shpesh.*  
– *Mund të bëjnë martesë edhe pulëbardhat nga njëri breg në tjetrin.*

– Do të presim, – i përgjigjesha unë. – A nuk të duket se tani vitet sikur kanë filluar të ikin më shpejt?

Pas atyre fjalëve ajo më vështronte e zhgënjyer. Nuk guxonte ta pranonte se ne po plakeshim.

Në ato vite filloi të shoqërohej me ne edhe Tatjana Radika, një ruse e martuar në Shqipëri që në vitet '50. Edhe ajo ishte mësuese në Shkollën e Muzikës. Jepte histori arti. Në piano luante jo keq. Grua si ajo rrallë kam njohur në jetë.

– Ishte e bukur?

– Sigurisht. Një bukuri tipike ruse. E gjatë, me një fytyrë të gjerë, me tipare të lëmuara dhe sy të thellë ngjyrë kafe që të kujtonin pafundësinë e një stepe.

– E kishte prurë edhe atë në Shqipëri një dashuri e madhe?

– E çfarë mund ta sillte tjetër? Çfarë e mbajti pas prishjes me Bashkimin Sovjetik? Qyteti ynë, përveç grave perëndimore, kishte edhe shumë gra lindore që nuk i braktisën dashuritë dhe fëmijët e tyre: ruse, çeke, bullgare, polake, hungareze, rumune, jugosllave. Mungonin vetëm kinezet. Nganjëherë im shoq më thoshte me shaka se shqiptarët kishin një gen të vjetër perandorak, i cili vinte që nga koha e Perandorisë Osmane, madje edhe më përtej. Martesat me gra të huaja të viseve të largëta nuk ishin gjë e re për ta. I vetmi ndryshim

ishte se dikur, kryesisht, shkonin burrat me shërbim në viset e grave, nga Kurdistanit e deri në Egjipt, kurse në ditët tona vinin gratë pranë burrave.

Vitet '70 qenë më të zymtët për ne gratë e huaja. Filluam të niseshim drejt burgut njëra pas tjetrës. Të parën arrestuan Tatjanën bashkë me të shoqin. Të dytën Sarën. Ndërkohë, fatit tim i kishte ardhur radha e një zbatice cinike. Partia marksiste-leniniste, ku bënte pjesë xha Frederiku, doli revizioniste, ndoshta maoiste. Delegationet e saj nuk ftoheshin më në Shqipëri. Atij devijimi politik nuk i shpëtova dot as unë. Më hoqën nga Shkolla e Muzikës dhe më lanë pa punë. Gjyshin e Antuanit e nxorën në pension. Ishte një pension me të ardhura të mjerueshme.

Unë po prisja radhën. E dija që do të më arrestonin. Më përgjonin ngado. Atëherë, vendosa të prisja me qetësi gjithçka që do të ndodhte. Arrita të fsheh Biblën dhe ikonën e sime vjehrrë. Ishin gjëra që mund të më rëndonin goxha. Fillova të qëndroja pranë tim shoqi çdo minutë. Bënim shëtitje të gjata, duke menduar se cila prej tyre ishte e fundit. Natën vonë, një herë në javë, si ai lumi i lodhur që bie në fushë dhe kreshpërohet më të rrallë në ndonjë va, bënim dashuri, duke menduar të njëjtën gjë: do të jetë e fundit. Dashuritë e fundit janë të mrekullueshme, vogëlushe, njëlloj si ato të parat, ndonëse nuk kanë vrullin e tyre. Nuk harrohen.

– Kur ndodhi e fundit për ju?

– Oh, nuk e harroj dot atë natë. Të nesërmen më arrestuan. Binte një shi inatçor. Frynte. Ne përpëliteshim në krahët e njëri-tjetrit. Kockat na thernin. Trupi sikur do të na çahet. Papritur, unë qava. M'u kujtua nata e njerëzve të Gestapos. Ashtu kisha bërë dashuri edhe herën e parë, duke qarë. Kurrë nuk më mbeti



peng që ajo ishte hera e fundit. Ishte një det i tërë dashurie, sa për të gjitha vitet që do të kaloja në burg.

Në mëngjes më arrestuan në një tregtoare aty pranë shtëpisë, në mes të njerëzve, në mënyrë që skena të trembte sa më shumë vetë. Shkova në qeli e qetë. E dija se do të më dënonin kot, siç kishin vepruar me tim shoq më parë, me dhjetra intelektualë, me gra të tjera të huaja para meje. Të trimërohej një shtet i tërë me ca gra të brishta e aq më tepër të huaja e pa mbrojtje! Ajo që prova e fundit që më bindi përfundimisht se rreth e rrotull nuk bëhej fjalë për komunizëm. Komunizmi që kisha ëndërruar unë mbeti një ëndërr e largët. Thonë se ai është ndërtuar në vendet skandinave. E ç'rëndësi ka se nuk quhet komunizëm? E rëndësishme është se nuk shihet njerëz të mjerë. E ç'do të kërkonte Jezui më tepër? Por, me sa duket, komunizmin e ndërtokan pikërisht ata që nuk janë komunistë.

– Nona, ndenje gjatë në qeli?

– Më shumë se një vit. Hetuesit donin t'i mbushnin mendjen vetes dhe mua se bëhej fjalë për një rast të bujshëm spiunazhi. Sipas skenarit, ne ishim një rrjet i rrezikshëm; unë dhe Sara spiunonim për Perëndimin, por nëpërmjet Tatjanës mbanim lidhje edhe me Lindjen. Pra, ishim si tip dopioagjentesh. Po përpiqeshim për të rrëzuar pushtetin popullor në Shqipëri.

Shkurt, iu luta Zotit të më ruante mendtë e kokës. Nuk pranova asnjëherë nga akuzat. Të paktën nuk më keqtrajtuat. Të jem e sigurtë. Madje njëri nga hetuesit ishte i ri dhe kohë pas kohe më pyeste në frëngjisht. Po përgatitej të mbronte gjuhën frënge. Vetëm më kërcënonin se po të mos pranoja akuzat, do të më burgosnin përsëri tim shoq dhe do të më internonin vajzën, të cilën tashmë e kishte ndarë i shoqi, me urdhër. Ç'njeri

i vogël! Krejt pa burrëri dhe dinjitet. Nuk e pata të vësh-tirë ta kuptoja se ai nuk e kishte dashur kurrë time bijë. Nuk mund të them se sa e kishte dashur ajo. Por mbi faqe të dheut ka edhe lidhje martesore të vockla. Plot.

– Dashuritë e mëdha ndodhin rrallë?

– Jeta ime më ka çuar në këtë përfundim. Të lutem, më kupto, vogëlushe! Nuk dua të fyej njeri. Por shumica e njerëzve janë të vegjël, tmerrësisht të vegjël. Të paafte për dashuri të mëdha. Mbase ky nuk është faji i tyre. Ashtu janë gatuar.

Kujtimi më njerëzor i asaj periudhe të kaluar në qeli qe një vizitë e shkurtër e sime vjehrrë. Ajo u ngrit nga shtrati ku po lëngonte. E kishte ndier afrimin e vdekjes. Dikush u prek nga lutjet e saj dhe më lejoi ta takoja. Folëm fare pak. Vetëm vështroheshim kapur për duarsh. Ajo mundohej të qëndronte ulur me nofullat shtrënguar.

– *Simonë, kemi kaluar vite të bukur bashkë, – më tha. – Të kërkoj falje nëse të kam lënduar ndonjëherë.*

– Nuk më ke lënduar kurrë, – iu përgjigja.

– *Im bir të meritonte.*

– Mbase isha unë që nuk e meritoja atë.

– *Jo, mos e thuaj më këtë fjalë. Nuk do të shihemi më Simonë.*

– Të kërkoj falje që ta fsheha ikonën.

– *Oh, ka edhe mënyra të tjera për t'iu lutur Zotit. Lutju edhe ti! Çdo ditë.*

– Përsëri jam në provë para tij?

– *Prova vazhdon gjithë jetën. Fati yt do të kthejë. Kurrë mos e humb besimin!*

Kur u ndamë, m'u duk se humba për së dyti nënën time. Ajo vdiq pas pak ditësh. E varrosën në vendin ku ndodheshin eshtrat e të shoqit.

– E zbatove porosinë e saj?

- Po. Lutesha për ditë. Recitoja përmendësh pjesë nga Bibla. Dora e parë që Zoti më dha që që nuk lajthita. Durova. Derisa erdhi dita e gjyqit. Më dënuan me dy dëshmitare të rreme. Të dyja i kishin detyruar ta kryenin atë veprim. Njërën e kisha pasur kolege në Shkollën e Muzikës. Tjetra që Sadetja.

- Sadetja?!

- Po. Kurrë nuk e fajësova. Ishte katandisur në gjysmë njeriu. E mbaj mend mirë në sallën e gjyqit. Ishte e zbehtë, duart i dridheshin. Kishte humbur e tëra nën një pallto të vjetër. Sytë i mbante përdhe. U ngushëllova me faktin se nuk e kishte të atin gjallë. Një mallkim tjetër të tij nuk do ta kishte përballuar dot.

E gjora Sadete u ngatërrua me ato që thoshte. I mbahej goja. Mend qau. Prova e saj që se që gjatë luftës, në grupin tonë komunist të qytetit, unë kisha folur për një republikë demokratiko-borgjeze që do të ndërtohej në Shqipëri me mbështetjen e Amerikës dhe Anglisë. Pushteti nuk do të ishte kurrë vetëm i komunistëve. Pak a shumë të njëjtat gjëra tha edhe kolegja ime e Shkollës së Muzikës, vetëm shtoi Belgjikën. Pra, sipas meje, Shqipëria duhej të bëhej si Belgjika dhe për t'ia arritur kësaj duhej përmbysur pushteti popullor.

I kundërshtova qetësisht ato akuza, megjithatë më dënuan me dhjetë vjet për agjitacion e propagandë me rrezikshmëri të lartë, në bashkëpunim në grup. Çuditërisht, u ndjeva e lehtësuar. Të paktën gjyshin e Antuanit dhe time bijë nuk i internuan. Dënimi për ta që që të largoheshin përsëri nga kati i parë i vilës dhe të jetonin vetëm në të nëndheshmin.

Më çuan në Brugun e Grave, në një vend të humbur mes ca kodrave të zhveshura, ku gjeta Sarën. Atë e kishin dënuar nja gjashtë muaj më shumë se unë. Kur më

doli para veshur me uniformën e burgut, pa tualet, e mbuluar nga thinjat...

– Të tmerroi?

– Jo, aspak. M’u duk më e bukur se kurrë. As aktorja Alida Vali nuk kishte qenë ndonjëherë aq e bukur. Ti e beson që vuajtjet të zbukurojnë?

– Ndoshta... të japin një pamje më fisnike.

– Të lumtë, vogëlushe! Rrallë kam parë fytyrë aq fisnike në jetën time.

– Qave?

– Jo. As unë, as ajo. Tashmë ishim mësuar t’i mposhtnim lotët. Vetëm u përqaftuam. Atëherë e kuptova se motrën e vërtetë nuk ta dhurojnë prindërit, por jeta. Ajo më quajti motër. Sa ëmbëlsisht tingëlluan ato fjalë në veshët e mi!

– Sara, motër për jetë, – iu përgjigja.

Dhe mbetëm të atilla.

– Po Tatjana?

– Edhe ajo erdhi më vonë. Ishte dobësuar shumë. Të kujtonte një shkurre të tharë stepe. Ndërkohë i shoqi kishte përfunduar në një burg tjetër. Kishte mbetur i lirë vetëm djali i tyre në moshë gjimnazi, një talent i lindur për muzikë. Por u detyrua ta linte Shkollën e Muzikës dhe hyri në punë që 17 vjeç. E kam takuar disa herë kur vinte në burg për t’u shmallur me të ëmën. Sillte me vete një çantë të vogël me ushqime. Në atë çantë gjendej gjithmonë një gjysmë pakoje gjalpë. Një ditë e pyeta Tatjanën se pse në ushqimet e saj gjendej gjithmonë një gjysmë pakoje gjalpë. Ajo nuk arriti të buzëqeshte. Lotët e tradhtuan.

– *Gjysma tjetër shkon te im shoq, – m’u përgjigj.*

Dhe të mendosh që racioni i gjalpëit ishte një pako në muaj për familje!

– A vazhdoi ajo të shoqërohej me ty dhe Sarën?

– Oh, sigurisht. Ajo shoqërohej me të gjitha. Ishte një lloj perëndie atje në burg. E respektonin të gjitha gratë, si ato të dënuarat për politikë, si ato që kishin kryer vrasje burrash apo dashnorësh, aborte të paligjshme, tentativa arratisjeje, kishin vjedhur apo ishin dënuar për sjellje imorale. Tatjana shuante çdo sherr apo rrahje që niste papritur, dëgjonte ankesa, jepte këshilla. Rrallë e kundërshtonin. Dalngadalë ajo mori pamjen e një mbrëtëreshe autoritare të thyer në moshë, së cilës nuk mund t'i bëhej fjala dysh. Edhe rojat e burgut druheshin prej saj. Rrallë kam parë në ato vite burg grua që ta pranonte një dënim të rëndë më aq vetmohim dhe qetësi. Sikur ta kishte ditur se një pjesë e jetës së saj do të kalonte brenda telave me gjemba. Eh, fate të çuditshme grash! Në shumë raste ato janë më të forta se burrat edhe në burg.

– Nona, të ndodhte ndonjëherë t'i humbje shpresat?

– Kjo na ndodhte të gjithave. Por i jepnim kurajë njëra-tjetrës. Atje nuk kishte kohë për të rënë pre e depresionit. Punonim në bujqësi, në parcelat e një ferme aty pranë burgut ose qepnim ca rroba të shpifura dhe thasë. Lodhja bënte të vetën dhe gjumi të dukej kapak floriri, sidomos kur duhej të ecnim mbi një orë në këmbë për të shkuar në frontin e punës. Ndonjë film apo koncert i parë në televizorin e vendosur në ngrënëtoren e burgut ishte argëtimi i vetëm. Pastaj numëronim ditët dhe prisnim vizitat e radhës.

Im shoq vinte rregullisht dy herë në muaj. Më mbante dorën mes duarve të tij dhe më vështronte. Përpiqej bashkë me time bijë të gatuanin ato gjëra që mua më pëlqenin më shumë. Nganjëherë më sillnin edhe kërmij. Unë e provoja njërin prej tyre, lëpija gishtat, pastaj buzët,

më tej përplasja gjuhën pas tavanit të gojës nga kënaqësia dhe i lëshoja lëvdatat lumë. Ai buzëqeshte dhe mundohej të më bindte se së shpejti do të ndodhnin ndryshime. Ngjarjet do të merrnin për mirë. Në çdo takim më sillte vizatime të Antuanit dhe letra të tij, në fund të të cilave shkruhej gjithmonë frëngjisht: "Nona, të dua shumë. Mezi po pres që ti të vish". Edhe unë i shkruaja, duke u munduar të gënjeja se kthimi im ishte punë muajsh.

Shpirti i gjyshes! Fotografinë e tij e mbaja nën jastëk. E puthja për natë, para se të flija. Në çastet më të rënda bisedoja me të dhe sikur lehtësohesha.

– Pse ai nuk erdhi kurrë në burg të të takonte?

– Unë nuk desha që ai të vinte. Vendosa që im nip të mos e shikonte burgun. Shpresoja që ai të mos e pësonte si gjyshërit e tij. Iu luta gjatë Zotit për këtë.

Kështu kalonte koha dhe një mëngjes të trishtë më shi pashë te porta e burgut tim shoq. Mbante në duar një tufë lulesh mbledhur me një gazetë. Atëherë u kujtova se kisha mbushur 65 vjeç. Atë ditë ai më puthi përmes hekurave dhe me një zë disi ndryshe, gati metalik, më tha:

– Simonë, të dua sa gjithë rruga që kemi bërë bashkë.

– Kjo ishte hera e tretë?

– Po. E vështrova e trembur. M'u duk i zbehtë, i dobët. Në fillim mendova se e kishte nga lodhja e rrugës. Por kur ai po largohej, vura re se qe kërrusur dhe herë pas here gjunjët i pritëshin. E nuhata se sëmundja kishte hyrë brenda tij.

Pas pak muajsh shumicën tonë e liruan pas një faljeje të madhe. Ka qenë janar i vitit 1986. Përfitova vetëm një vit nga ajo falje. Na kthyen në qytet me një autobus. Ai ndali te sheshi i stacionit të trenit. Me dhjetëra njerëz

po prisnin atje. Ishin familjarët tanë. E rrethuan autobusin dhe filluan të zgjasnin duart nëpër dritare. Zoti im, sa lotë dhe dhimbje kam parë atë ditë!

Sara zbriti ndër të parat. I biri dhe i nipi nuk e lanë të shkelte në tokë. Ajo mbeti varur në krahët e tyre, një krijesë e papeshë nga lumturia. Pastaj u dëgjua një thirrje ngjethëse në rusisht:

– *Mama, jam këtu!*

Ishte djali i Tatjanës. I shoqi i saj po priste pak më tutje. Kishte mbërritur para pak ditësh nga burgu i tij, edhe ai i falur. Ata u përqaftuan të tre me aq dhimbje dhe aq pazgjidhshmërisht, sa në ato çaste nuk kishte forcë në botë që t'i ndante. Një krijesë e vetme njerëzore me tri koka, supe që shkundeshin nga ngashërimat. Kushedi sa kalimtarë të rastësishëm u ndalën dhe filluan të qanin nga ato skena prekëse.

Radha më erdhi mua. Para më doli një adoleshent i gjatë, i dobët, krejt i mekur. M'i kishte ngulur sytë i trembur. Nuk i besonte pamjes që kishte para. Ndonëse atë ditë, që pa gdhirë, ne gratë kishim lyer flokët dhe kishim bërë një tualet primitiv, me gjëra të sajua, unë nuk kisha mundur ta fshihja plakjen dhe drobitjen. Im nip priste që të më shihte ndryshe, si nëpër fotografi.

– *Nona, çfarë të kanë bërë? – belbëzoi. – Je mirë?*

E përqafova dhe e binda se gratë e moshës sime, kur e lënë veten pas dore, duken më të vjetra se ç'janë në të vërtetë. Por ai nuk iu dorëzua zhgënjimit. Më ngriti flokët mbi ballë, më përkëdheli në faqe dhe për habinë time tha me naivitet prej fëmije:

– *Nona, a e di që je më e bukur se mami?*

Atëherë unë qesha. Rrotull meje pandehën se isha kthyer e çmendur. Por unë qesha me gjithë shpirt. Qeshi edhe im shoq. Ndërsa ime bijë i hodhi krahun Antuanit

duke thënë:

– *Ke të drejtë djalë, ajo është më e bukur.*

Rrugën për në shtëpi e bëmë ngadalë. Më kishte marrë malli për çdo pëllëmbë të atij qyteti. Pa folur për vilën. Megjithëse hymë në katin nën dhe, mua m'u duk sikur shkelja në parajsë. Preka gjithçka me dorë, pastaj u ula dhe kërkova një kafe.

– Zot, më në fund na lër të jetojmë në paqe, – rënkova.

Por paqe, me sa dukej, nuk do të kishte më. E lexova në sytë e hequr dhe në vështrimin e turbullt të gjyshit të Antuanit vuajtjen e tij. Ishin si sy kali në muzg. Vuajtjen e dinte vetëm ai. Mua ma tregoi ndonjë muaj pas kthimit në shtëpi. Nuk deshi të më trishtonte. Deri sa një mbrëmje dolëm në breg të detit. Shkelëm mbi rërën e lagur dhe duke vështruar atë pafundësi uji të mbuluar nga errësira, ai tha me një zë që m'u duk sikur erdhi nga një humnerë:

– *Simonë, unë nuk do ta kapërcej më kurrë këtë det.*

– Çfarë është? – e pyeta.

– *Kancer në mushkëri. Ftohjet e vjetra që kam kaluar kur punoja në erë e në shi.*

– Ta thanë mjekët?

– *Po.*

Në ato çaste m'u duk vetja një dallëndyshe e mjerë, si ata shtegtarët që nisen mbi det drejt viseve të ngrohta. E vetme, edhe unë nuk do ta kapërcej dot, mendova. Ishim një çift i mjerë shtegtarësh. Im shoq do të binte rrugës, siç bien për të humbur përgjithmonë me dhjetëra zogj shtegtarë, të sëmure e të dobët, që nuk e përballojnë dot rrugën e gjatë. Pas tij do të lëshohesha edhe unë, e dëshpëruar, për t'i dhënë fund jetës mbi ndonjë kreshtë dallge.

Vegimi e ndjeu dhimbjen time dhe më hodhi krahun.



– Simonë, rruga vazhdon, – tha. – Më mirë të mos shohim nga deti. Drejtimi 'nuk është andej.

Jetuam edhe një vit e gjysmë bashkë. Erdhi një ditë dhe ai nuk dilte dot më. Nëpër spitale ishte mjerim. Çdo muaj unë fusja dorën në astarin e trashë të palltos së sime vjehrrë. Merrja nga një monedhë floriri dhe shkoja t'i lutesha një farmacisti të vjetër të më gjente qetësues për tim shoq. Nuk mund ta duroja dot kur rënkonte nga dhimbjet.

Një natë, ndërsa ai i lutej Zotit që ta merrte, më mbërtheu një dallgë naiviteti dhe i shkrova një letër të gjatë ministrit të Shëndetësisë. Iu luta që të na lejonin të dilnim jashtë shtetit bashkë me tim shoq, për t'u kuruar. Kuptohet me shpenzimet tona. Por përgjigjja që e thatë dhe e neveritshme: "Qytetarja Simonë, ne kemi spitalet tona moderne. Kërkesën tuaj e konsiderojmë një gabim të rëndë. Ju duhet të keni besim në mjeksinë tonë socialiste".

Ja, kështu. Dhe të mendosh që nëpër spitale gjeje vetëm aspirina, një kos të thartë dhe një supë që pak ndryshonte nga ajo e burgut. Pas asaj përgjigjeje shkova të merrja monedhën e radhës dhe e tmerruar numërova me gishta. Kishin mbetur edhe pesë. M'u kujtua amaneti i sime vjehrrë. Megjithatë, e mora njërën. Por im shoq më foli me një zë të akullt:

– *Simonë, lëre atë gjënë në vend. Kanë mbetur pesë të fundit.*

Amanetin e dinte edhe ai.

– Nuk e lë, – iu përgjigjja. – Do të shkoj të blej qetësues.

– *Të lutem! – këmbënguli ai. – Unë nuk do t'i fus më në trupin tim ata qetësues.*

Fillova të qaja me napolonin e florinjte shtrenguar në grusht.

– Po pse do të më duhen më ato monedha?

– *Kurrë nuk i dihet, Simonë.*

Atë ditë ai m'u lut ta çoja për herë të fundit në breg të detit. E ngritëm bashkë me Antuanin dhe e veshëm. Morëm një taksi dhe shkuam. Ai u pështet në një stol me pallton krahëve. Zoti im, ç'pamje morën sytë e tij kur ia ngulën vështrimin detit! Kurrë s'kam parë një shkëlqim dhe mall të atillë në sytë e një njeriu. Ata sy ishin të thellë e të pafund si vetë deti. Vështronin të fik-suar nga perëndimi, sikur nga çasti në çast do të ndodhte ndonjë mrekulli planetare. Pastaj, nuk mundi dot më. Qau. Pa rënkime, pa zë. Ishin fare pak lotë. Të fundit e jetës së tij.

– *Simonë, ti je e fortë, – më tha. – Ti do ta kalosh këtë det. Ki besim.*

Me t'u kthyer në shtëpi, ai ra në agoni. Ajo agoni zgjati tri netë të pafunda dhe katër ditë. Atëherë kur unë nuk e prisja ai u përmend befas. Ishte i kthjellët. Më kërkoi, pastaj më vështroi më një ëmbëlsi qiellore dhe bëri mundimin më heroik të jetës së tij për të më thënë:

– *Simonë, të kam dashur gjithmonë.*

Ajo ishte hera e fundit që i shqiptoi ato fjalë përrallore. Arriti të më buzëqeshte. Mbaroi me atë buzëqeshje të ngrirë në buzë. Zot, deri para se ta nxirrnim nga shtëpia nuk guxoja të mbyllja kapakun e arkivolit, sepse ai vazhdonte të më buzëqeshte. Deri sa një kushërirë e tij, një plakë e vjetër, e cila e kishte ndeshur shpesh vdekjen në rrugë, më pëshpëriti nga pas se ajo ishte një shenjë e mirë. Tim shoq e kishin thirrur engjëjt. E besova vërtet dhe e mbylla kapakun.

## XI

Të nesërmen u zgjova pa të dhe e kuptova se jeta vazhdonte. Pranë makinës qepëse qëndronte një stivë me rroba të prera që prisnin radhën për t'u qepur. Askush nuk kishte ardhur t'i tërhiqte mbrapsht, ndonëse u ishin vonuar. Duhej jetuar, vogëlushe. Rroga e sime bije nuk na dilte. Antuani rritej për ditë. Merrej me not, stërvitej në palestër. Mund të hante një dem të tërë brenda javës.

Vajza qeshi.

– E njoh mirë urinë e tij. Eta, më hahet, më thoshte nganjëherë në mes të mësimit. E shumta që mund t'i jepja ishte ndonjë copë byreku. Kishte raste që ai hidhej deri në shtëpi për të shuar urinë.

– Eh, kur rriten, djemtë hanë si krokodilë.

– Nona, të kujtohet kur gatove për herë të parë kërmij për mua? Antuani kishte bërë një javë luftë për të më bindur që t'i haja.

– Oh, vogëlushe, si s'më kujtohet! Ti kishte shumë frikë nga ato krijesa të pastra. Por, ama, kur i provove...

Ato qeshën më duart para gojës.

– Filluam të shkonim me Antuanin kodrave për të mbledhur kërmij, – vazhdoi vajza. – Ishte gallatë. Askush nuk e besonte që në të vërtetë kishim shkuar për kërmij. Një ditë, në një ferrë të vogël, pashë dy kërmij që... hëm... të çiftuar. Në fillim unë budallaqja nuk u kthjellova. Thirra Antuanin. Po këta të dy, pse janë

ngatërruar kështu, e pyeta. Ai ia plasi gazit. Çfarë po bëjnë, vazhdova të pyesja unë. Atëherë ai deshi të më tregonte se mes njerëzve dhe kërmijve nuk kishte ndonjë ndryshim pale se çfarë kur ishte fjala për dashurinë, por vendi rrotull ishte lagur nga vesa dhe ndërroi mendje.

– I latë ata të lumturit të mbaronin?

– Po, po.

Ato filluan përsëri të qeshnin.

– Oh, Zoti im, ç'natë e magjishme! – psherëtiu gruaja.

– Ku paskan qenë tërë këto histori! Po shiko, nga lindja sikur po zbardh.

– Ashtu duket. Por... të lutem, vazhdo! Ka ende natë. Dhe Antuani po fle.

– Mirë, po vazhdoj. Kur unë dola nga burgu, rreth e rrotull kishte marrë fund gjithçka. Epoka e radhave kishte arritur periudhën e lavdisë së saj. Njerëzit vërsuleshin drejt dyqaneve pas mesnate, me të hyrë dita e re, nganjëherë edhe para mesnate. Racionet sa vinin e zvogëloheshin. Oh, vogëlushe, ti i di shumë mirë këto. Ti dhe Antuani i përkisni brezit të racioneve dhe radhave.

Më qesharakja ishte se te ai gjoja komunizëm nuk besonin më as ata që e drejtonin. Thjesht prisnin ndarjen e re politike që do të bënin të mëdhenjtë e botës. Ndërkohë komunistët e thjeshtë idealistë, të hutuar, vazhdonin t'i mbanin ende sytë nga portretet e Marksit dhe Leninit. Ende besonin se mund të dilej nga ajo katrahurë dhe se gjendja do të përmirësohej. Një nga ata ishte yt atë. Një tjetër ishte Orest, shoku im i vjetër i grupit komunist të qytetit. Pak muaj pas daljes nga burgu ai më erdhi për vizitë në shtëpi. Na befaso i ajo vizitë.

Orest i kërkoi leje të hynte. Im shoq iu përgjigj se miku nuk kërkon leje. Atëherë ai bëri para me një

pamje të mallëngjyer. Dora ku mbante një kaush me fruta i dridhej. Vështronte banesën tonë gjysmë të nëndheshme dhe i mbahej fryma. Kishte rënë nga shëndeti. Vitet e fundit të punës e kishin qarkulluar në bazë, sekretar partie në një fermë të madhe bujqësore, pastaj kishte dalë në pension dhe merrej me punë partie aty në lagje.

– *Simonë, më vjen mirë që u ktheve shëndoshë, – më tha. – Qofshin telashet e fundit këto! Ja, të kam sjellë ca fruta.*

Më shkoi goja lëng. Në atë stinë, ishte fillim maji, fruta mund të shikoje vetëm nëpër tablotë skematike me natyra të qeta që shumëkush i mbante nëpër kuzhina, pikturuar nga duar amatore.

– Je shpenzuar shumë, shoku Orest, – i thashë.

– *Është racioni që na japin si familje dëshmori. Ti e di. Im vëlla u vra në luftë.*

– Sigurisht që e di. Ende e mbaj mend fytyrën e tij. Dinte vetëm të qeshte.

Oresti u mallëngjye edhe më shumë.

– *Simonë, është hera e fundit që marr fruta, – shtoi papritur dhe zëri e tradhtoi.*

Unë dhe im shoq ngrimë.

– Pse duhet të jetë e fundit? – e pyeta.

Por ai nuk u përgjigj. Vetëm më vështronte me një zhgënjim të thellë, aq të thellë sa nuk do t'i mjaftonte një abis oqeani për ta krahasuar. I bëra një kafe. E piu atë, pastaj më falënderoi disa herë radhazi. Kur u ngrit, m'u lut ta shoqëroja

– *Simonë, këta që na drejtojnë nuk janë komunistë, – tha. – Edhe ata që na drejtuan në luftë nuk ishin komunistë. Këtë vend nuk e kanë drejtuar kurrë komunistët e vërtetë. Por, ç'flas edhe unë budallai! Ti i ke kuptuar shumë më*

*parë se unë këto gjëra.*

– Është e vërtetë, shumë më parë, – ia ktheva.

Ai ngriti sytë dhe më vështroi.

– *Simonë, ishim të rinj. Shumë të rinj. Ata na përdorën. Ajo luftë nuk ia vlejti. Edhe jeta e tim vëllai shkoi kot.*

Kurrë në jetën time nuk kam burrë më të dëshpëruar se ai. M'u duk se po shkonte t'ia hiqte vetes. Pas pak ditësh e arrestuan. E dënuan me tetë vjet burg, për politikë. Pikërisht atë! Më idealistin, më të pastrin, më të singertin, që e vinte partinë mbi familjen e tij.

Kur kjo anije u nis dhe ti më tregoje për tët atë, më kujtohej pikërisht Oresti. Ndaj të thashë se i njoh shumë mirë njerëz si babai yt. Ata janë njerëzit më të mirë, vogëlushe. I përkasin fesë së Jezu Krishtit pa e ditur as vetë. Gjithmonë kanë ëndërruar dhe kanë dashur më të mirën për të tjerët. Kurse vetë...

– Ç'faj bëri shoku yt i vjetër që meritoi tetë vjet burg?

– Oh, bëri gjënë më të pafajshme në botë. Atë që ka të drejtë ta bëjë çdo komunist. I shkroi një letër komitetit qendror, me anën e së cilës kërkonte ndryshime për të dalë nga gjendja e mjeruar ku ishte katandisur vendi.

– Domethënë... edhe babi im mund ta kishte pësuar ashtu po sikur...?

– Idealistët gjithmonë e pësojnë, vogëlushe. Ata filluan ta pësonin që në luftë. Jam e bindur se edhe yt atë ka menduar me naivitet se udhëheqja atje lart nuk i dinte hallet e popullit, nuk e njihte gjendjen poshtë në bazë, sepse e gënjenin burokratët, e dokrra të tilla. Edhe ai ka dashur të flasë, të shkruajë, por me siguri nuk e ka lejuar jot ëmë.

– Ka shumë të ngjarë. Ka qenë një periudhë kur ata vetëm bënin sherre për punë politike.

– Me të sajën, ajo e ka shpëtuar. Dhe mirë ka bërë.

Ishte me këmbë në tokë. Sepse nuk besonte në dokrrat e librave me kapakë të kuq.

– E kam dëgjuar një ditë t’i thoshte babit: “I gjori ti! Ata nuk duan mend nga ty, por bindje. Po nuk u binde, dije se do të më lësh vajzat rrugëve”.

– I ka thënë një të vërtetë. Ajo e kishte kuptuar se udhëheqja atje lart po tallej me popullin duke propaganduar një ideologji boshe. Nuk ishte e vështirë ta kuptoje. Mjaftonte pjata e zbrazur dhe racionet. Megjithatë, babai yt ishte njeri i mirë. Ai do të mbetet gjithmonë i tillë. Mos dysho për këtë! Të qenit i mirë apo i keq, nuk ka të bëjë me ideologjitë. Kurrë nuk ka pasur të bëjë.

Vajza ngriti kokën lart. Kishte filluar të binte një shi i imët. Ajo ndjeu piklat e tij në fytyrë. Ishte e vetmja mënyrë për të larguar disi lodhjen dhe përgjumjen.

– Po me ato të dyja që të dolën dëshmitare në gjyq, u takove?– pyeti pastaj.

Tjetra vështroi ca piklat e shiut tek shndrisnin si xixëllonja në fluturim, kur kalonin para njërit prej farëve të anijes, pastaj humbnin rishtazi në errësi.

– Ajo kolegja e Shkollës së Muzikës nuk u bë e gjallë, – foli me një ton të zymtë. – Rrugës shtrej sikur nuk më njihte. Nuk ishte prekur fare nga burgimi im i gjatë. Ishte e bindur se nuk kishte kryer asnjë krim. Ajo e dinte se gjërat funksionin sipas parimit: fatkeqësia jote, lumturia ime. Por pavarësisht nga sjellja, unë e kam falur. Kam kohë që e kam falur. Edhe ajo ishte viktimë. E urdhëruan dhe pikë.

– Je e sigurt që e urdhëruan?

– Duhet të ketë qenë kështu.

– Nona, pati edhe të tjerë që i urdhëruan të bënin dëshmi e denoncime, por ata nuk pranuan. Zgjedhën

- më mirë të vuanin vetë se sa t'i bënin keq dikujt tjetër.
- E po, njerëzit nuk janë njëlloj. Ka edhe njerëz të dobët.
  - Po ata që shkatërruan të tjerët për të bërë karrierë dhe për të zënë poste?
  - Ata futen te kategoria e bajgave. Bajgat mund të bëjnë keq në çdo kohë dhe regjim politik. Ashtu janë gatuar. Por një ditë ata do t'i zërë mallkimi i viktimave. Mos ata, pasardhësit e tyre. Nuk ka gjë më të rëndë se sa mallkimi i viktimave, vogëlushe. Atë e ka dëgjuar Zoti. Dhe Zoti di si të vendosë drejtësi.
  - Mbase. Dyshoj për këtë.
  - Të kuptoj. Nuk është e lehtë të bësosh te Zoti.
  - Vajza heshti një copë herë.
  - Po me Sadeten, ç'u bë? - pyeti pastaj.
  - Sadeten e mjerë e takova një ditë në rrugë. Më saktë, ajo kishte dalë të më priste. Mezi e njoha. Ishte plakur tmerrësisht. Kishte një dridhje ritmike koke.
  - *Zonja Simonë, në emër të Zotit, më fal! - tha. - Unë nuk doja, por...*
  - E përqafova.
  - Asnjëherë nuk të kam quajtur fajtores, - i thashë.
  - Ajo nuk e priste atë lloj sjelljeje. Filloi të qante.
  - *Zonja Simonë, dua të të tregoj diçka që nuk e di askush, - vazhdoi. - Unë... ka vite e vite që nuk fle.*
  - Si nuk fle?!
  - *E shumta mund të fle dy orë në natë. Pastaj zgjohem e pataksur.*
  - E pse?
  - *Dikur, në luftë, kam vrarë një njeri. Më urdhëruan.*
  - E ç'ishte ky njeri?
  - *Një komisar. Sapo kishte shkelur në moshën e burrërisë. Por ata, të mëdhenjtë, nuk e donin. Më ngarkuan ta*



shoqëroja nëpër një pyll. Rrugës do ta vrisja dhe pastaj do të përhapej lajmi se ai ishte vvarë në një pritë nga një çetë ballistësh. Nuk doja ta bëja atë vrasje. Vrapova të gjeja të fejuarin tim dhe i tregova për urdhërin. "Do ta bësh, – ma preu ai, – ose nesër je ti ajo që nuk do ta shohë më diellin kur të lindë. Sadete, mos guxo kurrë të kundërshtosh një urdhër, ndryshe je e humbur. Nuk ka kthim prapa, as për ty e as për mua".

Pas atyre fjalëve unë e vështrova e veñitur. Ishte ai që kishte kërkuar të ma ngarkonin mua atë detyrë. U nisa bashkë me komisarin nëpër pyll. Ai nuk dyshoi. Unë isha vetëm 16 vjeçe. Në një shteg të ngushtë, vështrova shpinën e tij, u ndala dhe ngrita armën. Ai i ndjeu lëvizjet e mia dhe u kthye. Më pa me ca sy të pafajshëm e të trembur sa duart m'u drodhën. Shoqe, mos e bëj, m'u lut. Por unë shtiva. Kur vdiq, guxova t'i afrohesha dhe i mbylla sytë. Por ata sy filluan të më torturonin shumë shpejt. Pak kohë pas mbarimit të luftës fillova të shikoja të njëjtën ëndërr: skenën e vrasjes së tij. Komisari më vështronte dhe më fliste: shoqe, mos e bëj. Edhe dje e pashë. Më tha të njëjtat fjalë.

Isha fëmijë, zonja Simonë. Vetëm 16 vjeçe.

Ajo qau me dënësë, por lehtësimi që i përkohshëm.

– Zonja Simonë, ata na bënë vrasës, – rënkoi.

– Jo të gjithëve, – i thashë. – Disave u pëlqeu të bëheshin vrasës.

Ajo më vështroi e mekur.

– E ke fjalën për tim shoq? – pyeti. – Mbase ke të drejtë.

Ai mendoi se mund të shkonte përpara duke kryer vrasje. Dikur, para se të fillonte lufta, kishte provuar të vriste një njeri, bakallin e lagjes.

– Po pse?

– Sepse... i përdorte të ëmën. Im shoq ishte rritur jetim. Nëna e tij duhej të ushqente fëmijët dhe... Im shoq më ka

*treguar disa herë gjatë luftës se e kishte parë bakallin mbi të ëmën. Ndoshta edhe më keq se kaq. Ato skena i ishin kthyer në makth. Më betohej se do ta vriste sapo të kthehej në qytet.*

– Po herën e parë, nuk e vrau dot?

– *Jo, vetëm e plagosi. E burgosën. Por kur filluan trazirat e luftës, ia doli të arratisesh. Jetonte i fshehur, ku të mundte. Pastaj u bë komunist.*

– E vrau bakallin më në fund?

– *Po. U deh atë natë. Kishte filluar punë në seksionin e Sigurimit të Popullit. Ai qeni vdiq me m... e vet në gojë, më tha. Por tashmë nuk i bënte më përshtypje një vrasje. Andej nga viti 1945, kur luftonim malësive të Veriut, e kam parë atë me sytë e mi duke vrarë malësorë të pafajshëm vetëm e vetëm se nuk pranonin të dorëzonin armët. Njërin prej tyre e vrau nga fare afër. Gjaku i të vrrarit i spërkati fytyrën. E mora mënjane ta pastroja dhe iu luta të ktheheshim në qytet. Ai më vështroi i trembur. Sadete, ka mbaruar gjithçka, më tha. Nuk ka kthim prapa.*

*Mbase ke të drejtë, zonja Simonë. Ata e zgjodhën dhe atij i pëlqeu ajo rrugë.*

– Të ka kërkuar më të bashkoheni? – e pyeta.

– *Po, – m'u përgjigj ajo. – Por imë atë nuk më lejoi. "Rrit fëmijët me nder, – më tha, – që të lash edhe gjynahet e tët shoqi". Kam vuajtur shumë, zonja Simonë. A thua Zoti do të më ndëshkojë te fëmijët e mi?*

– Jo, – iu përgjigja. – Nëse i lutesh me gjithë zemër.

*Ajo u largua e kërrusur. Që nga ajo ditë nuk e takova më.*

– Jeton ende?

– *Jo. Vdiq nga një hemoragji cerebrale në vitin 1988. I shkova në varrim. Qava mbi arkivolin e saj, ndërsa njerëzit rreth e rrotull më vështronin të shushatur.*

Askush nuk më kuptonte dot.

– Po ai, i shoqi, ishte atje?

– Ishte. E ndesha vështrimin e tij për ca çaste. Kishte mbetur po ajo fytyrë e ligë dhe e neveritshme.

– Po ai, si reagoi?

– Më vështroi me urrejtje. Hajde dhe gjeje pse! Jam e bindur se po të kthehej edhe një herë viti 1944, ai do të bënte po të njëjtat fëlliqësira. Mos më zi. Mbaje mend vogëlushe: në këtë botë njerëzit nuk bëhen të këqinj apo të mirë gjatë rrugës. Ata lindin të tillë. Lënë gjatë rrugës ligësinë dhe mirësinë e tyre, pastaj largohen nga kjo jetë. Dhe prapa mbesin vetëm kujtimet dhe gjykimi i Zotit.

## XII

Ndërkohë, rrotull kishte zbardhur. Qielli dhe deti kishin marrë një ngjyrë gri. U dëgjuan këlthitje pulëbardhash. Njëra prej tyre kaloi mbi anije. Bregu nuk duhej të ishte larg.

– Nona, ti e ndjeve në ato vite se po i vinte radha këtij bregu? – pyeti vajza.

Gruaja e moshuar i buzëqeshi mëngjesit.

– Kuptohet që po. Instiktivisht. Ishte si ajo nuhatja e bishës që del nga dimri i gjatë dhe ndjen afrimin e pranverës. Gjërat u përmbysën shumë më shpejt nga ç'pritej. Ose më saktë, i përmbysën ata që i kishin nën kontroll. Si dhe pse, duhet pritur e duhet parë. Të flakësh brenda nate si paçavure një ideologji që kishte shkaktuar me mijëra viktima, nuk është lojë e lehtë. Vogëlushe, unë nuk do të besoj asgjë nga këto që ndodhën. Kurrë. Kam frikë se është një teatër gjigant.

Por shumëkush nuk e vrau dhe nuk e vret mendjen për këto. Mendonin dhe mendojnë vetëm për ikjen. Një pasaportë, një vizë dhe... nga sytë këmbët. Gratë e huaja ikën të parat. Me gjithë familje. Hebrejet, italianet, ruset, lindoret e tjera. Shumë nga to i ndihmuan shtetet e tyre. Pati edhe që mbetën. Nuk kishin ku shkonin.

Erdhi koha të ndahesha me Sarën. Po ikte i gjithë barku i saj, kur i thonë fjalës. Me djem, vajza, nipër e mbesa. I shoqërova deri në port. I shoqi i Sarës mbante shtrënguar fort nën krahun e djathtë një violinë të vjetër,

njëlloj si gjysmë shekulli më parë, kur ishte kthyer në atdhe nga studimet. Ishte e njëjta violinë. E njoha nga kutia. Dorën e majtë e kishte të zënë me një çantë të madhe lëkure. E kuptova që ajo çantë duhej të ishte mbushur me partiturat e kompozimeve të tij të paluajtura kurrë nëpër skena.

Kurse Sara m'u duk më e bukur se kurrë. Era i tundte ca krela të imta rebele që ishin shkëputur nga flokët e mbledhura topuz. Herë pas here vështronte në mënyrë të pakontrolluar nga deti. Sikur nuk i besohej që po ikte. Kohë më vonë më tregoi se i dukej sikur do ta kthenin në çastet e fundit.

– *Simonë, mbijetuam, – më tha duke më përqafuar.*

– Jo të gjithë, – iu përgjigja.

Pas atyre fjalëve ajo filloi të qante.

– *Më vjen keq, – mëmëriti. – E di shumë mirë çfarë ndien në këto çaste.*

Iu luta të shkonte. Prita deri sa ajo u ngjit në traget, madje deri sa ajo anije e stërmadhe u nis. Sara kishte dalë lart në kuvertë. Më bëri shenjë që të largohesha. Por unë qëndrova në kalatë me dorën ngritur deri sa ajo më humbi nga sytë.

– *Mama, po ti ç'po pret? – më pyeti ime bijë sapo mbërrita në shtëpi.*

– Mos u ngut, do të ikim, – iu përgjigja.

Ndërkohë po prisja që të mbërrinte ndonjë letër nga njerëzit e mi. U kisha shkruar katër herë radhazi. Por nuk mora përgjigje. Dyshova se ime motër nuk jetonte më. Dija se ajo kishte një djalë dhe një vajzë dhe kaq. Atëherë, u detyrova t'i shkruaja Lysienit. Adresa e shtëpisë së tij kishte mbetur e ngulitur në kujtesën time prej dekadash. Përgjigjia mbërriti shumë më shpejt nga ç'e prisja. Lysieni mbahej mirë. Jetonte edhe e shoqja,

Lizeta. Më shkruanin një letër aq të ngrohtë, sa, pas leximit të saj, isha gati të nisesha drejt shtëpisë së tyre në këmbë.

Pas pak ditësh shkova në ambasadën franceze. Mezi munda t'i afrohesha asaj. Ngado kishte policë. U detyrova të ndalja në rrugë një djalë të ri që kryente detyrën e konsullit. Frëngjishtja ime e shtangu atë. Më vështroi sikur të kishte para ndonjë kufomë lëvizëse.

– *Zonjë, si mund t'ju ndihmoj? – më pyeti.*

Nënqesha.

– Atëherë, kur ne kishim nevojë për ndihmë, ju nuk u bëtë të gjallë, – ia ktheva. – Tani është vonë, tepër vonë. Një vizë nuk mund të quhet ndihmë.

Ai më ftoi brenda i hutuar.

– *Zonjë, kush jeni? – pyeti.*

Ia tregova.

– *Keni qenë në ndonjë gulag? – vazhdoi ai.*

– Ky vend ishte i tëri gulag, – i thashë. – Ju e dinit shumë mirë këtë. Por rritit dhe e vështronit nga larg.

– *Zonjë, ju lutem, unë jam vetëm një konsull i thjeshtë, – u shfajësua djali duke u skuqur.*

E ndjeva se nuk ia vlente të harxhoja frymë me të. Nuk do të të kuptojnë dot kurrë, Simonë, mendova. Merr vizën dhe ik. Për ta ti je vetëm një viktimë. Viktimë e zgjedhjes që bëre vetë.

Ndërsa po kthehesha në shtëpi, pashë nga dritarja e trenit një avion që u ngrit në qiell. Në sirtarin e bufesë kisha lënë të holla sa për të shtyrë edhe një javë. Atëherë m'u kujtua amaneti i sime vjehre dhe palltoja e saj e vjetër. Pesë monedhat e fundit të floririt ishin ende atje. Kishin gati gjysmë shekulli nën astar. Me to mund të blija një biletë avioni vajtje-ardhje dhe mund të tepëronte ndonjë pare xhepi.

Ato ditë u largua nga qyteti ynë edhe një grua tjetër e huaj, një austriake e martuar me një dentist që në kohën e lulëzimit të mbretërisë së Zogut, tashmë e ve. Iu lut njerëzve të familjes ta linin për më vonë. Por askush nuk kishte besim te e nesërmja. Familjarët e saj nuk pranuan ta linin pas. Të gjithë trembeshin se komunizmi do të kthehej përsëri. Nuk ju dilnin paratë për bileta avioni dhe u detyruan të shisnin shtëpinë. Një vilë me dy kate, rrethuar me kopsht, për një biletë avioni! Do të vijë një ditë dhe s' do ta besojë kush këtë çmenduri, por ja që ndodhi. Vetëm e vetëm që ata të iknin të gjithë.

Po unë, ç' të shisja? Fillova të bëja gati valixhen time të mjerë, për t' u kthyer në atdhe. Të njëjtën valixhe me të cilën kisha ardhur.

– Më kujtohen mirë ato ditë, – tha vajza. – Antuani më fliste veç për ty. Të kujtohet kur u nise? Unë dola te stacioni i trenit të të takoja. Kisha me vete çantën e shkollës.

– Më kujtohet shumë mirë, zemër.

– Ti na vështrove duke buzëqeshur, Antuanin dhe mua. Pastaj na the tepër e bindur: vogëlushë, filloni behuni gati dalngadalë. Së shpejti do t'ju vijë radha.

– Por ju kishit filluar të bëheshit gati që para se t'ju thosha unë!

– Në të vërtetë, po. Mësonim frëngjisht si të tërbuar. Librave të tjerë vetëm sa u hidhnim një sy. E mësuam hartën e Belgjikës përmendësh. Shikonim ëndrra edhe në orën 12 të ditës, kur dielli të binte në majë të kokës.

Gruaja e moshuar zgjati buzët dhe e puthi vajzën në flokë.

– Zemër, më vjen keq që këtë natë nuk të lashë të shikoje ndonjë ëndërr.

– Oh, nona, kjo natë që e gjitha një ëndërr. Unë ende

nuk e besoj që atje përballë po duken brigjet e Italisë.

Gruaja psherëtiu.

– Edhe unë nuk e besova kur shkela për herë të parë në qytetin tim të lindjes. Të tjerëve u ngjaja si fantazmë. Nuk më njihnin. Nuk i njihja. Edhe qyteti kishte ndryshuar. Unë nuk i përkisja më. Isha e huaj, e largët. Le të jetë një ëndërr, mendova. Nga stacioni i trenit u mundova të shkoja drejt shtëpisë. Por nuk e gjeta dot. Ishte shembur. Kishin mbetur rrotull vendit të saj të dikurshëm vetëm disa rrepe të vjetër. Më tutje qe ngritur një park i vogël. Duke u orientuar me anë të pemëve, m'u duk se e gjeta truallin ku dikur kishin qenë themelet e shtëpisë. Lashë valixhen mënjanë, rashë në gjunjë dhe e putha. Qava. M'u kujtua ikja e llahtaritur e asaj natës së Gestapos, në fije të fustanit.

Rruga e vjetër që të çonte te Vila e Blireve ishte ende. I kishin shtuar vetëm këmbësore të reja dhe një ndarje për biçikleta. E përshkova ngadalë, duke u munduar të kujtoja çdo pëllëmbë të saj, vendet ku isha rrëzuar dikur me biçikletë, një shesh të vogël ku më ngacmonin dy vëllezër binjakë, një kryqëzim ku rastiste të takohesha me një shoqe shkolle. Disa kalimtarë u ndalën për të më ofruar ndihmë, por unë iu përgjigja njëlloj: falemnderit, jam në drejtimin e duhur. Nuk kam dyshim se ata më kanë pandehur o të lajthitur, o të dehur. Këto pandehma i ndihmonte valixhja ime e vjetër prej lëkure bualli, një model i rrallë i viteve '40, që, çuditërisht, kishte arritur të mbijetonte dhe kishte ende një farë pamjeje.

Dhe ja, më në fund, dola te Bliret. Në ato anë nuk kishin lejuar ndërtime të reja. Para më doli vila e zonjës Klodetë. M'u duk më e madhe. Gjatë rikonstruksionit, të kryer ndoshta para tridhjetë vjetësh, i kishin shtuar një kat. Por modelin e kishin ruajtur. Gardhi dhe oborri



ishin pothuaj si dikur. Kurorat e dy blireve anash ndërtesës ishin zgjeruar edhe më.

Ula valixhen dhe u pështeta te gardhi. Lysieni dhe e shoqja ishin ulur në verandë. Lexonin. Papritur vura re se Lizeta qëndronte në një karrocë invalidësh. Ajo që dikur kalëronte dhe në garat me biçikleta në pyll ishte më e krisura. Jeta ruan për të gjithë nga një goditje, mendova.

U detyrova të kollitesha që ata të ngrinin kokat. Kuptohet, nuk më njohën.

– *Zonjë mund t'ju ndihmojmë? – pyeti Lizeta.*

– Nëse e keni ende pianon, mund të luaj diçka për ju, – ia ktheva.

Atëherë Lysieni u ngrit. Simonë, thirri dhe nxitoi drejt portës. Filluam të qanim të tre. Nuk flisnim. Vetëm qanim dhe vështroheshim. Ata më hapën vend në verandë. Lysieni solli edhe një karrike të katërt dhe vuri mbi të një kapelë të vjetër stofi.

– *Është e Vegimit, – tha. – E harroi atëherë. Mendoni sikur jemi të katërt. Eh, sa do të doja që ai të ishte këtu!*

E shoqja iu lut që të mos më lëndonte me kujtime.

– *Simonë, e dimë, je e lodhur nga jeta, – m'u drejtua. – Kur lexuam ato që na shkruaje, na u duk vetja xhuxhë egoistë. Kurse ti... Do të doja të kisha pasur fatin tënd veç të mos kisha përfunduar në këtë karrocë të mallkuar.*

– *Zemër, secili fatin e tij, – iu drejtua i shoqi. – Nuk e ndryshojmë dot.*

Ata jetonin vetëm te Bliret që pas vdekjes së zonjës Klodetë dhe largimit të dy fëmijëve. Djalin e kishin në Bruksel, ndërsa vajzën në Kanada. Lysienit i kishte ndritur karriera. Një periudhë kohe ishte marrë me politikë. Kishte qenë edhe kryetar bashkie i qytetit në vitet '70. Ndërsa e shoqja kishte arritur deri në drejto-

reshë shkollë.

Kur unë u shlodha disi, piva një kafe dhe lotët m'u shterën, e ulëm karrocën e Lizetës tëposhtë shkallëve dhe filluam të shëtisnim rrotull vilës. Pastaj dolëm jashtë dhe shkuam deri afër pyllit. Zot, andej gjithçka ishte siç e kisha lënë! Ëndrra vazhdonte. Herë pas here flisja me tim shoq. Më dukej sikur ishim katër.

Ndërsa po darkonim në dhomën e madhe të ndenjies, unë i ngrija herë pas here sytë nga shkallët e drunjtja që të ngjishnin në dhomat e katit të dytë.

– *Simonë, do të të çoj atje, – më tha Lysieni duke buzëqeshur me dhimbje. – Mos doje më parë të shmalleshe me pianon?*

– E keni ende?! – gati klitha.

– *Sigurisht. Vetëm nuk të siguroj dot për gjendjen e saj.*

U ngrita. Kërkova rrotull me sy dhe e pashë në fund të dhomës, të mbuluar me një rrobë të gjerë.

– *Nuk e ka prekur kush prej vitesh, – foli Lysieni.*

Iu afrova, i hoqa mbulesën, hapa kapakun e tastierës dhe ndërkohë duart e mia m'u dukën të vogla, të ndrojtura, të bardha, me damarë të hollë blu, me mollëzat e gishtave të kafshuara me dhëmbë nga nervozizmi. Më dridheshin. Arrita të luaja me shumë mundim pjesën që zonja Klodetë më kishte mësuar për herë të parë. Isha një fëmijë e lumtur në ato çaste. Papritur ndjeva një dëshirë të egër që gjithçka të kthehej pas, shumë vite pas, atje ku ishte ndërprerë fëmijëria ime.

Ata të dy më shikonin të mekur. U urova natën e mirë dhe u ngjita lart. Më kishin përgatitur dhomën ku natën fatale të Gestapos kisha fjetur me gjyshin e Antuanit dhe kisha bërë dashuritë më të çmendura të jetës sime. Ishte ende edhe krevati i vjetër me balle hekuri, edhe mobiljet. Nga dritarja dallohej e njëjta

pamje e livadheve dhe tutje pylli që nxinte.

U ula mbi krevat me kapelën e tim shoqi në duar. Nuk munda të fle dot atë natë. Në të vërtetë nuk desha të fle. Ashtu si dikur, gjumi më zuri vetëm afër mëngjesit. Kur u zgjova, ishte pasdite. Lysieni dhe Lizeta po lexonin në verandë. Ajo më buzëqeshi e mrekulluar.

– *Simonë je ndryshe, – tha. – Je krejt ndryshe.*

Por unë vazhdoja ëndrrën time. Vetëm pas disa ditësh u kujtova për kohën reale ku po jetoja. Shkova në varreza. Gjeta varrin e nënës. Nga një punëtor i varrezës mësova se kishte vdekur edhe ime motër. Çova lule edhe në varrin e saj. Kur u ktheva në shtëpi, i kërkova Lysienit të bisedonim. I thashë se ndoshta andej rrotull duhej të ndodheshin njerëz të racës sime. Ai pohoi në heshtje, pa asnjë grimë gjallërie. Kishte folur me tim nip dhe time mbesë dhe u kishte kërkuar të vinin.

– *Kam frikë se do të kesh probleme me ta, – më tha. – Simonë, në emrin tënd nuk figuron asnjë lloj trashëgimie.*

Vetëm nënqesha. Prita. Pas atyre që kisha kaluar në jetë, një zhgënjim i atillë ishte një kafshim limoni. Në të vërtetë nuk prisja ndonjë trashëgimi pa le çfarë. Historia e babait ishte e mbyllur. Ai kishte qenë bir i një minatori të këputur. Ndërsa nga nëna, diku pranë një mulliri të vjetër, i cili qe ruajtur ende si një relike, kishim një fermë të vockël. Kuptohet, gjithçka ishte shitur. Pranë mullirit qe ndërtuar një lokal, i cili gjatë verës tërhiqte plot njerëz.

Fëmijët e sime motre të paktën erdhën të më takonin. Nuk kisha asnjë lloj ideje për ta, përveç një fotografie të viteve të fëmijërisë që ma kishte dërguar nëna. Por mes tyre dhe fotografisë ngjashmëria ishte zero. Mbesa ishte një grua në moshë, më kujtonte ca time motër. Më takuan sikur të ishte fjala për një njohje të rastit, të

ndodhur në tren apo në plazh, ku të dyja palët marrin vesh papritur se janë nga i njëjti qytet.

– *Teze Simonë, jemi të habitur nga vizita jote, – tha im nip. – Ne të dinim...*

– Të vdekur?

– *Jo. Të zhdukur në gulag.*

– Ah, e ditkeni fjalën gulag! Sa mirë!

– *Kështu është shkruar edhe nëpër dokumente: “E zhdukur në një gulag në Shqipërinë komuniste”.*

– Ç’ dokumente?

– *Ato të familjes. Të pronësisë.*

– E kush i ka shkruar këto fjalë?

– *Avokati. Besoj se ti ke ardhur të kërkosh pjesën tënde nga gjyshja. Kështu?*

Vogëlushe, duhet të dish se, nganjëherë, njerëzit e racës tënde janë më të neveritshëm e më të këqinj se ata që të kanë prindjekur e të kanë bërë të vuash.

– Unë erdha në shtëpinë time, – iu përgjigja tërë mllef. – Ju e dinit shumë mirë se një ditë do të kthehesha.

– *Ne dërgonim letra, por nuk merrnim përgjigje, – tha ime mbesë. – Shtëpia nuk është më.*

– E mora vesh. Po toka te mulliri i vjetër?

– *Është shitur. Vite më parë. Nëse ti... kuptohet... ke të drejtë të hapësh sërish gjyq. Por neve na kishin thënë se je komuniste dhe se komunistët e urrejnë pronën private.*

Pas atyre fjalëve nervat m’u ngatërruan si një shkurre e tharë në diell.

– Pa shiko! Pra, të gjithë komunistët këtu hoqën dorë nga pronat dhe shtëpitë? – thirra.

– *Komunistët tanë nuk ishin stalinistë! – filozofoi im nip.*

– Kurse unë isha?

– *Ne kështu kishim dëgjuar, që Shqipëria është një çerdhe stalinistësh.*

– Domethënë, gjyshja juaj nuk ju kishte treguar çfarë kisha hequr unë?

Ata nuk më vështronin.

– *Jo, – u përgjigj ime mbesë. – Ajo vetëm qante kur fliste për ty.*

– Pra, zoti nip dhe zonja mbesë, unë duhet të përfundoj në ndonjë azil pleqsh?

– *Për ju që ktheheni nga Lindja komuniste duhet të mëndojë shteti!*

Ky ishte përfundimi i tyre. As ai dhe as ajo nuk më ftuan në shtëpitë e tyre. I dëbova nga tryeza ku ishim ulur.

– Largohuni, ju vemje! – u thirra. – Nuk dua të më dilni më para. Nuk dua që ime bijë dhe im nip t’ju njohin. Do të vijë dita që Antuani im të bëhet një avokat me emër dhe atëherë do t’ju shkatërrojë të dyve. Do t’jua marrë paratë e vjedhura. Të jeni të bindur për këtë! Do t’jua marrë deri në qindarkën e fundit. Unë isha vërtet në gulag, por dijeni se kisha lënë Zotin të shikonte se çfarë bënit ju. Ai është dëshmitar. Dhe ju nuk do t’i shpëtoni dot ndëshkimit të tij!

Ata u larguan të trembur. Me siguri menduan se isha një e çmendur, e arratisur nga gulagu dhe e ardhur deri aty rrugë e pa rrugë, duke kapërcyer male e lumenj. Nuk i pashë më. Nuk ma ndjeu t’i takoja më. Antuani le ta fillojë gjithçka nga fillimi. Njëllor si stërgjyshi i tij, që u fut në minierë në moshën 14 vjeç. Një ditë, kur ai të ketë studion e vet ligjore, do ta presin beteja të mëdha. Ai e di mirë se nipi i kujt është dhe ç’prona ka lënë pas. Ato prona kanë në themel eshtrat e disa njerëzve fisnikë. Do të kthehen te trashëgimtarët e tyre sikur qielli me tokën të puqet.

## XIII

Kështu, vogëlushe, kështu. Të gjorin njeri e presin deri ditën e varrit befasia nga më të çuditshmet. Ai vjen në këtë botë me një mijë pyetje në kokë dhe largohet me një milion. U ktheva te Bliret e qetë. Raca njerëzore kishte kohë që nuk më habiste më. Dhe ajo është kudo njëlloj. Mos dysho për këtë. Në një rrugë ecin të gjithë, edhe të mirët edhe të këqinjët.

– Po nga shokët e vjetër të grupit komunist, munde të takosh njeri? – pyeti vajza.

– Eh, kjo është një histori më vete. Nga grupi ynë jetonin ende në qytet vetëm dy njerëz, Ivi dhe Klara. Lysieni më dha adresat e tyre.

– Ivi që ai shoku që erdhi natën e Gestapos të të njoftonte që të largoheshe nga shtëpia?

– Ai. Eh, i detyrohem jetën atij djali. Nga letrat e nënës dija që pjesa më e madhe e grupit nuk ishte kthyer më nga kampet e përqëndrimit. Kishte mbijetuar vetëm Klara. Hektorin, njërin nga shokët, e kishte vrarë gjatë torturave një oficer i Gestapos, i mbërthyer nga një shkrim i befasishëm nervozizmi. E kishte qëlluar me plumb në zverk dhe kishte dalë nga qelia. Hektori nuk kishte pranuar të fliste. Arrestimeve të asaj nate korriku u kishim shpëtuar vetëm unë, Ivi dhe Antoneta, e cila ishte larguar nga qyteti që pas luftës.

E pyeta Lysienin për Ludvigun, kryetarin e grupit tonë. E imagjinoja edhe atë të zhdukur në ndonjë kamp

apo të hedhur në ndonjë gropë të humbur pas vrasjes në Gestapo. Por Lysieni iu shmang vështrimit tim.

– *Klara duhet të dijë më shumë për të, – më tha.*

Zbrita një paradite deri pranë kishës së madhe të qytetit, te një bllok shtëpish të vjetra ku jetonte Klara. E gjeta atë në oborr, duke u marrë me lulet e saj. Në pamje të parë m'u duk se i kishte mbyllur historitë me këtë botë. Lëvizte si e papeshë, me gjymtyrë tmerrësisht të ngathta dhe një vështrim të ngulitur. U fliste lueleve herë pas here.

– Jetonte vetëm?

– Fare vetëm. Nuk ishte martuar kurrë. Ajo ishte e vetmja hebreje mes nesh. Shtyva portën dhe hyra në oborr. Klara nuk më ndjeu. Atëherë i fola. Ajo u kthye dhe më vështroi qetësisht.

– *Kush jeni? – më pyeti.*

– Simona, – iu përgjigja.

– *Simona?! Po ne nuk kishim takim sot. Nuk kemi vendosur gjë për aksionin e radhës.*

– Klara, erdha thjesht të të takoj. Është kohë tjetër. Jam kthyer edhe unë nga një kamp përqëndrimi.

– *Pas sa kohësh?*

– Pas shumë vitesh.

– *Pse kaq vonë, e shtrenjta ime?*

– Ashtu rodhën ngjarjet.

Ajo u shkëput nga lulet dhe më përqafoi. Kishte një fytyrë të bardhë e të ngrirë si prej mermeri, sy të palëvizur, gati pa lëng, që të kujtonin dy sfera qelqi. Për flokët nuk ishte kujdesur prej kohësh. Mbante veshur një rrobëdhomë të gjatë, që i ngatërrohej nëpër pantofla. Më ftoi brenda. Kohë pas kohe kishte çaste kthjellimi.

– *Simonë, ç'ndodhi me ty atë natë korriku? – më pyeti papritur.*

Ia tregova.

– *E ke idenë kush mund të na ketë spiunuar? – vazhdoi ajo.*

– Ndoshta askush. Thjesht na ranë në gjurmë.

– *Nuk e besoj. Dikush e bëri.*

– E ç'rëndësi ka tani? Klara, më trego ndonjë gjë për veten. Me se u more pas luftës?

Ajo iu shmang pyetjes dhe më ftoi në dhomën e saj të gjumit. Mbi krevatin e saj të vjetër pashë një fotografi të kryetarit të grupit tonë. Ishte zmadhuar dhe vendosur në një kornizë të bukur. Ai buzëqeshte prej saj me një pamje engjëjlore, si dikur në kohën e luftës. Duhej të kishte dalë në atë fotografi pak muaj para shkatërrimit të grupit tonë. Në një komodinë pranë krevatit ndodheshin dy foto të tjera, ku Klara kishte dalë e përqaftuar me Ludvigun.

– *Ajo ishte një dashuri e pavdekshme, – rënkoi papritur Klara.*

U ula përballë fotove e shushatur.

– Klara, mes teje dhe Ludvigut kishte një histori dashurie?!

– *Po, Simonë.*

– Kur ndodhi?

– *Deri ditën që më arrestuan. Ludvigu më kishte premtuar se do të martoheshim pas luftës.*

– Po ti, si nuk na fole kurrë ne vajzave për këtë histori?

– *Ludvigu më kishte porositur të heshtja. Ti e kupton... Figura e tij prej udhëheqësi...*

Figura e tij prej bastardi, mendova. Njëqind herë bastard.

– Ku ndodhet ai tani? – pyeta.

– *Nuk e di, – m'u përgjigj ajo. – Unë po e pres.*

– Ke kohë që e pret?



– Që pas luftës.

Ajo u ngrit dhe hapi sirtarin e sipërm të një komoje. Me duar të dridhura dhe ca lotë të ftohtë në sy, që ngjanin si copëra qelqi, nxori prej aty një palë intime femrash, nga ato që ne mbanim në vitet '40.

– Shikoji Simonë, – tha. – Këto kisha veshur kur bëra për herë të fundit dashuri me Ludvigun.

– E kur ndodhi kjo? – e pyeta.

– Dy ditë para se të më arrestonin.

– Ku ishit?

– Në shtëpinë e tij.

Bajga, në shtëpinë e tij më çonte edhe mua.

– Këtu janë ende duart e tij, Simonë, – vazhdoi ajo duke shtrënguar intimitet e saj në gjoks.

Ishte e sëmurë. Çastet e kthjellimit ishin fare të pakta në krahasim me turbullimin që e kishte pushtuar. Për të kujdesej disa orë në ditë një emigrante nga Sri Lanka.

– Ai do të kthehet dhe ne do të martohemi, – shtoi.

I kërkova të bënim një shetitje.

– Nuk eci dot, – tha ajo. – Nuk më mbajnë gjunjët.

Atëherë i premtova se do të kaloja prapë andej.

– Simonë, është e vërtetë që edhe ti e doje? – më pyeti ajo papritur, ndërsa po i afrohesha portës së oborrit. Me sa dukej e kishin radhën çastet e kthjellimit.

– Jo, – iu përgjigja. – Nuk e kam dashur kurrë.

Vështrimi i saj i akullt sikur më shpoi tejprtej.

– Nuk më gënjen dot, – tha. – Një ditë unë gjeta në shtratin e tij një fije floku nga të tutë.

– Mundet, – ia ktheva. – Por kjo nuk do të thotë se e kam dashur! Po ti, pse vazhdojë të shkoje me të pasi gjete fijen e flokut?

– Ai ishte udhëheqësi. Unë e adhuroja.

Jetë e shkatërruar, mendova. Nuk duhet ta ngatërmoj

më tej. Ika. Eca gjatë në këmbë për të mbledhur veten. Por nuk kishte mbaruar gjithçka. Ivi erdhi të nesërmen te Bliret. Më mori me makinën e tij dhe dolëm për të drekuar jashtë qytetit. Ai vazhdonte të mbahej mirë. Pas luftës kishte punuar profesor në gjimnaz. Ishte martuar dy herë. Kishte fëmijë me të dyja gratë dhe nuk i kishte takuar ata prej vitesh. Me gruan e dytë mbahej si gozhda me potkoin.

– Kush ishte gozhda?

– Sipas tij, ajo. Kuptohet.

– *Zakonisht bie potkoi i pari, – më tha. – Edhe unë po pres të bie. Simonë, pse jetojmë si budallenj për t’u zhgënjyer në fund? – më pyeti.*

– E kam urryer gjithmonë filozofinë, – iu përgjigja. – Të gjithë filozofët të mësojnë se si të jetosh keq. Gjithsecili e nxjerr vetë filozofinë e jetës së tij.

– *Pra, jo të gjithë zhgënjehen? – vazhdoi ai.*

– Unë nuk futem te të zhgënjyerit.

Ai më vështroi gjatë.

– *Simonë, çfarë kishte të bukur jeta jote? – pyeti.*

– Mbijetesën, – iu përgjigja. – Ata që luftojnë për të mbijetuar nuk kanë kohë të zhgënjehen.

– *Është e kotë, – tha ai. – Nuk do të kuptohemi dot. Kemi jetuar në dy botë të ndryshme.*

Kujtuam shumë histori të kohës së luftës. Kuptohet, mbërritëm edhe te nata e arrestimeve dhe arrative.

– *Simonë, a të shkon ndër mend se kush na spiunoi? – më pyeti ai.*

Kryqëzuam vështtrimet gjatë.

– Udhëheqësi, – iu përgjigja unë pastaj.

Në fytyrën e tij nuk lëvizi asnjë nerv.

– *Ti e dije?*

– Jo. E mësova këtu.

– Si?

– Nuhatje femrash.

– Pra, është e vërtetë që ai shkonte me ty dhe Klarën?

Nuk i ula sytë.

– Po, – iu përgjigja qetësisht. – Na kishte premtuar të dyjave se do të martohej me ne pas luftës. Mbase e ka bërë këtë gjë edhe me ndonjë tjetër.

– Dhe nuk desh asnjërën.

– Kuptohet. Po ti, kur e more vesh të vërtetën?

– Disa vjet pas luftës. Diku në Suedi arrestuan një oficer gjerman të Gestapos. E gjykuan këtu në Belgjikë. Ishte ai që vrau me plumb pas koke Hektorin. Kishte studjuar në Paris. E fliste frëngjishten shumë rrjedhshëm.

Mua m'u ftohën duart.

– Ai pranoi në gjyq se Ludvigu kishte spiunuar për Gestapon. Ishte rekrutuar prej saj. Pas nesh kishte marrë më qafë edhe një grup tjetër të rezistencës.

Mbulova fytyrën me duar. M'u desh kohë të kthjellohesha.

– Pas akuzave që iu bënë, njeriu i Gestapos tha se kishte bërë vetëm detyrën e tij si ushtarak, – vazhdoi Ivi. – Shumë krime i mohoi. Madje u mburr se një vajze të grupit tonë i kishte shpëtuar jetën.

Ishte ti... Simonë?

I ngrita përsëri sytë drejt tij.

– Po, Iv.

– A kam të drejtë ta di si ndodhi?

– Plotësisht.

I tregova për natën e fshehjes te Bliret, pa lënë mangut asnjë detaj.

– Çast dobësie njerëzore, – psherëtiu Ivi.

– Ti ke dyshuar gjatë këtyre viteve se mund të kem qenë edhe unë spiune? – e pyeta.

– Jo, kurrë, – tha ai.

– Pra, më bëson?

Ivi më buzëqeshi.

– Sigurisht, – u përgjigj.

– Po ai... udhëheqësi ynë?

– U largua pas luftës. Diku larg. Pa gjurmë.

– Nuk e gjetën dot?

– Jo. Simonë, ai njeri nuk kishte asnjë lidhje me komunizmin.

– Asnjë grimë.

Ivi nënqeshi.

– Shpesh udhëheqësit nuk kanë asnjë lidhje me revolucionet apo ideologjitë që drejtojnë, – tha.

– Nuk ke bërë ndonjë zbulim të ri, – ia ktheva. – Po ti, kur hoqe dorë nga komunizmi?

– Kur Bashkimi Sovjetik pushtoi Hungarinë. Ti?

– Nuk mund ta them dot me saktësi. Ndoshta kur fillova të shkoja në kishë dhe të lexoja Biblën.

Ai zgjati duart mbi tryezë dhe shtrëngoi duart e mia.

– Kohë të shkuara! – psherëtiu. – Besoj se është hera e fundit që u kthehem. Nuk më bëjnë mirë ato kujtime. Uroj që edhe ti ta mbledhësh veten shpejt.

– Do të përpiqem.

Kur po ndaheshim u mallëngjeva keqazi.

– Iv, nuk do ta harroj deri në vdekje fytyrën tënde atë natë kur erdhe të më njoftoje të largohesha nga shtëpia, – i thashë. – Më ke shpëtuar jetën.

– Jam i bindur se për atë veprim nuk do të zhgënjehem kurrë, – tha ai duke më buzëqeshur. – Simonë, do të gjesh mbështetje tek unë. Të jesh e sigurt për këtë.

E përqafova dhe qava në supin e tij.

## XIV

Ja, vogëlushe, kështu nis dhe mbyllet një jetë. Ti dhe Antuani jeni në kilometrat e parë të një rrugë të re. Te Bliret po na presin, zemër. Njerëz që nuk janë të gjakut tonë, por që janë njerëz të vërtetë. Iu luta Lysienit për time bijë, për Antuanin dhe për ty.

– Për mua?!

– Po, zemra ime e vogël. Pandehje se do ta këshilloja tim nip të të linte pas? Nuk mund ta bëja dot këtë. Ti je pjesë e jetës së tij tashmë. Mbase do të jesh për shumë kohë. Kjo duhet provuar. Jo! Mos bëj premtime! Kurrë mos bëj premtime!

– Jo, nuk desha të premtoj asgjë. Vetëm desha të të thosha se...

– Të lutem, jo tani! Do të kesh kohë. Unë kam ndër mend të jetoj gjatë.

– Të kuptova.

– Dhe ... po thosha...

– Iu lute Lysienit për ne.

– Dhe ai m'u përgjigj se te Bliret kishte vend për të gjithë ne. Deri sa ju të mbaroni shkollimin dhe të dilni në jetë. Deri sa ime bijë, mbase, të lidhet me një burrë tjetër. Është edhe ajo në mes të rrugëtimit të saj, në një kryqëzim.

– Nona, sa kohë ndenje te Bliret?

– Gati dy muaj. Deri sa më kthyen nënshtetësinë dhe mora pasaportën belge. Lashë të hapur procedurën për

time bijë, Antuanin dhe ty. Je pjesë e familjes, vogëlushe.

Vajza e mbërtheu dorën e gruas dhe e puthi gjatë.

– Dhe tani po ma thua këtë?!

– Më duket se erdhi koha. Apo jo?

– Po si ka mundësi që nuk ia ke thënë as Antuanit?!

– Antuani e njeh gjyshen e tij. Mos ki merak. Kështu, i lashë letrat hapur dhe bëra gati valixhen time. Në oborr më prisnin edhe dy valixhe të tjera, të mbushura me dhurata nga Lysieni, Lizeta, Ivi dhe disa shoqe të vjetra të vajzërisë. Ndërkohë kishte hyrë dimri. Vesha një pallto të falur, mbatha një palë këpucë me qafa të Lysienit, vura në kokë kapelën e dikurshme të Vegimit dhe mbërtheva fort në dorën e djathtë një shkop. Të zotët e vilës së Blireve e nuhatën ç'më kishte shkrepur në kokë.

– *Simonë, maleve ka nisur bora, – më tha Lysieni.*

Por unë ia kisha ngulur sytë pyllit.

– I mbaje mend të gjitha vendet nga kishit kaluar në kohën e luftës?

– Të gjitha. Ndoshta më kishin shpëtuar dy apo tri ndalesa. Lysieni më gjeti një furgon që transportonte prodhime blegtorale. Ai do të më çonte deri në një farë vendi.

– *Simonë, tani nuk ke pse fshihesh, – tha duke qeshur. – Ndiq gjithmonë rrugën e makinave. Të lutem, më jep fjalën që nuk do të ecësh në këmbë!*

Por unë nuk ia dhashë. Doja të ecja në këmbë si dikur. Lysieni më përmendi përsëri borën, me sa duket për të më trembur. Iu përgjigja se do të tregohesha e kujdesshme. Ai më shoqëroi një copë rrugë. Kur po ndaheshim, më la në dorë një zarf me para. Nuk desha t'i pranoja.

– *Ti nuk ke të drejtë të më fyesh, – tha ai i prekur. – Merri!*

*Unë kam shumë. Një zarf më pak nuk do të ndryshojë asgjë. Ti nuk mund të shkosh deri në Bari të Italisë duke bërë autostop.*

E mora zarfin me dorë të dridhur.

– Dije se jam nip do të t'i kthejë, – i thashë me krenari.

– *As që dyshoj për këtë, – m'u përgjigj ai. – Uroj të jem gjallë deri atë ditë! Simonë, edhe një porosi të fundit! Të lutem puthe pllakën e varrit të Vegimit për mua!*

U nisa. Lysieni duhej ta kishte porositur shoferin për gjithçka sepse ai pranoi të ndalonte dy herë në pyll.

– Arrite të gjeje ndonjë vend të njohur?

– Po. Një burim ku kishim pirë ujë me Vegimin pas dashurisë së parë në arrati. Pranë tij dikur kishte qenë një kasolle barinjsh, por atë nuk ma zunë sytë. Ndërsa burimi vazhdonte të rridhte. U ula në gjunjë dhe piva në një lëfynt guri. Shoferi nuk më ngacmoi me pyetje. Vetëm kur po ndaheshim, ai më vështroi i menduar dhe tha:

– *Zonjë, a keni ndonjë peng në jetën tuaj?*

– Jo, – iu përgjigja aty për aty.

– *Çudi! – psherëtiu ai. – Unë nuk i kam kaluar të pesëdhjetat dhe kam disa.*

Në një stacion të madh treni vendosa t'i hiqja qafe valixhet. I nisa me porosi për në stacionin e Romës. Mbajta vetëm disa plaçka në një çantë. Kështu, fillova ta bëja një pjesë të mirë të rrugës në këmbë. Herë pas here i ngrija dorën ndonjë makine. Një pension të vogël alpin me emrin “Te jargavanët”, ku kishim kaluar një natë, e gjeta ashtu siç e kisha lënë, madje me të njëjtin emër.

– Pse e quanin ashtu?

– Oh, ishte një kështjellë e vogël e veshur me degë jargavani. Ato u ishin qepur mureve të gurta dhe kishim

mbuluar çatinë. Në korrik, tufçet e luleve ishin në shpërthim të plotë dhe vendi rrotull kundërmonte një aromë dehëse. Kërkova dhomën numër 5, ku dikur kisha fjetur me gjyshin e Antuanit dhe përsëri ndenja pa gjumë, ndonëse nuk ishte korrik. Aroma e jargavanëve më çante hundët. E ndieja ngado. Atë natë të largët mjalti unë dola në dritare dhe këputa disa tufçe lulesh. I shpërndava ato nëpër krevat. Pastaj këputa të tjera e të tjera. U sajua një çarçaf i madh ngjyrë lejla. Nga Vegimi më vinte ende turp kur zhvishesha, ndaj mbulova edhe pjesët e mia intime me tufçe lulesh. Kur ai më pa, qeshi i befapsuar dhe, kuptohet, sytë i shkuan te tufçet që më mbulonin mua.

– *Çfarë sekretesh fshihen pas këtyre tufave që po më dehin?* – pyeti. – *Pa ta shohim.*

Dhe i largoi lulet ngadalë, fare ngadalë, sikur nën to të ishin fshehur thesaret më të çmuara të kësaj bote. Ne bëmë dashuri mbi lulet e jargavaneve. E si mund të harrohet një dashuri e atillë? Petalet e jargavaneve na ngjiteshin nëpër trup dhe ne i largoëm ato me buzë. Lëngu i atyre luleve të mrekullueshme na mbeti në lëkurë. Tani që flas e ndiej aromën e tyre.

– Po atë ujëvarën e famshme, e gjete?

– Oh, sigurisht. Vajta edhe atje. Prita me sytë ngulur drejt ujit që binte furishëm deri sa m'u fanepsën në mes të tij dy njerëz që bënë dashuri. I njoha. Ishim ne. Pastaj qava.

Eh, ai ishte një rrugëtim në vetmi, megjithatë unë tërë kohën mendoja sikur ishim bashkë me Vegimin, sikur gjithçka ishte si dikur, ndonëse shumë nga fshatrat malorë me shtëpi prej guri, kishat dhe manastiret, tashmë ishin braktisur dhe njerëzit kishin rënë poshtë në lugina, nëpër shtëpi të reja prej tulle. Nëpër rënojat



e gurta gjeje më të rrallë ndonjë blegtor ose ndonjë tip të vetmuar që nuk kishte pranuar t'i dorëzohej luginës.

– Nuk kishte frikë se mos humbje?

– Frikë?! Jo, aspak. Në të vërtetë humba dy herë në pyll. Falë disa shenjave nëpër drurë arrita të dilja përsëri në rrugë. Herën e dytë më ndodhi para se të mbërrija në një manastir. Gati më zuri nata jashtë. Kur trokita në portën e manastirit ishte errur. Rrotull nuk pipëtitte frymë e gjallë. Dyshova se manastiri duhej të ishte braktisur dhe fillova të kërkoja me sy për ndonjë strehë, kur portën e hapi një prift i moshuar, i cili vazhdonte të shërbente në një kishë të bukur aty pranë. Më ftoi brenda. Darkuam bashkë.

– Ku janë murgjit? – pyeta.

Ai më vështroi me çudi, pastaj rënkoi me dhimbje e mall.

– *Murgj nuk ka më, zonjë. Është një traditë që po zhduket. Tashmë këtu vijnë vetëm turistë.*

– Keni vite këtu?

– *Oh, një jetë. Që nga viti 1931. Jam ndër të fundit e brezit tim.*

– Atëherë, keni qenë këtu verën e vitit 1943, kur poshtë në fshat ndodheshin gjermanët?

– *Nuk kam lëvizur kurrë nga ky vend.*

– Në korrik të vitit 1943 unë dhe i fejuari im jemi strehuar këtu për një natë. Mua më kërkonte Gestapoja. Kisha me vete një pasaportë false.

Ai e ndërpreu të ngrënët, piu pak verë, pastaj më vështroi i hutuar.

– *A e mbani mend ku fjetët atë natë?* – më pyeti.

– Sigurisht. Ishte një dhomë e vogël, dritarja e së cilës binte përballë këmbanave të kishës.

– *Ç'ndodhi me ty dhe të fejuarin tënd atë natë?*

– Më falni, atë, por ishim të çmendur atëherë, kullonim mjaltë. Ndonëse ishte mëkat i madh, ne...

– *Bëtë dashuri?*

– Po. Dhe nuk ishim vetëm të çmendur. Unë isha komuniste, kurse im shoq mysliman. Menduam se mund të na falej dhe...

Ai ngriu për ca çaste.

– *Zoti ynë, sa e vogël është bota! – psherëtiu. – Zonjë, a do të më lejoni t'ju rrëfehem?*

– E pse jo?!

– *Atë natë vere unë nuk munda të fle. Isha në dhomën afër jush. Ju kërkoj njëqind herë falje, por... Mënyra se si ju bënit dashuri ishte një mrekulli dhe...*

– Atë, ju na keni parë?

– *Ka qenë një nga rastet e rralla kur më ka munduar tundimi dhe kur kam menduar se të humbje dashurinë për rrobën e priftit nuk ia vlente. Në fillim dëgjova rënkimet tuaja. Zura veshët me duar. Por nuk munda të duroja gjatë. Në dysheme ishte një e çarë e gjerë dhe... Ju lutem, më falni!*

– Oh, atë, ju ishit i ri.

– *I kam kujtuar shpesh skenat tuaja të dashurisë. Në mëngjes doja t'ju shikoja në fytyrë, por ju ikët nëpër mugëtirë.*

– Po, më kujtohet. Kishim frikë nga gjermanët.

– *Zonjë, mund t'ju dukem i lajthitur, por kujt ia kishte marrë mendja se pas kaq vitesh... Edhe mund të mos e kisha treguar, por janë ca gjëra në jetë që...*

– Ne nuk duhej të kishim vepruar ashtu.

– *Eh! Sikur! Atëherë unë besoja se ju ishit pushtuar nga Djalli. Mund të kisha njoftuar t'ju dëbonin, por më erdhi keq. Në mëngjes u vetfshikullova për t'u kthjelluar dhe u luta të më falej mëkati, megjithatë, skenat tuaja të dashurisë mbetën në kujtesën time. Ishin gjërat nga të cilat unë kisha*

*hequr dorë.*

Filluam të qeshnim të dy. Po të kishte pirë ndonjë gotë më shumë, ai ndoshta do të më kishte treguar edhe ndonjë mëkat tjetër. Kur mësoi historinë time, më premtoi se do të niste në qytetin tonë ca ndihma humanitare.

– I nisi vërtet?!

– Sigurisht. Kur është fjala për ndihmë, një prift nuk mund të gënjejë.

Vonë në darkë ai më shoqëroi deri te dera e dhomës time të dikurshme.

– *Zonjë, më vjen mirë që në atë skëterrë gjetët forcë të ktheheshit në rrugën e Zotit, – tha.*

– Më ktheu jeta, – iu përgjigja.

– *Herët a vonë, të gjithë i kthen jeta te Ai, – psherëtiu prifti – Flini e qetë, zonjë. Nga lart nuk do t'ju përgjojë njeri. Tavani është i ri.*

Qeshëm përsëri. Megjithatë, përsëri unë nuk fjeta dot.

– Sa ditë zgjati udhëtimi?

– Ndoshta tetë. Deri në Piemonte. Atje pastaj mora trenin për në Romë. Filloi të më ngacmonte kolla. Isha e dërmuar. Sara kishte dalë të më priste në stacion bashkë me të shoqin. Sa më pa ashtu me shkop në dorë dhe kapelë në kokë, ajo kuptoi gjithçka. I dinte mirë historitë e Rrugës së Mjaltit. Në fillim u përlot, pastaj filloi të qeshte. Qesha edhe unë.

– *Simonë, je e çmendur, – më tha. – Vjen aromë pylli.*

– Sara, duhej bërë, – iu përgjigja. – Ishte një premtim. Ju jeni përsëri dy. Mund të çmendeni kur të doni. Zoti im, do të isha gati ta sosja jetën këtu në Romë, vetëm Vegimi të kishte qenë me mua!

Ata më futën në mes dhe shkuam në shtëpi. Ishte një apartament i vogël, por ama pronë e Sarës. Ia kishin ruajtur njerëzit e saj. M'u lutën të qëndroja. E kupton?

Ishte gallatë dhe rrëmuje Shqipërie. Nuk më ikej. Një mbrëmje, bashkë me burrin e Sarës, organizuam një koncert për piano dhe violinë, ku morën pjesë edhe disa nga fqinjët. E shëtitem Romën në këmbë. Por kisha lënë time bijë dhe Antuanin vetëm dhe...

– Më kujtohet kur zbritë nga trageti, – tha vajza. – Ishe ndryshe. Krejt ndryshe.

– Por... vetëm. Vogëlushe, ti nuk e di sa e poshtër është vetmia. Uroj që të mos e provosh kurrë!

## XV

Ndërkohë kishte zbardhur. Kuvërta e gjatë e anijes filloi të zgjohej. Një klithmë korale gëzimi u përhap mbi det. Ato të dyja u vështruan gjatë në sy. Gruaja buzëqeshi. Pastaj vajza.

– Nona, shpesh kam pyetur veten pse ti je kaq e mirë, – foli.

– Të dukem vërtetë e mirë?

– Oh, nuk të krahasoj dot me asnjë njeri tjetër që njoh.

– E po, nëse jam e tillë, jam sepse kam vuajtur shumë.

Vajza zgjati buzët dhe e puthi në tëmthin e thinjur.

– Po për mamin tim... do të mendosh keq?

– Për nënën tënde? Jo, sinqerisht, jo. Ajo histori u ndodh shumë grave. Pastaj ato kthehen te burrat e tyre dhe e kuptojnë se në të vërtetë janë këta të fundit që kanë dashur më shumë. Pas një tradhtie inatçore apo dashurie të re gënjeshtare, një grua e do më shumë burrin e saj. Një burrë po ashtu gruan e tij. Dhe kështu jeta shkon përpara.

Oh, vogëlushe, jam krejt e mpirë. Të lutem, zgjoje Antuanin! Dua të ngrihem, të lëviz. Nuk i ndiej gjymtyrët. Antuan!

– E do frëngjisht.

Gjyshja i foli një sërë fjalësh të ëmbla në gjuhën e saj të parë. Djali u ngrit duke fërkuar sytë.

– Shikoje Italinë, – iu drejtua gjyshja. – Të besohet?

Ai puliti disa herë qepallat, pastaj filloi të qante.

– Nona, pra, mbaroi gjithçka?

Gjyshja e përqafoi.

– Jo, zemër. Gjithçka po fillon. Shikoje mirë atë tokë të lirë, Antuan. Mos e harro kurrë këtë pamje! Për atë tokë të lirë me qindra njerëz kanë humbur jetët e tyre.

Ata, si edhe njerëzit e tjerë rreth e rrotull, nuk u ulën më deri sa anija mbërriti në portin e Brindizit. Nga atje u nisën drejt e në stacionin e trenit. Gruan e vjetër me emrin Simonë e këputi gjumi sapo u ul në ndenjësë. Dy të rinjtë u pështetën në supet e njëri-tjetrit, me duart shtrënguar, duke mos e besuar ende që ai tren po i çonte drejt Romës.

– Eta, jeni të dyja të krisura, – tha djali papritur.

– Kush? – pyeti vajza.

– Ti dhe gjyshja ime. Gjatë natës dëgjova gjithçka. Isha zgjuar.

– E di, – iu përgjigj ajo qetësisht. – Të ndieja që ishe zgjuar. Të jesh e sigurt që edhe nona e ka ditur. Antuan, ajo donte që ne të dy ta dëgjonim deri në imtësitë më të vogla historinë e saj.

– E kuptoj.

– Deshi të na tregonte se si jetohet me dinjitet një jetë njerëzore. Ndërkohë edhe unë doja që ti të dëgjoje ca gjëra të miat, të pathëna. Mbase e tepëruam pak vende-vende, por femrat mes tyre kështu flasin.

– Ç'natë! – rënkoi ai. – Me mijëra kilometra e gjatë.

- fund -